# LLOGARITJA E MINIMUMIT JETIK NË SHQIPËRI

*- Nga Minimumi Jetik si Mbijetesë drejt një Standardi Jetese të Arsyeshëm -*




Përgatitur nga:

ACER
Albanian Center for Economic Research



Tiranë, Tetor 2016

Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë studim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën apo qëndrimin zyrtar të institucioneve publike të konsultuara në procesin e përgatitjes se tij.

## PËRMBAJTJA

**Lista e Shkurtimeve ....... 7**

Përkufizime ....... 8

Hyrje ....... 10

Përmbledhja Ekzekutive ....... 12

**1. NJË KËNDVËSHTRIM TEORIK RRETH MINIMUMIT JETIK ....... 15**

1.1 Rishikimi i Literaturës ....... 15

1.2 Vështrim mbi Metodat e Matjes së Minimumit Jetik ....... 19

1.2.1 Metoda e Varfërisë Absolute ....... 20

1.2.2 Metoda e Varfërisë Relative ....... 21

1.2.3 Metoda e Standardeve të Buxhetit ....... 22

1.2.4 Metoda e Përafrimit të të Ardhurave ....... 23

**2. METODOLOGJIA E STUDIMIT ....... 26**

2.1 Rishikimi i të Dhënave Dytësore ....... 26

2.2 Grumbullimi i të Dhënave Primare ....... 26

2.3 Kufizimet e Studimit ....... 27

**3. NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI MINIMUMIN JETIK ....... 28**

3.1 Aspekte të Minimumit Jetik në Kontekst Global ....... 28

3.1.1 Minimumi Jetik në SHBA ....... 29

3.1.2 Minimumi Jetik në Vendet Themeluese të Bashkimit Evropian ....... 30

3.1.3 Minimumi Jetik në Vende të Evropës Lindore Pjesë e Bashkimit Evropian ....... 34

3.1.4 Minimumi Jetik në Ballkanin Perëndimor ....... 41

3.2 Evoluimi i Matjes së Minimumi Jetik në Shqipëri ....... 44

3.3 Kuadri rregullator dhe institucional për Minimumin Jetik ....... 55

3.3.1 Kuadri Rregullator ....... 55

3.3.2 Roli i Institucioneve Publike në Kuadër të Përcaktimit të Minimumit Jetik ....... 57

3.3.3 Monitorimi dhe Trajtimi i Minimumit Jetik nga Aktorë të Tjerë të Jashtëm ....... 58

**4. PËRLLOGARITJA E MINIMUMIT JETIK NË SHQIPËRI ....... 64**

4.1 Metoda e përzgjedhur për Studimin ....... 64

4.1.1 Numri i kalorive që kërkohen për një muaj për një individ mesatar ....... 65

4.1.2 Grupet ushqimore që do të përfshihen në dietën model ....... 65

4.1.3 Përqindja e kalorive që duhet të zënë proteinat, yndyrnat dhe karbohidratet në dietën model ushqimet specifike të secilit grup ushqimor ....... 65

4.1.4 Përcaktimi i kostos së secilit produkt ushqimor dhe shumatores së tyre për llogaritjen e kostos totale të shportës ....... 66

4.1.5 Përcaktimi i shpenzimeve jo-ushqimore dhe llogaritja e minimumit jetik ..........66
4.2 Të dhëna për Llogaritjen e Minimumit Jetik në Shqipëri ..........68
4.3 Përllogaritja e Nivelit të Minimumit Jetik në Shqipëri ..........71
4.4 Nga minimumi jetik si filantropi drejt një standardi jetese të arsyeshëm ..........76
**5. CESHTJE PER DISKUTIM ..........79**
5.1 Indeksimi i Minimumit Jetik ..........79
5.1.1 Inflacioni ..........79
5.1.2 Remitancat ..........80
5.1.3 Reformat e Qeverisë Kundër Informalitetit ..........81
5.2 Implikimet e Përllogaritjes së Minimumit Jetik në Vend ..........82
5.2.1 Ndikimi në Pagën Minimale ..........82
5.2.2 Ndikimi në Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore ..........82
5.2.3 Ndikimi te Pensionet ..........83
5.2.4 Ndikimi te Ndihma Ekonomike ..........83
5.2.5 Ndikimi te Pagesa e Papunësisë ..........84
5.2.6 Ndikimi te Pagesa e Paaftësisë ne Pune ..........84
**6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME ..........85**
6.1 Disa Përfundime Kryesore ..........85
6.2 Disa Rekomandime Kryesore ..........87
**Bibliografi e Zgjedhur ..........93**

## Lista e Tabelave

Tabela 1. Metodat e ndryshme për përcaktimin e varfërisë dhe minimumit jetik. 24
Tabela 2. Përkufizimi i grupeve ekonomike .......... 29
Tabela 3. Minimumi jetik në vendet e Bashkimit Evropian (në euro) .......... 31
Tabela 4. Përqindja e popullsisë në rrezik varfërie në vitin 2014 .......... 32
Tabela 5. Disa ndër Indikatorët Kryesorë të Strategjisë Evropa 2020 .......... 34
Tabela 6. Popullsisë në rrezik varfërie (2013-2015) .......... 36
Tabela 7. Vlerat vjetore të minimumit jetik sipas metodës së varfërisë relative në disa prej vendeve të BE-së (Euro/muaj) .......... 37
Tabela 8. Rregullim ose jo mbi përcaktimin e pagës minimale në BE që prej 01 Janar 2016 .......... 38
Tabela 9. Të dhëna mbi pagat minimale në disa vende të BE-së .......... 39
Tabela 10. Të dhëna krahasuese të pagës minimale dhe minimumit jetik për frymë (2013-2015, në euro) .......... 40
Tabela 11. Të dhënat ekonomike të Ballkanit Perëndimor .......... 42

Tabela 12. Vlera të Minimumit Jetik në disa nga vendet e Ballkanit Perëndimor (Euro/muaj) ........ 43
Tabela 13. Paga minimale dhe minimumi jetik në Ballkanin Perëndimor (Euro/muaj) ........ 43
Tabela 14. Përllogaritjet e minimumit jetik në Shqipëri ndër vite ........ 46
Tabela 15. Treguesit e kufirit të varfërisë ........ 49
Tabela 16. Shpenzimet për mbrojtjen sociale në vitin 2014 ........ 52
Tabela 17. Matrica e disa shërbimeve me fondet buxhetore në vitin 2015 ........ 53
Tabela 18. Fushat e veprimit të agjencive shtetërore dhe aktorëve të tjerë në lidhje me çështje të minimumit jetik ........ 59
Tabela 19. Shpërndarja e nevojave ushqimore sipas proteinave, yndyrnave dhe grupeve ushqimore sipas rekomandimeve të FAO ........ 66
Tabela 20. Burimet e kalorive në shportën e 2288 kalorive ........ 68
Tabela 21. Shpenzimet mesatare mujore për konsum ........ 69
Tabela 22. Çmimet mesatare të shpenzimeve ushqimore të konsumit (në lekë) .. 70
Tabela 23. Norma ditore mesatare në gram dhe në kalori ........ 72
Tabela 24. Minimumi jetik në vlerë për artikujt ushqimorë në muaj ........ 73
Tabela 25. Minimumi jetik në vlerë për frymë në muaj ........ 74
Tabela 26. Kufiri i varfërisë me metodën e indeksit të çmimeve të konsumit ..... 75
Tabela 27. Matrica e ndërhyrjeve të rekomanduara ........ 90

**Lista e Figurave**

Figura 1. Piramida e koncepteve të varfërisë ........ 16
Figura 2. Paraqitje Skematike e Shërbimeve Sociale të Shtetit ........ 48
Figura 3. Grafiku i metodës së përdorur për llogaritjen e Minimumit Jetik ........ 67
Figura 4. Inflacioni në Shqipëri në vitet 2000-2015 ........ 80
Figura 5. Remitancat personale në Shqipëri 1992-2015 (në milionë $ amerikan) .. 80

**Falënderime**

"Shqipëria është i vetmi vend në Evropë që nuk ka të deklaruar minimumin jetik. Sindikata, organizma të tjera jo-qeveritare dhe institucioni i Avokatit të Popullit kanë bërë në vite kërkesa të vazhdueshme për të shpallur zyrtarisht minimumin jetik, por nuk kanë marrë asnjë përgjigje, apo qoftë dhe prononcim zyrtar për këtë problem" - ishte konkluzioni kryesor i një auditoriumi të gjerë të organizuar nga institucioni i Avokatit të Popullit një vit më parë rreth kësaj teme. Është pikërisht kjo arsyeja që ky institucion, përmes një procesi konkurrues, kontraktoi Qendrën Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER) për realizimin e studimit: "Llogaritja e Minimumit Jetik".

Falënderime të veçanta për ekipin e ekspertëve të Qendrës Shqiptare për Kërkime Ekonomike, posaçërisht për Dr. Zef Preçi për udhëheqjen metodologjike nga ana e tij të të gjithë procesit të hartimit, plotësimit, redaktimit, përshtatjes dhe përgatitjes së raportit të studimit në fjalë. Falënderime për Prof. Fatmir Memaj, Lorena Zajmi (MSc), Eugena Topi (MSc) dhe Brunilda Kosta (PhD) që grumbulluan dhe analizuan informacionin e nevojshëm për hartimin e këtij raporti.

Falenderime gjithashtu për bashkëpunimin dhe asistencën e dhënë nga zyrtarët dhe punonjësit e INSTAT-it, Institutit të Shëndetit Publik (ISHP), Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore që ndihmuan në sigurimin e informacionit statistikor, si dhe ekspertëve të njohur si: Prof. Kosta Barjaba, Luan Shahollari, Kiço Ziso e Naim Hasa që ndihmuan në konsultimin e dokumentit gjatë gjithë procesit të përgatitjes të tij.

Së fundi, falënderime dhe mirënjohje për mbështetjen e dhënë nga institucioni i Avokatit të Popullit për drejtimin dhe realizimin e projektit, posaçërisht për zt. Igli Totozani për inkurajimin personal në realizimin e këtij studimi.

## LISTA E SHKURTIMEVE

| | |
|---|---|
| ACER | Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike |
| BB | Banka Botërore |
| BE | Bashkimi Evropian |
| BSPSH | Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë |
| FAO | Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë |
| FMN | Fondi Monetar Ndërkombëtar |
| GDP | Produkti i Brendshëm Bruto |
| ILO | Organizata Ndërkombëtare e Punës |
| INSTAT | Instituti i Statistikave |
| ISE | Instituti i Studimeve të Ekonomisë |
| KP | Kodi i Punës |
| LSMS | Anketa për Matjen e Nivelit të Jetesës |
| ME | Ministria e Ekonomisë |
| MJ | Minimumi Jetik |
| MMRS | Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë |
| NE | Ndihma Ekonomike |
| OECD | Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim |
| OJF | Organizata Jo-fitimprurëse |
| OKB | Organizata e Kombeve të Bashkuara |
| PAK | Persona me Aftësi të Kufizuar |
| SHBA | Shtetet e Bashkuara të Amerikës |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |

## PËRKUFIZIME

**Minimumi jetik** është shuma monetare e një sërë produktesh ushqimore të përshtatshme për të siguruar funksionimin normal të trupit të njeriut dhe ruajtjen e shëndetit, plus një numër minimal artikujsh jo-ushqimorë dhe një numër minimal shërbimesh të nevojshme për të përmbushur nevojat bazë social-kulturore. [1]

**Paga Minimale** është shuma e paguar për punën e kryer ose shërbimet e dhëna, brenda një periudhe të caktuar, të llogaritur ose mbi bazën e kohës ose të prodhimit, e cila nuk mund të reduktohet nga marrëveshje kolektive ose individuale, e cila është e garantuar nga ligji dhe caktohet në mënyrë të tillë që të mbulojë nevojat minimale të punëtorit dhe familjes së tij duke marrë parasysh kushtet ekonomike dhe sociale.[2]

**Pensioni social** është një përfitim që i jepet çdo shtetasi shqiptar, i cili ka mbushur moshën 70 vjeç, është me qëndrim të përhershëm në Shqipëri të paktën për pesë vitet e fundit, nuk plotëson kushtet për asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe nuk ka të ardhura, ose të ardhurat që përfiton nga çdo burim tjetër, janë më të ulëta se të ardhurat që jep pensioni social.[3]

**Ndihma ekonomike** është mbështetja në para, që u jepet familjeve dhe individëve në nevojë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj. [4]

**Pagesa e papunësisë** është pjesë e politikave shtetërore të punësimit, e cila siguron mbështetjen me të ardhura të të papunëve në momentin e daljes së tyre si të tillë, duke synuar krijimin e kushteve për rikthimin e tyre në tregun e punës.[5]

**Pagesa e aftësisë së kufizuar** është pagesa mujore, në lekë, që u jepet personave me aftësi të kufizuar, sipas përcaktimit në ligj.[6]

**Shërbimet shoqërore** përbëhen nga tërësia e shërbimeve që u ofrohet individëve dhe grupeve në nevojë, të cilët nuk janë në gjendje të përballojnë, me burimet që kanë, nevojat e tyre jetësore, për ruajtjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e mundësive individuale, për të kapërcyer nevojat emergjente. [7]

---

[1] ILO, Akti Nr. 966, 15 Korrik 1999, http://ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:13100:0::NO::P13100_COMMENT_ID:3081229

[2] ILO, 1992, http://libguides.ilo.org/minimum-wages-en

[3] Ligji Nr. 7703, date 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", 1993, Neni 5/1, http://www.issh.gov.al/al/wp-content/uploads/2014/02/LIGJI_7703_MERITA_UPDATE_02_02_2015.pdf

[4] Ligji Nr. 9355, date 10.03.2005, "Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore", Neni 4, http://www.sociale.gov.al/files/userfiles/Ligj_Nr._9355,_date_10.3.2005_PER_NDIHMEN_DHE_SHERBIMET_SHOQERORE,_i_ndryshuar.doc

[5] VKM Nr 203,date 19.04.2006, "Për Pagesën e së Ardhurës nga Papunësia", http://www.kerkojpune.gov.al/wp-content/uploads/2014/03/Pagesa-e-Papun%C3%ABsis%C3%AB-n%C3%AB-mb%C3%ABshtetje-t%C3%AB-tregut-t%C3%AB-pun%C3%ABs.pdf

[6] Ligji Nr. 9355, datë 10,03,2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", Neni 3, http://observator.org.al/wp-content/uploads/2015/11/Ligji_9355_per_ndihmen_ekon.dhe_sherbimet_sociale.pdf

[7] Idem

**Të ardhura të familjes** janë të ardhurat e të gjithë anëtarëve të familjes nga çdo lloj burimi, përfshirë dhe ata anëtarë që jetojnë dhe punojnë jashtë shtetit. Nuk përfshihen në të ardhurat e familjes pagesat që marrin anëtarët e familjes me aftësi të kufizuar, në kuptim të ligjit në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore.[8]

**Varfëria absolute** përcaktohet si një gjendje e karakterizuar nga privimi i rëndë i nevojave themelore të njeriut, duke përfshirë ushqimin, ujin e pijshëm, objektet sanitare, shëndetësinë, strehimin, arsimin dhe informacionin. Ajo varet jo vetëm nga të ardhurat, por edhe nga qasja në shërbime.[9]

**Varfëria relative** ka manifestime të shumta, përfshirë mungesën e të ardhurave dhe burimeve produktive të mjaftueshme për të siguruar një jetesë të qëndrueshme; uri dhe kequshqyerje; shëndet të dobët, mungesë aksesi ose akses i limituar në arsim dhe shërbime të tjera bazë; sëmundshmëri dhe vdekshmëri e rritur, mungesë strehimi ose strehim i papërshtatshëm, mjedis i pasigurt, dhe diskriminim dhe përjashtim social. Ajo gjithashtu karakterizohet nga një mungesë e pjesëmarrjes në vendim-marrje dhe në jetën qytetare, sociale e kulturore.[10]

**Shporta ushqimore** përcaktohet si grupimi i produkteve bazë që përbëjnë dietën zakonshme të popullsisë, në sasi të mjaftueshme për të mbuluar në mënyrën e duhur kërkesat për energji të individëve[11].

**Standard jetese i arsyeshëm** konsiderohet ai standard që plotëson nevojat fizike, psikologjike dhe sociale të një personi. Një standard jetese i arsyeshëm nuk do të thotë që një person duhet të jetojë në një nivel luksi, por as nuk nënkupton se një person duhet të jetojë vetëm në nivelin e mbijetesës. Personi që zotëron paratë duhet të jetë në gjendje që të marrë pjesë në jetën e komunitetit, njësoj si qytetarët e tjerë. Duhet të jetë e mundur për personin që të ha ushqime të shëndetshme..., të ketë rroba për mot dhe situata të ndryshme, të mbajë shtëpinë të rregullt dhe të pastër, të ketë mobilie dhe pajisje në shtëpi për pushim dhe argëtim, të jetë në gjendje që ti kushtojë kohë aktiviteteve të lira, dhe të lexojë libra, gazeta dhe të shohë televizor.[12]

---

[8] Ligji Nr. 9355, date 10.03.2005, "Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore", Neni 4, http://www.sociale.gov.al/files/userfiles/Ligj_Nr._9355,_date_10.3.2005_PER_NDIHMEN_DHE_SHERBIMET_SHOQERORE,_i_ndryshuar.doc

[9] Organizata e Kombeve të Bashkuara, Samiti Botëror mbi Zhvillimet Sociale në Kopenhagen, 1995, http://www.un.org/esa/socdev/unyin/documents/ydiDavidGordon_poverty.pdf

[10] Idem

[11] M. Flores, "Shporta Ushqimore e Familjes, Përkufizimi dhe Metodologjia", http://www.ncbi.nlm.nih.gov/pubmed/7447589

[12] Shërbimi i paaftësisë në Irlandë, "Udhëzime për një standard jetese të arsyeshëm dhe shpenzime jetese të arsyeshme", 2013, http://www.isi.gov.ie/en/isi/guidelinesundersection23-final.pdf/files/guidelinesundersection23-final.pdf

## HYRJE

Minimumi jetik është indikatori social kryesor, i cili përdoret për vlerësimin e varfërisë dhe cilësisë së jetës, si dhe për llogaritjen e pagave minimale, pensioneve minimale dhe pagesave sociale bazë. Niveli i minimumit jetik në vend njihet si shuma e parave që duhet të zotërojë çdo person për të përballuar nevojat bazë të mbijetesës së tij si qenie njerëzore (Fjalori Enciklopedik Shqiptar).[13] Mënyra tradicionale për matjen e varfërisë bazohet në të ardhurat. Një familje konsiderohet e varfër kur të ardhurat e saj bien nën një nivel minimal të nevojshëm për të plotësuar nevojat bazë të anëtarëve të saj. Në literaturën e shkruar dhe në atë elektronike ky nivel zakonisht quhet *minimumi jetik* ose *kufiri i varfërisë*. Disa nga arsyet pse është e nevojshme matja e minimumit renditen në vazhdim.

Aktualisht në vendin tonë, mungojnë të dhëna zyrtare lidhur me treguesin e minimumit jetik. Në këtë mënyrë, Shqipëria është i vetmi ndër vendet ish-socialiste të Evropës Lindore, pa një tregues zyrtar të minimumit jetik të përcaktuar, që do të thotë se në vendin tonë mungon aktualisht niveli bazë i matjes së varfërisë. Nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Banka Botërore, FMN, Sindikatat, Avokati i Popullit, dhe nga Kuvendi i Shqipërisë herë pas here janë adresuar sugjerime për qeverinë për përcaktimin e treguesit zyrtar të minimumit jetik. Në besojmë se nga ky këndvështrim, ky studim, njëherazi mund të shërbejë edhe për rishikimin e strategjive të rritjes ekonomike dhe për reduktimin e varfërisë. Treguesi i minimumit jetik përdoret edhe në studime të tjera, për t'u krahasuar me pagat, pensionet etj, por edhe me të ardhurat gjithsej të punonjësve mbi bazën e buxheteve familjare. Studimi do të shërbejë për të bërë krahasimin e minimumit jetik zyrtar për një të punësuar me pagën minimale dhe me madhësinë e pensioneve, të ndihmave sociale, të pagesës së papunësisë etj.

Studimi ka si qëllim të masë se sa është minimumi jetik në Shqipëri. Analiza përgjatë gjithë studimit tonë synon të ngrihet mbi nivelin e trajtimit të minimumit jetik si detyrim të shtetit në konsiderimin e tij si një e drejtë themelore e çdo qenieje njerëzore. Objektivat kryesorë të studimit përfshijnë llogaritjen e minimumit jetik për frymë për vitin 2015, përcaktimin e strukturës së minimumit jetik për artikujt ushqimorë, veshmbathje, pajisje dhe orendi shtëpiake dhe shpenzime të tjera; dhe krahasimin e minimumit jetik për frymë me pagën minimale, pensionin minimal, ndihmën ekonomike dhe pagesën e papunësisë me qëllim për t'i dhënë përfituesve mbrojtjen sociale të nevojshme dhe të domosdoshme për plotësimin e nevojave bazë jetike. Me synim përmirësimin e

[13] Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Akademia e Shkencave, faqe 1728

këtyre treguesve, studimi do të ofrojë dhe disa rekomandime për ndërmarrjen e politikave socio-ekonomike adekuate.

Për matjen e varfërisë përdoren dy metoda kryesore: *metoda absolute,* sipas të cilës minimumi jetik llogaritet duke përcaktuar nevojat minimale të konsumit të një "shporte" mallrash e shërbimesh dhe *metoda relative*, ku kufiri vendoset si raport i medianës (apo mesatares) së të ardhurave (apo konsumit) të popullatës në tërësi. Vendet në zhvillim përdorin metodën absolute, kurse vendet e pasura, përjashtuar SHBA, përdorin metodën relative. Çdo vend llogarit dhe miraton kufirin e varfërisë bazuar në kushtet e tij ekonomike, sociale, tradicionale etj. Ky tregues shërben për të njohur numrin e familjeve dhe të varfërve, shkallën dhe përhapjen gjeografike e territoriale të varfërisë, si dhe për të zbatuar politika e programe të diferencuara për reduktimin e saj.

Ky raport është i strukturuar në shtatë kapituj kushtuar minimumit jetik. Kapitulli i parë i studimit ofron një trajtim teorik të konceptit të minimumit jetik, aspekte të ndryshme të minimumit jetik në botë dhe Shqipëri dhe një përshkrim të metodave të ndryshme shkencore për llogaritjen e minimumit jetik. Në kapitullin e dytë pasqyrohet metodologjia e përdorur në realizimin e këtij studimi. Në kapitullin e tretë paraqitet një përshkrim i përgjithshëm i kuadrit ligjor dhe institucional të lidhur me çështjet e minimumit jetik. Më tej në kapitullin e katërt trajtohet metoda që kemi përzgjedhur dhe në kapitullin e pestë ofrohet dhe përllogaritja faktike e minimumit jetik. Me përcaktimin e minimumit jetik, kapitulli i gjashtë mbulon një diskutim mbi nevojën për indeksimin e minimumit jetik dhe një analizë të implikimeve të minimumit jetik në vend. Në përmbyllje, në kapitullin e fundit, jepen përfundimet dhe rekomandimet kryesore të studimit.

## PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Varfëria është një fenomen i përhapur në të gjithë botën dhe kudo bëhen përpjekje të shumta për të vlerësuar numrin e individëve të cilët konsiderohen të varfër. Nga përvoja e vendeve të tjera, për të matur nivelin e varfërisë përdoren tregues me emërtime të ndryshëm **si "niveli zyrtar i varfërisë", "minimumi i ekzistencës", "pragu i varfërisë", "minimumi jetik", "standardet minimale sociale" etj.** Në Shqipëri, minimumi jetik përkufizohet si niveli i të ardhurave i cili garanton që konsumi të përmbushë kërkesat minimumit të qenieve njerëzore në aspektin e nevojave fizike dhe sociale. Në trajtimin e nocionit të minimumit jetik përkufizimet e dhëna janë të shumta duke përfshirë si ato ndërkombëtare (ILO, FAO) dhe kombëtare (Kodi Penal, Fjalori Enciklopedik Shqiptar). Sipas këtij treguesi *konsiderohet si "i varfër"çdo individ i cili ndodhet "nën nivelin e minimumit jetik"*.

Në ditët e sotme për llogaritjen e minimumit jetik përdoren kryesisht dy metoda kryesore: **metoda e varfërisë absolute**, sipas të cilës *minimumi jetik llogaritet duke përcaktuar nevojat minimale të konsumit të një "shporte" mallrash e shërbimesh* dhe **metoda e varfërisë relative**, ku *kufiri vendoset si raport i medianës (apo mesatares) së të ardhurave apo konsumit të popullatës në tërësi*. Vendet në zhvillim përdorin metodën absolute, kurse vendet e pasura, duke përjashtuar SHBA-në, përdorin metodën relative. Interpretimi i rezultateve mbi nivelin e minimumit jetik ndryshon në varësi të përdorimit të të ardhurave apo konsumit në metodologjinë e përllogaritjes së tij, pra në vartësi të kësaj të fundit.

Nisur nga treguesit e minimumit jetik në vendet themeluese të Bashkimit Evropian konstatohet se përgjithësisht niveli i tij përgjatë viteve të fundit ka ardhur në rritje. Një analizë e thjeshtë krahasimore tregon se *vendet e anëtarësuara rishtazi në BE kanë një minimum jetik (kufi varfërie) dukshëm më të ulët se vendet themeluese të këtij bashkimi*. Ndërsa për vendet e Ballkanit Perëndimor, si pasojë edhe e nivelit të zhvillimit të tyre ekonomik, pasqyrohen vlera më të ulëta të pagës minimale dhe të minimumit jetik, në krahasim me vendet e tjera të BE-së. Në këtë kuadër evidentohet dukshëm fakti se *Shqipëria ofron një normë më të ulët të treguesit të pagës minimale në krahasim me vendet e rajonit*. Për një numër arsyesh që lidhen me kapacitetet dhe ekspertizën, me burimet financiare dhe njerëzore në dispozicion etj., për Shqipërinë nuk është bërë ende një përllogaritje e kufirit të varfërisë sipas metodës relative. Ndërkaq vlen të përmendet edhe fakti se *duke filluar nga viti 2018 pritet që edhe për vendin tonë të bëhet e mundur përllogaritja e këtij treguesi nga EUROSTAT*. Ndërkohë, në kushtet e mungesës së të dhënave të njësuara, një analizë krahasimore e nivelit të minimumit jetik të Shqipërisë me vendet e Ballkanit Perëndimor aktualisht është e pamundur të realizohet.

Pavarësisht kufizimeve të veta metodike duke përfshirë edhe ato që lidhen me saktësinë e burimeve të informacionit, minimumi jetik është përllogaritur për herë të parë në Shqipëri në vitet e fundit të regjimit komunist (1989), në vlerën ***450 lekë për familje*** në muaj. Me ndryshimin e sistemit, studimi i parë për përcaktimin minimumit jetik u ndërmor në vitin 1991 nga Ministria e Ekonomisë dhe Instituti i Studimeve të Ekonomisë në të cilin rezultoi ***870 lekë për familje***. Përpjekja e fundit institucionale e kryer për llogaritjen e minimumit jetik është ajo e vitit 2001 të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ku minimumi jetik u përllogarit ***7,975 lekë në muaj për frymë***. Që prej atëherë të vetmet vlerësime institucionale janë ato të INSTAT për kufirin e varfërisë për frymë, i cili u përcaktua në ***vlerën 4,891 lekë (2002); 5,272 lekë (2005); 5,722 lekë (2008) dhe 6,047 (2012)***. Kontribut në këtë fushë kanë dhënë dhe studiues të tjerë të pavarur. Në vitin 1995, studiuesi Luan Shahollari përcaktoi minimumin jetik,sipas të cilit varianti optimal në ***4,543 lekë në muaj për një familje*** me katër anëtarë. Sipas profesorit Ilia Telo, minimumi jetik për frymë llogaritej të ishte 9,058 lekë në muaj në vitin 1998. Përllogaritja e fundit te këtij treguesi u bë në vitin 2011 nga studiuesi Kiço Ziso, i cili e përllogariti minimumin jetik në nivelin e ***15,072 lekëve në muaj për frymë***. Diferencat në vlerën e minimumit jetik vijnë si pasojë e këndvështrimeve dhe metodologjive të ndryshme në trajtimin e përllogaritjes së minimumit jetik.

***Në legjislacionin aktual shqiptar ende mungon një dispozitë e posaçme kushtuar minimumit jetik,*** si për përkufizimin ligjor të tij, ashtu edhe për detyrimin ligjor për llogaritjen e tij. Përcaktimi i parë i rëndësishëm i minimumit jetik në Shqipëri u evidentua në kodin e punës së vitit 1995, por *me amendimet që i janë bërë KP në vitet në vijim, koncepti i minimumit jetik është hequr*. Referencë tjetër është ajo e Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 119, datë 08.03.2001, "Për një Shtesë Fondi në Buxhetin e Vitit 2001, të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, për Projektin "Minimumi Jetik, Zyrtar"". Që prej asaj kohe, ende nuk është përfshirë në kuadrin ligjor detyrimi i përllogaritjes së minimumit jetik dhe *nuk janë caktuar institucionet përgjegjëse për vlerësimin e këtij minimumi*. Siç dihet, në Shqipëri, niveli i pensioneve është i vendosur me ligj, ndërsa niveli i pagës minimale, madhësia në vlerë e ndihmës ekonomike, pagesës së papunësisë dhe pagesës së paaftësisë përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Asnjëri prej këtyre treguesve të varfërisë nuk bazohet drejtpërdrejt në treguesin e minimumit jetik.

Për llogaritjen e minimumit jetik në këtë studim është përzgjedhur metoda e varfërisë absolute falë avantazheve që kjo e fundit ofron. Kështu, minimumi jetik është përllogaritur mbi bazën e shportës ushqimore. Nga përllogaritjet e bëra ***minimumi jetik për frymë në vitin 2015 rezulton të jetë*** përafërsisht ***16,000 lekë në muaj*** *(7,089 lekë në muaj për shpenzimet ushqimore dhe 8,913 lekë në muaj për shpenzimet jo-ushqimore)*. Në ndryshim nga studimet e tjera mbi nivelin e minimumit jetik, **vlera e përcaktuar nga ky studim, merr në konsideratë edhe**

**aspekte sociale dhe tendencat e konsumit në vendin tonë**. Vlera e minimumit jetik përbën edhe bazën mbi të cilën duhet të llogariten pagat, pensionet sociale, ndihma ekonomike, pagesa e paaftësisë dhe pagesa e papunësisë, kuptohet duke bërë edhe rregullimet e nevojshme ne lidhje me numrin e pjesëtarëve të familjes, numrin të punësuarve prej tyre, pjesëtarët mbi dhe nën moshën e punës, asetet që zotëron familja etj. *Minimumi jetik i llogaritur prej 16,000 lekë në muaj për frymë në Shqipëri vërehet se luhatet përafërsisht në të njëjtat nivele me vendet e Ballkanit Perëndimor*, veçanërisht me Serbinë dhe Maqedoninë. Kjo ngjashmëri me vendet e rajonit rrit kredibilitetin e vlerës së përllogaritur nga ky studim.

Me qëllim për t'i siguruar individëve një jetesë me dinjitet do të ishte e nevojshme *ridimensionimi i konceptit të nivelit të minimumit jetik në atë të një standardi jetese të arsyeshëm*. ***Standard jetese i arsyeshëm*** konsiderohet ai standard i cili plotëson nevojat fizike, psikologjike dhe sociale të një personi. Një standard jetese i arsyeshëm nuk do të thotë që një person duhet të jetojë në një nivel luksi por as ***nuk nënkupton se një person duhet të jetojë vetëm në nivelin e mbijetesës***. E drejta për një standard jetese të përshtatshëm njihet si një e drejtë njerëzore edhe në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe nënkupton nevojën për të vendosur një të drejtë minimale për ushqim, veshje dhe strehim në nivelin e duhur. Prandaj, është i rëndësishëm identifikimi i të gjithë ndërhyrjeve dhe politikave sociale për kalimin nga nevoja e përcaktimit të minimumit jetik në atë të një standardi jetese të arsyeshëm në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerëzor.

*Minimumi jetik është një tregues që ka karakter dinamik* dhe që ndryshon në vartësi të zhvillimeve të ndryshme sociale dhe ekonomike. Për këtë arsye, duke synuar pasjen e një minimumi jetik real përgjatë viteve *mbetet thelbësore indeksimi periodik i tij*. Kjo për arsye se çdo përmirësim në ekonomi ka një ndikim të drejtpërdrejtë në nivelin e standardit të jetesës dhe për këtë arsye duhet të reflektohet dhe në vlerën e minimumit jetik. Për fat të keq në Shqipëri, ende *nuk kryhet indeksimi i Çmimeve të Shportës së Konsumit mbi bazën e të cilit mund të bëhet llogaritja automatike e minimumit jetik për vitet pasardhëse*.

Përmes një analize krahasimore të nivelit të minimumit jetik me atë të pagës minimale, pensionit minimal dhe atij social, ndihmës ekonomike, pagesës së papunësisë dhe pagesës së paaftësisë në vend mund të evidentojmë lehtësisht se këto pagesa ndodhen nën kufirin e minimumit jetik. Për këtë arsye, rekomandohet që në vitet që vijnë, në përputhje me mundësitë që do t"i krijohen buxhetit të shtetit, të gjithë treguesit e sipërpërmendur të kenë prirje përafrimi deri në përputhjen e plotë me vlerën e minimumit jetik, me synim për ti ofruar individëve përfitues të pagesave sociale një jetesë me dinjitet.

# 1. NJË KËNDVËSHTRIM TEORIK RRETH MINIMUMIT JETIK

Ky seksion ofron një rishikim i plotë literature për treguesin e minimumit jetik, ku ofrohet një këndvështrim teorik i minimumit jetik, një vështrim mbi metodologjitë e matjes së minimumit jetik.

## 1.1 Rishikimi i Literaturës

Koncepti i minimumi jetik lidhet gjerësisht në ekonomi me atë të varfërisë dhe pabarazisë. Varfëria sipas Bankës Botërore është pamundësia për të siguruar një nivel minimal jetik. Kontribut të veçantë në përcaktimin sasior të varfërisë ka dhënë ekonomisti i shquar *Sen*[14], i cili në trajtimin e problematikës së matjes së varfërisë ka vënë në dukje dy çështje:

i) identifikimi i individëve të varfër;

ii) agregimi i karakteristikave të të varfërve në një indikator.

Literatura mbulon çështjen e parë me metodën e të ardhurave (ose konsumit), duke përcaktuar pikërisht një niveli të minimumit jetik, e njohur ndryshe edhe si kufiri i varfërisë.[15] Kufiri i varfërisë (pragu i varfërisë ose linja e varfërisë), është niveli minimal i të ardhurave që konsiderohet i përshtatshëm në një vend të caktuar.[16] Një individ quhet i varfër nëse, sipas metodës, ai ndodhet nën kufirin e varfërisë. Mbi çështjen e dytë i njëjti autor ka sugjeruar në punimet e tij si njësi matëse përqindjen e individëve që jetojnë nën linjën e varfërisë dhe diferencën e të ardhurave mesatare të popullatës së varfër me linjën e varfërisë, e shprehur në raport me linjën e varfërisë (Sen, 1987).

Në përgjithësi minimumi jetik përkufizohet si niveli i të ardhurave i cili garanton që konsumi të përmbushë kërkesat e minimumit të qenieve njerëzore fizike dhe sociale.[17] Nga përvoja e vendeve të tjera, për të matur nivelin e varfërisë përdoren tregues me emërtime të ndryshëm si "niveli zyrtar i varfërisë", "minimumi i ekzistencës", "pragu i varfërisë", "minimumi jetik", "standardet

---

[14] A. K. Sen, "Varfëria: Një qasje rendore për matjen", Ekonometrika 44 (1976), 219–231, http://dds.cepal.org/infancia/guia-para-estimar-la-pobreza-infantil/bibliografia/capitulo-III/Sen%20Amartya%20(1976)%20Poverty%20an%20ordinal%20approach%20to%20measurement.pdf

[15] F. Bourguignon dhe S. R. Chakravarty, Banka Botërore, "Matja e varfërisë shumëdimensionale", Journal of Economic Inequality, 2003, http://siteresources.worldbank.org/INTPA/Resources/429966-1092778639630/bourguignon.pdf

[16] M. Ravallion, Varfëria "fanatike: Një udhëzues për koncepte dhe metoda. Studimet mbi Matjen e Nivelit të Jetesës", 1992, fq. 25

[17] ILO, "Metodologjia e Vlerësimit të Minimumit jetik në Kazakistan dhe Problemet e tij", 2012, http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_protect/---soc_sec/documents/publication/wcms_secsoc_33548.pdf

minimale sociale" etj. [18] Legjislacioni shqiptar nuk ofron një përkufizim të minimumit jetik në dispozitat e tij dhe për këtë arsye definicioni të cilit ne do ti referohemi vazhdimisht në këtë studim është ai i ILO-s. Sipas tij, minimumi jetik është shuma monetare e një sërë produktesh ushqimore të përshtatshme për të siguruar funksionimin normal të trupit të njeriut dhe ruajtjen e shëndetit, plus një numër minimal artikujsh jo-ushqimorë dhe një numër minimal shërbimesh të nevojshme për të përmbushur nevojat bazë sociale dhe kulturore. [19]

**Figura 1. Piramida e koncepteve të varfërisë**




KP –konsumi personal
SHSH – shërbime shtetërore

*Burimi: White dhe Killick, 2001*[20]

Piramida e Varfërisë është një ilustrim i thjeshtë i gamës së gjerë të koncepteve të përfshira në diskutimin e varfërisë. Niveli bazë i nisjes është aftësia për të marrë ushqim, strehim dhe akses në shërbimet bazë. Kjo piramidë mund të pasurohet me dimensione të tjera që zgjerojnë bazën të tilla si autonomia dhe pjesëmarrja në jetën qytetare dhe sociale. Në këtë kuadër, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (UDHR) në Nenin 25 të saj citon se "çdokush ka të drejtë për një nivel jetese të mjaftueshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij dhe familjes së tij". Kjo dispozitë përcakton disa nga elementet e kësaj të drejte: ushqimi;

---

[18] Avokati i Popullit, "Minimumi Jetik", Botim Periodik i Institucionit të Avokatit të Popullit Nr. 2, Shkurt 2015, fq. 8-10
[19] ILO, Akti Nr. 966, 15 Korrik 1999, http://ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:13100:0::NO::P13100_COMMENT_ID:3081229
[20] S. Tsenkova dhe Z.N. Budic, "Mozaiku Urban i Evropës Post-Socialiste, Hapësira, Institucionet dhe Politikat", https://books.google.al/books?id=qvbPjM-EewUC&pg=PA153&lpg=PA153&dq=poverty+line+in+CEE+countries&source=bl&ots=FXrlYAZrrE&sig=ngkmzdlzNxrDYBGgVDb4_9rG6vc&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwjS6dfspbzOAhUIMBoKHXuwDD8Q6AEIUDAI#v=onepage&q=poverty%20line%20in%20CEE%20countries&f=false

veshje; strehim; kujdes mjekësor; dhe shërbimet e nevojshme sociale."[21] Kështu, e drejta për të pasur disa të ardhura bazë i siguron çdo individi të drejtën për të jetuar në kushte të denja.[22]

Vlen të theksohet se nga studime të shumta arrihet në përfundimin se plotësimi vetëm i nevojave të konsumit personal nuk është i mjaftueshëm për të jetuar një jetë me dinjitet. Në këtë linjë, edhe Komisioni Evropian në rekomandimet e tij ka përsëritur përgjegjësinë e vendeve anëtare të BE-së në promovimin e skemave të mbështetjes së duhur me të ardhura të bazuara te "e drejta themelore e një individi në burime dhe ndihmë të mjaftueshme për të jetuar me dinjitet njerëzor, në kuadrin e një mekanizmi global dhe koherent për të luftuar varfërinë dhe përjashtimin social". [23]

Kryesisht metodologjitë e përzgjedhura për matjen e varfërisë, në tërësi kategorizohen dhe sjellin dy grupime rezultatesh: vlera të varfërisë në terma absolutë dhe vlera të varfërisë në terma relativë. Vendet në zhvillim e masin varfërinë në terma absolutë, duke u bazuar në vlerësimin monetar të konsumit të individëve sipas një shporte ushqimesh të paracaktuara (minimumi jetik). Ndërkohë vendet e zhvilluara përdorin terma relativë në matjen e varfërisë ose të rrezikut nga varfëria. Këta të fundit ndërtojnë një mediane krahasimi të standardit të jetesës në vend dhe përzgjedhin mbi bazën e argumenteve ekonomikë nivelin e quajtur në rrezik varfërie. [24] Përtej përdorimit të metodës relative apo asaj absolute, interpretimi i rezultateve mbi nivelin e varfërisë ndryshon në varësi të përdorimit të të ardhurave apo të konsumit në metodologji. Në bazë të objektivave mund të vendoset të përdoret konsumi, të ardhurat apo të dy treguesit. Të ardhurat si instrument matës të varfërisë tregojnë paaftësinë për të përmbushur një sërë nevojash. Konsumi në anën tjetër agregon pamundësinë dhe mospërmbushjen aktuale të nevojave (Garroway & Laiglesia, 2012).[25]

Megjithatë, mirëqenia e popullsisë (varfëria në krahun e kundërt), varen si nga variabla monetarë, ashtu edhe nga ata jomonetarë. Në literaturën e viteve të fundit argumentohet se edhe pse të ardhura më të larta mund të sjellin përfitime

---

[21] Neni 25, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, http://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/eng.pdf

[22] Deklarata Universale e të Drejtave në Zhvillim të Njeriut, 2009, http://www.world-governance.org/IMG/pdf_DUDHE.pdf

[23] Studio e Kërkimeve Sociale (SRS), F. Strati, "Italia: Skemat e të Ardhurave Minimale, Një Studim mbi Politikat Kombëtare", 2009, http://ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=9033&langId=it

[24] Bashkimi Evropian zbaton aktualisht rregullin e 60% të medianës kombëtare për të ardhurat e disponueshme të njehsuara, ndërkohë Banka Botërore përdor nivelin 50%.

[25] C.Garroway dhe J. R. Laiglesia, "Për rëndësinë e varfërisë relative për vendet në zhvillim", 2012, http://www.oecd-ilibrary.org/docserver/download/5k92n2x6pts3.pdf?expires=1473921275&id=id&accname=guest&checksum=6E10AF4E11F6DD542E3C3E9EF674DC3F

të tjera monetare dhe jomonetare, ekonomiksi mëson se në raste të caktuara kjo nuk është gjithmonë e mundur (Bourguignon, Chakravarty, 2003). Tregjet mund të mos ekzistojnë për disa të mira jo monetare, si në rastin e të mirave publike ose mund të jenë plotësisht jo perfektë. Për pasojë përqasja shumëdimensionale ndaj varfërisë është një zgjidhje më e mirë në përllogaritje, duke qenë se shihet qartazi që të ardhurat nuk mund të jenë indikatori i vetëm i varfërisë, por duhet të plotësohen prej variablave të tjerë si: banimi, edukimi, të mirat publike etj.[26] (Atkinson, Bourguignon, 1982) (Kolm, 1977) (Massoumi, 1986) (Tsui, 1995).

Autorë të ndryshëm mbështesin prej vitesh sa më sipër dhe në veçanti Ravaillon (1996) identifikon variabla se si mund të matet varfëria, duke theksuar se matësit monetarë të varfërie jo gjithmonë arrijnë të përfshijnë aspekte të mirëqenies që përfaqësohen nga indikatorët jo monetarë. Më tej ekspertët kalojnë edhe në atë që quhet përkufizim i varfërisë përmes indikatorëve socialë (Wratten, 1995).[27] Kjo, sepse pabarazia në vetvete nuk është vetëm pabarazi në të ardhura, por përfaqëson një gjendje jo të barabartë në status, të drejta dhe mundësi (Kombet e Bashkuara, 2015).[28] Në fusha të ndryshme pabarazia gjen zbatim dhe lidhet me elementë e nocione të dallueshme nga njeri-tjetri, por mbi të gjitha lidhet me teoritë e barazisë sociale. Pabarazia ekonomike, veçanërisht, e njohur ndryshe edhe si pabarazi e të ardhurave ose pabarazi e kushteve të jetesës, është e rëndësishme në kuadër të përmirësimit të mirëqenies së individëve apo të një popullate dhe në kuadër të hartimit të politikave. Të ardhurat në tërësi për një familje njihen vetëm si të ardhurat e disponueshme të familjeve.[29] Dhe në këtë dimension material haset një nga pikëpamjet bazë të pabarazisë: ai material i mirëqenies dhe mund të matet lehtësisht nga përqindja e pasurisë monetare që zotëron një përqindje e popullsisë. Në pamundësi për të matur gjithmonë dhe për të gjitha vendet indikatorët jo monetarë, shpesh edhe matja e pabarazisë kufizohet në ato monetarë. Pabarazia në shpërndarjen e të ardhurave matet kryesisht përmes koeficientit Gini që paraqet shifra nga 0 në 1 (ku 0 është barazi

---

[26] A. Atkinson dhe F. Bourguignon, "Krahasimi i shpërndarjeve multidimensionale të gjendjes ekonomike", fq 183–201., http://www.darp.lse.ac.uk/papersdb/Atkinson-Bourguignon_(REStud_82).pdf; K. Y. Tsui, "Përgjithësime shumëdimensionale të treguesve relative dhe absolute: Qasja e Atkinson- Kolm-Sen", fq. 251–265, http://www.ophi.org.uk/wp-content/uploads/ssTsui-1995.pdf; S. C. Kolm, "Barazia shumëdimensionale", https://www.jstor.org/stable/1883135?seq=1#page_scan_tab_contents; E. Maasoumi, "Matja dhe Zbërthimi i pabarazisë shumëdimensionale", http://www.ophi.org.uk/wp-content/uploads/ssMaasoumi-1986.pdf; M. Ravallion, "Çështjet dhe Matjet në Modelimin e Varfërisë", Jstor, https://www.jstor.org/stable/2235525?seq=1#page_scan_tab_contents

[27] E. Wratten, "Konceptualizimi i Varfërisë Urbane, Mjedisi dhe Urbanizimi" 1995, http://eau.sagepub.com/content/7/1/11.full.pdf+html

[28] Kombet e Bashkuara, Sektori i Zhvillimit të Politikave dhe Analizave, Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Sociale, "Koncepte të Pabarazisë – Çështje të Zhvillimit" Nr. 1, 2015, http://www.un.org/en/development/desa/policy/wess/wess_dev_issues/dsp_policy_01.pdf

[29] Përbëhen nga të ardhurat e punës, të vetëpunësimit dhe të ardhurat kapitale dhe transfereve të parasë publike, duke i zbritur taksat mbi të ardhurat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore të paguara nga familjet.

absolute dhe 1 pabarazi absolute). Gini nuk është matës i mirëqenies, por vetëm i pabarazisë.

Në Shqipëri përdoret përgjithësisht metoda e konsumit në përcaktimin e nivelit të varfërisë dhe Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës. Megjithatë nuk ka shifra zyrtare për sa i përket një llogaritje të minimumit jetik sipas disa standardeve specifike duke marrë parasysh të gjithë shpenzimet që një familje mund të kryejë. Niveli i minimumit jetik në vend njihet si shuma e parave që duhet të zotërojë çdo person për të përballuar nevojat bazë të mbijetesës së tij si qenie njerëzore (Fjalori Enciklopedik Shqiptar).[30] Por vlerësimi i nevojave bazë në vend për këtë përllogaritje, duhet t'i qëndrojë disa standardeve të kohës, të cilat duhet të jenë subjekt i diskutimit mes ekspertësh në mënyrë periodike.

Llogaritja e minimumit jetik është hapi i parë i suksesit në hartimin dhe menaxhimin e politikave korrekte. Në çdo rast kjo përllogaritje do ti shërbejë politikave, të cilat ministria përgjegjëse për çështjet e punës dhe mirëqenies sociale do të zbatojë për të siguruar mirëqenien e popullsisë dhe në kuadër të përcaktimit të minimumit jetik, edhe reduktimin e varfërisë më në veçanti. Mbrojtja sociale, e cila në terminologji përfshin politikat e sipërpërmendura, përbëhet nga një tërësi veprimesh të ndërmarra nga strukturat shtetërore për interes publik dhe që adresojnë riskun, vulnerabilitetin dhe varfërinë. Ato përfshijnë edhe transfertat në para, si një nga format e asistencës sociale. (Farrington & Slater, 2006). Të cilësuar si më pak e kushtueshme për buxhetin e shtetit është edhe paga minimale dhe jo vetëm ligjërimi i saj, por edhe përshtatja me kushtet ekonomike në vend. Megjithëse ekonomistët dhe ekspertët e politikave sociale mbajnë qëndrime të ndryshme ndaj secilës prej çështjeve dhe metodave të sipërpërmendura, ata pohojnë gjithashtu se zvogëlimi i varfërisë nuk është vetëm objektiv i politikave të pagës minimale apo transfertave.

## 1.2 VËSHTRIM MBI METODAT E MATJES SË MINIMUMIT JETIK

Për përcaktimin e minimumit jetik ekzistojnë koncepte dhe kritere të shumta. Një ndër to është varfëria, e cila klasifikohet në varfëri absolute dhe varfëri relative. Varfëria absolute përfaqësohet nga minimumi jetik ose vlera e ushqimeve të konsumit ndërkohë që varfëria relative llogaritet nga raporti i medianës së të ardhurave ose konsumit. Për përcaktimin e kufirit të varfërisë përdoren ndonjëherë dhe linja alternative të varfërisë. Ato përcaktohen mbi bazën e matjeve subjektive ose të vetë raportuara të varfërisë. Kjo teknikë lejon marrjen në konsideratë të pabarazisë dhe pozicionin relativ të familjeve duke njohur rëndësinë e një minimumi absolut nën të cilin jetesa është e pamundur.

---

[30] Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Akademia e Shkencave, faqe 1728

### 1.2.1 Metoda e Varfërisë Absolute

**Varfëria absolute** përcaktohet si një gjendje e karakterizuar nga privimi i rëndë i nevojave themelore të njeriut, duke përfshirë ushqimin, ujin e pijshëm, objektet sanitare, shëndetësinë, strehimin, arsimin dhe informacionin. Ajo varet jo vetëm nga të ardhurat, por edhe nga qasja në shërbime.[31]

Metoda absolute për përcaktimin e varfërisë fillon me konceptin e "minimumit jetik", i cili përfshin një grup të mirash dhe shërbimesh që konsiderohen si thelbësore për nevojat fizike të një individi ose familjeje. Ata të cilët nuk zotërojnë burimet ekonomike për të për të marrë këto të mira dhe shërbime konsiderohen të varfër. Për përcaktimin e kufirit absolut të varfërisë janë përqafuar disa standarde mbi atë çka familjet duhet të kenë për të plotësuar nevojat e tyre themelore. Në këtë mënyrë llogaritja e kufirit absolut të varfërisë bazohet mbi vlerën e nevojave ushqimore bazë, në të cilën përfshihet dhe një ndarje për nevojat jo-ushqimore. Kjo metodë analize është përdorur më shumë në fillimin e shekullit XIX por me zhvillimin e shoqërisë dhe pritshmërinë për një cilësi më të mirë jetese, studiuesit në ditët e sotme e përdorin rrallë metodën absolute. Megjithatë, për vendet në zhvillim ku pjesa më e madhe e popullsisë mbijeton me minimumin ose më pak, është shpesh më e rëndësishme përdorimi i metodës absolute se i asaj relative. [32]

*Metoda e llogaritjes sipas marrjes së energjive ushqimore* e përcakton kufirin e varfërisë duke vlerësuar shpenzimet e konsumit ose nivelin e të ardhurave në të cilat marrja e energjive ushqimore tipike për një person është e mjaftueshme vetëm për të përmbushur një nevojë të paracaktuar të energjisë ushqimore.

*Metoda e kostos së nevojave bazë* vlerëson një paketë të qartë ushqimore që konsumohet tipikisht nga të varfrit me çmimet e para lokale. Për këtë, shtohet një kompensim i veçantë për mallrat jo-ushqimore, në përputhje me shpenzimet e shtresës së varfër.

Sipas kësaj metode minimumi jetik përfshin koston e shportës ushqimore dhe koston e produkteve jo-ushqimore. Kështu për llogaritjen e kostos së nevojave bazë në një vend, është e nevojshme ndërtimi i një diete model dhe llogaritja e kostos së asaj diete, duke llogaritur shumën e kalorive që nevojiten për një muaj për një individ mesatar, duke përcaktuar grupe ushqimore do të përfshihen në këtë dietë, duke vendosur përqindjen e kalorive që duhet të zënë proteinat, yndyrnat dhe karbohidratet dhe duke identifikuar kostot e secilit produkt ushqimor për të llogaritur koston totale të shportës. Së fundmi përcaktohen dhe kostot jo-

[31] Idem
[32] Banka Botërore, "Zgjedhja dhe Matja e një Kufiri Varfërie", 2015, http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/TOPICS/EXTPOVERTY/EXTPA/0,,contentMDK:20242879~menuPK:435055~pagePK:148956~piPK:216618~theSitePK:430367,00.html

ushqimore mujore në varësi të përqindjes që zënë shpenzimet e tjera te konsumit që nuk shkojnë për ushqim në anketën e matjes së nivelit të jetesës dhe bëhet llogaritja e kostos totale të nevojave bazë në vend.[33]

### 1.2.2 Metoda e Varfërisë Relative

**Varfëria relative** ka manifestime të shumta, përfshirë mungesën e të ardhurave dhe burimeve produktive të mjaftueshme për të siguruar një jetesë të qëndrueshme; urinë dhe kequshqyerjen; shëndetin e dobët, mungesën e aksesit ose akses i limituar në arsim dhe shërbime të tjera bazë; sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë e rritur, mungesën e strehimit ose strehim i papërshtatshëm, mjedisin e pa sigurt, diskriminimin dhe përjashtimin social etj. Ajo gjithashtu karakterizohet nga një mungesë pjesëmarrjeje në vendim-marrje dhe në jetën komunitare, sociale e kulturore.[34]

Kufiri i varfërisë relative përcaktohet nga shpërndarje e përgjithshme e të ardhurave ose konsumit të një vendi. Për shembull, kufiri i varfërisë mund të vendoset te 40%, 50%, 60% ose 75% e të ardhurave ose konsumit mesatar të një vendi. Sipas metodës së varfërisë relative, vlera mesatare e të ardhurave kombëtare përfaqëson një tregues ekonomik, i cili korrespondon me stilin dominues të jetesës. Një individ ose familje, të ardhurat e të cilit janë më të ulëta se ajo vlerë, përcaktohen të jenë në pragun e varfërisë dhe në pamundësi për të jetuar atë stil jetese.[35]

Përllogaritja e këtij treguesi shpjegohet në vazhdim. Fillimisht mblidhen të gjitha të ardhurat monetare të marra nga çdo anëtar i një familjeje që përfshijnë të ardhurat nga puna, nga investimet dhe nga përfitimet sociale, plus çdo e ardhur tjetër e familjes (taksat dhe kontributet sociale që janë paguar zbriten nga kjo shumë);

Për të bërë dallimet në madhësitë e ekonomisë familjare dhe në përbërjen e saj, të ardhurat gjithsej (neto) të familjes ndahen sipas "të rriturve ekuivalentë", duke përdorur një shkallë standarde (ekuivalence): OECD e ka modifikuar shkallën:

- 1 për të rriturin primar;
- 0.5 të dytit dhe çdo personi tjetër mbi moshën 14;
- 0.3 për çdo fëmijë të moshës nën 14 vjeç.

---

[33] R. Anker, "Një metodologjie e re për vlerësimin e kufirit të varfërisë dhe normës së pagës së jetesës të krahasueshme ndërkombëtarisht", 2005, http://www.ilo.int/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---integration/documents/publication/wcms_079165.pdf

[34] Kombet e Bashkuara, 1995,

[35] ILO, "Metodologjitë e Përcaktimit të Minimumit Jetik: Mënyrat dhe Përqasjet për Përmirësim", 2012, http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_protect/---soc_sec/documents/publication/wcms_secsoc_33548.pdf

Shifra e përllogaritur është quhet shuma e të ardhurave të disponueshme ekuivalente dhe i atribuohet në mënyrë të barabartë çdo anëtari të familjes.[36] Kështu, çdo anëtar i familjes ka në dispozicion të njëjtat të ardhura, qoftë i rritur apo fëmijë.

Metoda matjes së varfërisë relative pasqyron bindjen se privimet më të rëndësishme duhet të gjykohen në lidhje me mirëqenien e shumicës së shoqërisë. Përcaktimi i varfërisë në këtë mënyrë, shmang përcaktimin e "nevojave absolute" dhe vë theksin në shpërndarjen e barabartë të të ardhurave. Në këtë kuptim pabarazia merr rëndësi si një komponent privimi. Si e tillë, varfëria relative mund të reduktohet por asnjëherë të eliminohet, përveç rastit ekstrem kur në të cilin arrihet plotësisht barazia.[37] Ithtarët e përqasjes relative i kërkojnë qeverisë të ndërmarrë politika për rishpërndarjen e pasurisë me qëllim trajtimin e problematikës së varfërisë. Metoda e varfërisë relative përdoret në shumë vende të zhvilluara, sidomos ato të OECD-së, Australi, Danimarkë, Irlandë, Norvegji dhe Mbretëri e Bashkuar

### 1.2.3 Metoda e Standardeve të Buxhetit

Metoda e standardeve të buxhetit mbështetet në përcaktimin e listës së nevojave. Personat të cilët nuk janë të aftë të marrin të gjithë produktet në listë konsiderohen të varfër. Kjo është një metodë absolute në strukturë, por nevojat e ndryshme shoqërore të përcaktuara si thelbësore përfshihen për të formuar një grup buxhetesh. Në këtë kuptim, përcaktimi i standardeve të buxhetit mbështetet në shportën e mallrave dhe shërbimeve, duke përfshirë elementët "jetik" dhe "minimumet bazë për jetën sociale".[38]

Në praktikë, një inventar i standardeve të buxhetit mblidhet duke përcaktuar përbërësit bazë të jetesës njerëzore. Një listë e tillë mund të përfshijë minimumin e ushqimeve, veshjeve, strehimit dhe karburantit. Këtu mund të shtojmë dhe transportin apo shpenzime për aktivitete të tjera në mos nuk janë absolutisht thelbësore konsiderohen si të përshtatshme. Personat të cilët nuk përballojnë të gjitha këto produktet klasifikohen si të varfër.

Kjo metodë është përdorur nga organizata ndërkombëtare si BB dhe ILO. Komponentët e standardeve të buxheteve janë ushqimi, transporti, veshmbathja, energjia elektrike dhe karburanti, të mirat shtëpiake, të mirat personale, aktivitetet sociale, shpenzimet shëndetësore, mobiliet dhe pajisjet elektroshtëpiake. Normat e rekomanduara për secilin komponent jepen në varësi

---

[36] Për më tepër referojuni: Shpjegime Statistikore, Eurostat, 2016, http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Glossary:Equivalised_disposable_income
[37] J. Morduch, "Konceptet e Varfërisë", https://wagner.nyu.edu/files/faculty/publications/conceptsofpoverty.pdf
[38] E. Liu dhe J.Liu, "Llogaritja e Varfërisë", 1998, http://www.legco.gov.hk/yr97-98/english/sec/library/07plc.pdf

të moshës së përfituesit. Shuma e pagesave përcaktohet në nivele që janë të mjaftueshme për ti lejuar përfituesve të kenë burime të mjaftueshme ekonomike dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet sociale.

### 1.2.4 Metoda e Përafrimit të të Ardhurave

Metoda e përafrimit të të ardhurave është një përqasje e mënyrës së sjelljes që bazohet në modelet e konsumit të njerëzve. Të dhënat e shpenzimeve familjare përdoren si një përafrim të të ardhurave për matjen e varfërisë. Teoria bazohet në faktin se modelet e konsumit të kompozimeve të familjeve të ndryshme janë rezultat i konkurrencës relative midis nevojës dhe zgjedhjes. Kështu, mbizotërimi i nevojës ose zgjedhjes varet nga sasia e të ardhurave të fituara (grumbulluara) nga familjet. Në terma praktikë, familjet me të ardhura të ulëta shpenzojnë pjesën më të madhe të shpenzimeve në nevoja, ndërsa familjet në gjendje më të mirë ekonomike blejnë më shumë mallra të cilësisë se nevoja. Prandaj, nëse hulumtuesit ose qeveritë identifikojnë peshën e shpenzimeve të nevojave ndaj shpenzimeve totale nga të dhënat e shpenzimeve familjare ata mund të ndërtojnë një prag varfërie.

**Tabela 1. Metodat e ndryshme për përcaktimin e varfërisë dhe minimumit jetik**

| Metoda | Koncepti | Avantazhet | Disavantazhet |
|---|---|---|---|
| **Varfëria absolut e** | "Minimumi jetik" | - Matje e qartë e varfërisë në çdo kohë<br>- Krahasueshmëria e shkallës së varfërisë nëpër shoqëri të ndryshme dhe ndër vite, duke qenë se matet në mënyrë të njëjtë duke përdorur standarde të ngjashme<br>- Në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme, ku është dominuese varfëria absolute, zakonisht preferohet një kufi varfërie absolute për të identifikuar ata në nevojë absolute për ndërhyrje. | - Përcaktimi i varfërisë ndryshon me kohën<br>- Vështirësia në përcaktimin e "nevojave bazë", të cilat variojnë në individë të ndryshëm në varësi të metabolizmit dhe nivelit të tyre të aktivitetit<br>- Nevojat e njeriut interpretohen vetëm si nevoja fizike dhe nuk merr në konsideratë nevojat sociale të qenieve njerëzore<br>- Mund të matet vetëm me konsumin e kalorive dhe është e vështirë të përcaktosh sasinë dhe koston e nevojave të ekzistencës<br>- Në vendet e pasura, një kufi varfërie absolute nuk siguron informacion të rëndësishëm<br>- Është e vështirë ndërtimi i një kufiri absolut varfërie i cili është i vlefshëm për shoqëri dhe kohë të ndryshme |
| **Varfëria relative** | Një indikator relativ për vlerën e të ardhurave kombëtare | -Në vendet e zhvilluara ku varfëria absolute ose mjerimi është shumë i ulët ka më tepër kuptim përdorimi i metodës së varfërisë relative | -Nuk lejon krahasimet ndërmjet vendeve ose ndër vite pasi ato nuk pasqyrojnë të njëjtin nivel mirëqenieje.<br>- Sipas kësaj përqasje një përqindje fikse e popullsisë konsiderohet gjithmonë si e varfër përveç rastit ekstrem kur arrihet plotësisht barazia<br>-Kjo metodë varet nga shpërndarja e konsumit dhe jo në nivelin e konsumit. Nëse konsumi i të gjithë individëve në një vend dyfishohet, varfëria do të mbetet e pandryshueshme<br>-Varësia nga shpërndarja, çka do të thotë se nëse të varfrit varfërohen më shumë ulet mediana e konsumit, ulet kufiri i varfërisë dhe ulen matjet e varfërisë; dhe nëse të pasurit bëhen më të pasur rritet mediana e konsumit, rritet kufiri i varfërisë |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | dhe rritjen matjet e varfërisë.<br>-Kjo metodë jep një përllogaritje të numrit të të varfërve por jo të cilësisë së jetesës së të varfërve dhe të informacionit të asistencës për të cilën ato kanë nevojë për të pasur një standard të pranueshëm jetese. |
| **Standardet e buxhetit** | "Minimumi jetik" plus minimumin bazë për një jetë sociale | - Ato nuk janë arbitrarë, pasi ndërtohen për të përftuar një shportë mallrash dhe shërbimesh që përfaqësojnë një standard të caktuar jetese | - Zgjedhja e nevojave mbetet e diskutueshme<br>- Implikimi i gjykimit subjektiv në përditësimin e nevojave<br>- Puna për përditësimin e një buxheti shpenzimesh është shumë e madhe dhe e kushtueshme |
| **Përafrimi i të ardhurave ("income proxy")** | Model konsumi ku konkurrenca midis zgjedhjes dhe nevojës është e varur nga niveli i të ardhurave | - Modeli merr në konsideratë karakteristikat personale te familjeve që lidhen me varfërinë për të identifikuar nevojat bazë të konsumit | - Modeli i konsumit ndryshon me zhvillimet sociale<br>- Puna për përditësimin e të dhënave të rëndësishme kërkon burime shumë të mëdha, në kohë dhe në para<br>- Përkufizimet konkrete të nevojave janë gjithmonë të diskutueshme |

*Burimi: Përpunim i Autorit, 2016*

## 2. METODOLOGJIA E STUDIMIT

Studimi i "Llogaritjes së Minimumit Jetik" është zhvilluar duke përdorur të dhënat sasiore të disponueshme, statistika dhe informacionet nga burime dytësore si dhe të dhëna cilësore të përfituara nga konsultat me ekspertë të nivelit të lartë. Informacioni i marrë ka shërbyer si një bazë e fortë për përcaktimin e minimumit jetik dhe do të shërbejë për monitorimin e indikatorëve social të lidhur me të në periudhat e ardhshme, duke krijuar kështu mënyra për përafrimin e këtyre indikatorëve social me nivelin e minimumit jetik. Studimi është bazuar në burime parësore dhe dytësore. Metodat bazë të vlerësimit të përdorura janë kërkimi dytësor i materialeve dhe kërkimi cilësor nëpërmjet konsultave me ekspertë të nivelit të lartë të fushës.

### 2.1 RISHIKIMI I TË DHËNAVE DYTËSORE

Siç mund të shihet edhe nga seksioni i mësipërm, përmes rishikimit të literaturës dhe studimeve të mëparshme në Shqipëri dhe në botë, është bërë një përpjekje për tu thelluar në kuptimin e minimumit jetik dhe metodave për llogaritjen e tij në vende të ndryshme, për të shërbyer si referim përgjatë analizës në studimin tonë. Kërkimi dytësor i materialeve përfshin grupimin e:

- të dhënave dhe raporteve ekzistuese nga burime të ndryshme publike të publikuara nga institucionet shtetërore dhe jo shtetërore,
- të dhëna të hulumtuara në internet, artikuj në mas-mediat e shkruara dhe audio-vizuale nga gazetarë profesionistë të fushës,
- raporte të organizatave ndërkombëtare etj.

Të gjitha të dhënat e mbledhura kanë shërbyer për të krijuar një vlerësim të përgjithshëm të situatës në veçanti lidhur me kuadrin institucional dhe ligjor të minimumit jetik. Krahasimi me vende të tjera është konsideruar gjithashtu i rëndësishëm për studimin në tërësi dhe për krijimin/zhvillimin e një plani pune për llogaritjen e minimumit jetik.

### 2.2 GRUMBULLIMI I TË DHËNAVE PRIMARE

Kërkimi parësor përfshin konsultat me ekspertët e nivelit të lartë, specialistë të fushës të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë me këtë tematikë dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme si INSTAT, Instituti i Shëndet Publik, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, Shërbimi Social Shtetëror, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Avokati i Popullit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë etj. Konsultat me këto ekspertë të fushës ose njohës të mirë të minimumit jetik shërbejnë për të bërë një përllogaritje sa më të saktë të treguesit të minimumit jetik. Këto konsulta kanë si qëllim ofrimin e një kuadri më të plotë dhe të qartë të asaj që përfaqëson llogaritja e minimumit jetik në Shqipëri. Takimet e zhvilluara nga ACER kanë arritur të prekin tre grupe kryesore aktorësh: institucionet publike, struktura joqeveritare dhe studiues të pavarur apo akademikë.

## 2.3 KUFIZIMET E STUDIMIT

Proçesi i mbledhjes së të dhënave primare dhe sekondare të studimit ka qenë subjekt i kufizimeve të përmendura në vijim:

- Në kuadrin ligjor dhe rregullativ shqiptar primar mungon një *përkufizim i plotë dhe i qartë i konceptit të minimumit jetik dhe i nocioneve të tjera të lidhura me të* si kufiri i varfërisë, të cilat janë me interes të zbatimit të këtij studimi.

- *Informacioni dhe të dhënat bazë zyrtare që prodhohen aktualisht në Republikën e Shqipërisë janë të pamjaftueshme për zbatimin e dy metodave kryesore të përllogaritjes së minimumit jetik*. Për llogaritjen e minimumit jetik sipas metodës relative është i rëndësishëm raportimi i të dhënave mbi të ardhurat e familjes të barasvlershme sipas metodologjisë së EUROSTAT. Përpjekjet e INSTAT për të ndërtuar bazën e plotë të të dhënave për llogaritjen e kufirit të varfërisë janë në fillimet veta dhe pritet që nga fundi i vitit 2017 të jenë të disponueshme për qëllime studimore.[39]

- Vihet re një *mungesë dhe inkonsistencë në të dhënat e varfërisë sa u takon viteve të shkuara* në Shqipëri dhe për vendet e tjera të rajonit. Kufizim me ndikim të rëndësishëm është edhe *mungesa e përditësimit të të dhënave që mund t'i shërbejnë këtij qëllimi për vitin 2014 dhe 2015* nga disa institucione dhe agjenci publike.

- Vihet re *një mungesë dhe vështirësi në aksesimin e të dhënave zyrtare të nevojshme për përllogaritjen e minimumit jetik*. Kështu p.sh mungon informacioni rreth studimit për përcaktimin e minimumit jetik te kryer në vitin 1991 nga Ministria e Ekonomisë dhe Instituti i Studimeve të Ekonomisë. Gjithashtu nuk është publikuar as studimi i ndërmarrë nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për përcaktimin e "minimumit jetik zyrtar" në vitin 2001. Për të vazhduar më tej, mungojnë të dhëna publike të plota (për shportën ushqimore) për sa i përket mënyrës së llogaritjes së kufirit të varfërisë për frymë nga INSTAT.

[39] Komunikimi zyrtar me INSTAT për nevojat e zbatimit të projektit

# 3. NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI MINIMUMIN JETIK

## 3.1 Aspekte të Minimumit Jetik në Kontekst Global

Në përgjithësi, minimumi jetik në botë përcaktohet duke u mbështetur në nivelin e të ardhurave kombëtare i cili garanton që konsumi të përfshijë kërkesat minimale të qenieve njerëzore: fizike dhe sociale. Në këtë mënyrë minimumi jetik përdoret më pas si referencë për përcaktimin e pagës minimale, pensionit minimal dhe pagesave të tjera sociale. Sipas Bankës Botërore, konsiderohen individë të varfër ata të cilët jetojnë me më pak se 1.9 dollarë në ditë. [40]

Bota ku jetojmë është në zhvillim të vazhdueshëm dhe nga pikëpamja ekonomike paraqet indikatorë dhe produkte të ndryshme të politikave të ndërmarra në çdo vit. Pabarazia e ditëve të sotme shihet qartazi në krahasimet midis vendeve, në jetesë, punësim, edukim, konsum të përditshëm, në përfitimin e të mirave bazë, në përfitimin e shërbimeve bazë etj. Treguesit e varfërisë dhe pabarazisë janë të shumtë dhe të bazuar në metodologji të ndryshme. Megjithatë për të përcaktuar një madhësi të varfërisë duhet të merren në konsideratë tre përbërës bazë: dimensioni dhe treguesit e mirëqenies; përzgjedhja e linjës së varfërisë; masa e varfërisë do të raportohet për popullsinë në tërësi apo për një nëngrup të popullsisë.

Dimensioni i mirëqenies merr rëndësi të veçantë në matje apo në përcaktimin e metodologjisë, sipas Bankës Botërore. Kjo ndodh, sepse metodat e përzgjedhura si më të përshtatshmet të zbatuara nga organizatat ndërkombëtare, nuk janë të shumta, por janë komplekse në zbatim. Dy mënyrat kryesore të përcaktimit të indikatorëve monetarë të mirëqenies janë përmes konsumit dhe përmes të ardhurave. Ndërkohë indikatorët jo monetarë përfshijnë varfërinë shëndetësore apo të të ushqyerit, varfërinë në edukim dhe indekse komplekse të mirëqenies. [41] Në përputhje me faktorët dhe metodat e përllogaritjes së varfërisë dhe duke marrë në konsideratë ndryshueshmërinë në zhvillimin ekonomik të ekonomive në botë, grupimet ekonomike të individëve të punësuar mund të klasifikohen si më poshtë, përmes metodës së PBB-së/frymë.[42]

---

[40] Banka Botërore, "Kufiri Ndërkombëtar i varfërisë", http://www.worldbank.org/en/topic/poverty/brief/global-poverty-line-faq

[41] Banka Botërore, A.Coudouel, J. S. Hentschel, dhe Q. T. Wodon, Teknikat Kryesore dhe Problematikat Ndërsektoriale, Kapitulli 1. Matja e Varfërisë dhe Analiza, http://siteresources.worldbank.org/INTPRS1/Resources/383606-1205334112622/5467_chap1.pdf

[42] ILO, S. Kapsos, E. Bourmpoula, Punësimi dhe Klasat Ekonomike në një Botë në Zhvillim, 2013, http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---inst/documents/publication/wcms_216451.pdf

**Tabela 2. Përkufizimi i grupeve ekonomike**

| Grupi | Kategoria | Konsumi familjar për Frymë |
|---|---|---|
| Grupi 1 | Varfëri Ekstreme/Absolute | < $1.25 USD |
| Grupi 2 | Varfëri Moderuar | $1.25 USD - $2 USD |
| Grupi 3 | Afërsisht të Varfër | $2 USD - $4 USD |
| Grupi 4 | Klasë e Mesme në Zhvillim | $4 USD - $13 USD |
| Grupi 5 | Klasë e Mesme e Zhvilluar dhe më sipër | > $13 USD |

*Burimi: Ravaillon, 1996*

Grupi i parë i shkon përshtat përkufizimit të varfërisë ekstreme të përdorur në Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, ndërsa grupi i dytë është në një linjë me matjen ndërkombëtare të varfërisë së moderuar. Grupi i tretë, ndërtohet për të matur ato të cilët nuk janë të varfër, por janë shumë afër rrëshqitjes në varfëri. Ndërkohë grupi i katërt përfshin ato të cilët mund të përballojnë mallra dhe shërbime jothelbësore, duke përfshirë dhe disa mallra të konsumit ndërkombëtar, dhe kanë të ngjarë të kenë nivel më të lartë arsimi dhe aksesi në shërbimin shëndetësor cilësor më shumë se grupet më të ulëta. Së fundmi, në grupin e pestë përfshihen ato të cilët janë në gjendje të përballojnë një gamë të gjerë të mallrash konsumi ndërkombëtar.

Përllogaritja e një minimumi jetik është i rëndësishëm pasi ky i fundit shërben si kufi varfërie që na ndihmon të përcaktojmë numrin e të varfërve në vend. Kështu, kufiri i varfërisë synon që të analizojë shtrirjen dhe natyrën varfërisë në një vend dhe të vlerësojë rezultatet e politikave publike. Më specifikisht, kufiri i varfërisë kombëtar përdoret për të analizuar performancën dhe ndikimin e politikave të mbrojtjes sociale në reduktimin e varfërisë.

### 3.1.1 Minimumi Jetik në SHBA

Kufijtë e varfërisë janë përllogaritur për herë të parë në SHBA në vitet "60 nga M. Orschansky për një familje tipike me katër persona. Minimumi jetik u përcaktua përmes kostos minimale të një diete të shëndetshme ushqimore. Kjo kosto minimale shumëzohej me tre, me supozimin se ushqimet tipikisht përfaqësojnë një të tretën e shpenzimeve të një familjeje. Kështu, çdo familje të ardhurat e të cilës ishin më të ulëta se trefishi i kostos minimale të dietës ushqimore klasifikohej si e varfër. [43] Në vitin 1963, shpenzimet për produkte ushqimore në vit ishin 1,033 $, çka do të thotë se kufiri i varfërisë për familje rezultonte 3,100 $.

[43] P. Ruggles, "Matja e Varfërisë", 1992, http://www.irp.wisc.edu/publications/focus/pdfs/foc141a.pdf

Veçori në SHBA mbetet Programi Suplementar i Ndihmës Ushqimore që filloi në 1964, i cili nëpërmjet kuponave ushqimorë siguronte ndihmë për individët dhe familjet nën kufirin e varfërisë. Ngjyra e kuponit përcaktonte dhe vlerën e produkteve ushqimore që mund të bliheshin me të. Në fund të viteve "90 programi i kuponëve ushqimore u zhvillua në sistemin e specializuar të "debit-card", të njohur si Programi i Ndihmës Suplementare Ushqimore. Programi i kuponave ushqimore ka një rëndësi të veçantë jo vetëm në luftën kundër varfërisë por edhe në nxitjen e zhvillimit të industrisë agro-ushqimore amerikane.[44]

Ende sot përtej kritikave të konsiderueshme, kufiri i varfërisë i përcaktuar sipas Orchansky ka pësuar vetëm ndryshime të vogla por gjen akoma përdorim dhe sot. Ky kufi varfërie është përshtatur me indeksin e çmimeve të konsumit. [45] SHBA është i vetmi vend i zhvilluar i cili vazhdon të përdorë metodën e varfërisë absolute për përcaktimin e minimumit jetik. Sipas kësaj metode, në vitin 2014 kufiri i varfërisë ishte 12,071$ për frymë në vit dhe 15.4 përqind e popullsisë amerikane konsiderohej e varfër (me të ardhura nën minimumin jetik).[46]

### 3.1.2 Minimumi Jetik në Vendet Themeluese të Bashkimit Evropian

Në klasifikime të ndryshme si ai i Kombeve të Bashkuara, vendet e BE-së cilësohen si vende të zhvilluara, dhe si rrjedhojë pritshmëritë ekonomike për to janë të larta. Në secilin prej vendeve anëtare minimumi jetik llogaritet në kufirin e 60 përqind të medianës të të ardhurave të barasvlershme të familjeve në shkallë vendi. Një familje konsiderohet relativisht i varfër nëse ka të ardhura nën këtë kufi të minimumit jetik.[47] Në tabelën 3, jepet një përmbledhje e minimumit jetik për frymë dhe për një njësi familjare në muaj për vendet kryesore të Bashkimit Evropian.

---

[44] Instituti i Sociologjisë, "Shteti i Mirëqenies Sociale – Arritjet, Mangësitë dhe Rrugët e Përmirësimit", 2011, fq. 41-44
[45] P. Ruggles, "Matja e Varfërisë", 1992, http://www.irp.wisc.edu/publications/focus/pdfs/foc141a.pdf
[46] Kombet e Bashkuara, "Guidë për Vlerësimin e Varfërisë", 2016, https://www.unece.org/fileadmin/DAM/stats/documents/ece/ces/ge.15/2016/Sem/WP4_Chapter_2_ENG.pdf
[47] Një njësi familjare sipas Eurostat nënkupton dy të rritur me dy fëmijë në moshën 14 vjeç

**Tabela 3. Minimumi jetik në vendet e Bashkimit Evropian (në euro)**

| Viti | 2013 | | 2014 | | 2015 | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Vendi** | Për Frymë | Për një njësi familjare | Për Frymë | Për një njësi familjare | Për Frymë | Për një njësi familjare |
| Belgjikë | 1,074 | 2,256 | 1,085 | 2,279 | 1,083 | 2,274 |
| Danimarkë | 1,372 | 2,882 | 1,393 | 2,925 | 1,418 | 2,978 |
| Gjermani | 979 | 2,056 | 987 | 2,072 | * | * |
| Irlandë | 953 | 2,002 | 974 | 2,045 | * | * |
| Greqi | 419 | 879 | 384 | 806 | 376 | 790 |
| Spanjë | 676 | 1,420 | 663 | 1,393 | 668 | 1,402 |
| Francë | 1,046 | 2,197 | 1,060 | 2,226 | * | * |
| Itali | 787 | 1,652 | 788 | 1,655 | * | * |
| Luksemburg | 1,665 | 3,497 | 1,716 | 3,604 | * | * |
| Holandë | 1,042 | 2,188 | 1,045 | 2,194 | 1,058 | 2,221 |
| Austri | 1,104 | 2,318 | 1,161 | 2,437 | 1,163 | 2,442 |
| Portugali | 409 | 859 | 411 | 864 | 422 | 886 |
| Finlandë | 1,164 | 2,444 | 1,185 | 2,489 | 1,188 | 2,495 |
| Suedi | 1,321 | 2,774 | 1,356 | 2,848 | * | * |
| Mbretëri e Bashkuar | 935 | 1,963 | 1,026 | 2,155 | 1,047 | 2,199 |

*Burimi: Eurostat, 2016*[48]*, * - të dhënat mungojnë*

Vlen të përmendet se minimumi jetik në pothuajse të gjitha vendet themeluese të Bashkimit Evropian nga viti 2013 ne 2015 ka ardhur përgjithësisht në rritje. Përjashtim nga ky trend bën vetëm Greqia dhe Spanja, ku si pasojë edhe e vështirësive ekonomike dhe rritjes së papunësisë, minimumi jetik për frymë ka ardhur në ulje.

Në trajtimin e kuadrit të Bashkimit Evropian mbi minimumin jetik dhe politikat sociale po japim më poshtë disa shifra mbi përqindjen e popullsisë në rrezik varfërie të

[48] Eurostat, 2016, http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=ilc_li01&lang=en

disagreguara sipas gjinisë. Në totalin e tyre vendet e Bashkimit Evropian tregojnë për një risk ndaj varfërisë më të lartë për gjininë femërore në raport me atë mashkullore. Mesatarja e përllogaritur edhe EU 15 (me vendet përbërëse si më poshtë në tabelë) është po ashtu e ngjashme, duke treguar një risk më të lartë për femrat. Ndërkohë që vende si Danimarka dhe Spanja paraqesin një risk më të lartë për gjininë mashkull, për pjesën tjetër të vendeve dukuria është e anasjelltë. Hendekun më të madh në disfavor të femrave e shohim në vende si Estonia, Italia dhe Suedia.

**Tabela 4. Përqindja e popullsisë në rrezik varfërie në vitin 2014**

| Emërtimi | Total | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|
| BE (28 vende) | 17.2 | 16.7 | 17.7 |
| BE (15 vende) | 17.0 | 16.4 | 17.6 |
| Belgjikë | 15.5 | 15.0 | 15.9 |
| Danimarkë | 12.1 | 12.4 | 11.8 |
| Gjermani | 16.7 | 15.9 | 17.4 |
| Irlandë | 15.6 | 15.2 | 16.1 |
| Greqia | 22.1 | 22.2 | 22.0 |
| Spanjë | 22.2 | 22.4 | 22.1 |
| Francë | 13.3 | 12.6 | 14.1 |
| Itali | 19.4 | 18.4 | 20.5 |
| Luksemburg | 16.4 | 16.3 | 16.6 |
| Holandë | 11.6 | 11.3 | 11.9 |
| Austri | 14.1 | 13.3 | 14.9 |
| Portugali | 19.5 | 18.9 | 20.0 |
| Finlandë | 12.8 | 12.3 | 13.3 |
| Suedi | 15.1 | 13.9 | 16.3 |
| Mbretëri e Bashkuar | 16.8 | 16.0 | 17.6 |

*Burimi: Eurostat, 2016*[49]

[49] Eurostat, 2016, http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do

Në totalin e treguesve të paraqitura vendet grupohen edhe sipas disa kategorive ku në këtë tabelë shohim: Vende me një popullsi më të madhe të ekspozuar ndaj rrezikut të varfërisë (mbi 20 përqind): Greqia, Spanjë, Itali, Portugali; Vende në risk të lartë varfërie (16-19 përqind): Gjermani, Mbretëria e Bashkuar, Luksemburg; Vende në risk varfërie mbi mesataren (13-15 përqind): Belgjikë, Irlandë, Francë, Austri, Suedi, Finlandë; Vende me risk varfërie nën mesatare (10-12 përqind): Danimarkë, Holandë. Kategoria e fundit do të ishte ajo e normave të ulëta të riskut të varfërisë (nën 9 përqind). Në vitin 2014 asnjë nga vendet e BE-së nuk e ka arritur këtë nivel.[50, 51]

Drejtimi i strukturave të BE përpiqet të prezantojë një ndërveprim dinamik të vendeve pjesë e BE-së dhe të promovojë politikat e përfshirjes sociale mes aktorëve të ndryshëm.[52] Përmes sugjerimeve për buxhetet në kuadër të sigurisë sociale, indikatorëve matës, llojeve të politikave të nevojshme për zbatim etj., BE përpiqet të nxisë vendet anëtare në plotësimin sa më parë të qëllimeve madhore për uljen e varfërisë të përcaktuara nga vetë ata. Institucionet e Bashkimit Evropian synojnë në vazhdimësi përcaktimin e objektivave të përbashkëta dhe nxisin vendet drejt zbatimit të Modeleve Ekonomike Sociale, por kurrsesi nuk mund të ndërhyjnë përtej një niveli të caktuar në hapat politikë të një vendi anëtar.

Sot, BE zbaton një Agjendë të Politikave Sociale dhe ka në fokus të vazhdueshëm qëllimet e vendosura në kuadër të Strategjisë për *Evropën 2020.*[53] Në objektivat e kësaj të fundit të përcaktuara edhe në përputhje me atë që njihen si Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm, përfshihen: rritja e normës së punësimit për moshën 20-64 vjeç në 75% dhe largimi i të paktën 20 milion njerëzve nga rreziku i varfërisë dhe përjashtimi social.

---

[50] Islanda për vitin 2014, ka pasur normën totale të riskut ndaj varfërisë më të ulët në Evropë, duke arritur në 7.9%. Për më tepër: Eurostat, 2016, http://ec.europa.eu/eurostat/data/database#

[51] Në vitin 2010, Republika Ceke ka qenë e listuar ndër vendet me risk të ulët të varfërisë me 8.6 %. Për më tepër: Parlamentit Evropian, Departamenti i Politikave të Brendshme, Roli i të ardhurave minimale për përfshirjen sociale në Bashkimin Evropian 2007-2010, Viti i botimit 2011, http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/etudes/join/2011/451493/IPOL-EMPL_ET(2011)451493_EN.pdf

[52] Parlamenti Evropian, Departamenti i Politikave të Brendshme, Roli i të ardhurave minimale për përfshirjen sociale në Bashkimin Evropian, Viti i botimit 2007, http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/etudes/join/2007/401013/IPOL-EMPL_ET(2007)401013_EN.pdf

[53] Përfundime të Këshillit të Evropës, datë 17 Qershor 2010, http://ec.europa.eu/eu2020/pdf/council_conclusion_17_june_en.pdf

**Tabela 5. Disa ndër Indikatorët Kryesorë të Strategjisë Evropa 2020**

| Fusha | Synimi/ Indikatori | Njësia | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | Target |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Punësimi | Norma e punësimit (20-64 vjeç) | % | 68.5 | 68.5 | 68.4 | 68.4 | 69.2 | 70.1 | 75 |
| Varfëria dhe përjashtimi social | Njerëz në rrezik varfërie dhe përjashtimi social | Nr (Milion) | 117 | 120.4 | 123.1 | 121.4 | NA | NA | 96.6 |

*Burimi: Komisioni Evropian, 2016*[54]

Indikatorët e paraqitur deri në 2013 tregojnë tendenca përmirësimi te një sërë prej tyre, por gjithashtu përkeqësim të disa të tjerëve.[55] Në rastin e përfshirjes sociale norma e punësimit është ulur për moshën në fjalë (20-64 vjeç), ndërkohë që numri i individëve jashtë rrezikut për varfërinë ka pësuar luhatje të vazhdueshme. Efektet e krizës financiare së Eurozonës dhe politikat ekonomike të aplikuara nga çdo vend anëtar i BE-së, por edhe në vendet e tjera të Evropës ka sjellë sa më sipër.

Në kuadër të politikave të ndërmarra shihet se çfarë roli të rëndësishëm ka marrë siguria sociale në planet e veprimit për të ardhmen. Megjithatë ndërmarrja dhe zbatimi rigoroz i vendimeve për përfshirje sociale, për reduktimin e varfërisë e më gjerë mbetet detyrë e çdo vendi anëtar të BE-së. Dhe në raste të mos-unifikimit të politikave dhe veprimeve të marra përfundimet dhe produkti i masave të zgjedhura do të jetë pashmangshmërisht i ndryshëm.

### 3.1.3 MINIMUMI JETIK NË VENDE TË EVROPËS LINDORE PJESË E BASHKIMIT EVROPIAN

Në klasifikimin dhe rishikimin e mëposhtëm janë marrë në konsideratë vendet e integruara në Bashkimin Evropian prej vitit 2004 e më pas. Këto vende janë kryesisht vendet e bllokut lindor (disa të ish bllokut Sovjetik), vendet ballkanike dhe ato mesdhetare (ish koloni britanike). Këto vende janë shtete të cilat nuk janë vlerësuar si

[54] Komisioni Evropian, Eurostat, 2016, http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/images/4/4a/Europe_2020_headline_indicators%2C_EU-28%2C_2008%E2%80%9313.PNG

[55] Për më tepër mund ti referoheni të dhënave të publikuara nga Komisioni Evropian mbi ecurinë e indikatorëve të Strategjisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm: Eurostat, 2016, http://ec.europa.eu/eurostat/web/sdi/indicators/complete-set-of-indicators

vende të zhvilluara prej një kohe shumë të gjatë[56], madje disa prej tyre kanë kaluar vështirësi të mëdha ekonomike në ecurinë e viteve të fundit.

Në kuadër të krahasimit të nivelit të jetesës dhe vlerave të minimumit jetik, një pjesë e mirë e vendeve të sipërpërmendura kanë pasur si praktikë ekonomike përdorimin e këtij minimumi. Vende si Estonia, Lituania, Letonia, Republika Ceke, Sllovakia, Polonia, Hungaria etj., e llogarisin kufirin e varfërisë përmes metodës absolute.[57] Megjithatë sot, ato e gjejnë veten të integruara në statistikat e Bashkimit Evropian dhe për pasojë edhe me metodologjitë e përllogaritjes që BE përcakton si të përshtatshme. Një ndër metoda alternative për të trajtuar vlerësimet e minimumit jetik është kufiri i 60% të medianës kombëtare për të ardhurat e disponueshme të njehsuara (pas transfertave sociale). Në këtë rast kjo metodologji nuk tregon mirëqenien apo varfërinë, por nivelin e ulët të të ardhurave në krahasim me individë rezidentë në po atë vend.[58] Për pasojë kjo e fundit nuk nënkupton medoemos një nivel të ulët jetese. Figura e mëposhtme paraqet krahasimin midis këtyre vlerave për 3 vitet e fundit për totalin e përbashkët të Bashkimit Evropian dhe vendet e marra në konsideratë. Ngjyra jeshile në grafik ofron të dhënat për vitin 2015, të cilat nuk janë ende të gatshme për të gjitha shtetet e BE-së. Megjithatë për këtë vit të dhënat tregojnë se përqindja se për disa nga vendet ka patur një rritje të përqindjes në fjalë. Në gjashtë vende anëtare të Bashkimit Evropian Rumani (25.4 %), Spanjë (22.2 %), Greqi (22.1 %), Bullgari (21.8 %), Estoni (21.8 %) dhe Letoni (21.2 %) 1/5 e popullsisë dhe më tepër shihet si në rrezik varfërie. Në Evropë në tërësi shifrat më të ulëta për 2015 të kësaj normë i japin vende si Republika Ceke, Norvegjia dhe Islanda.[59]

Grafiku tregon norma të përkeqësuara për vende si Rumania, Lituania, Letonia dhe Bullgaria. Ndërkohë viti 2014 ka shënuar një përkeqësim të përqindjes së individëve në risk nga varfëria për vende si Estonia, Letonia, Rumania, Republika Ceke dhe Bullgaria (në rend zbritës) dhe për Bashkimin Evropian në tërësi. Ndërkohë në vendet e tjera shihet një ulje e lehtë e kësaj vlere, por në asnjë prej vendeve nuk shihet një përmirësim i ndjeshëm.

[56] Kombet E bashkuara, Aneks Statistikor, Klasifikimi i Vendeve sipas Nivelit Zhvillimor, 2012, http://www.un.org/en/development/desa/policy/wesp/wesp_current/2012country_class.pdf
[57] L. Shahollari, Metodologjia Amerikane e Matjes së Varfërisë si Model për Shqipërinë, Revista Demografia,
[58] Për më tepër referojuni: Shpjegime Statistikore, Eurostat, 2016, http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Glossary:At-risk-of-poverty_rate
[59] Për më tepër referojuni: Statistika të Shpërndarjes së të Ardhurave, Eurostat, 2016, http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Income_distribution_statistics

## Tabela 6. Popullsisë në rrezik varfërie (2013-2015)




*Burimi: Eurostat (2016), Përpunim i Autorit*[60]

Literatura mbështet fortësisht se një analizë e tillë duhet të ofrojë edhe shifra në terma monetarë, të cilat të mund të përdoren për ndërmarrje të politikave sociale e më gjerë në secilin vend, por edhe në grupime vendesh dhe aleanca ekonomike dhe politike si BE. Vetë BE-ja përllogarit dhe publikon dy vlera të të ashtuquajturit minimum jetik për vendet e BE-së: për individ dhe për një familje prej katër personash, ku dy fëmijë janë nën moshën 14 vjeç. Duke e lidhur përcaktimin edhe me metodologjinë e përmendur në diskutimin e grafikut të mësipërm, variabli në tabelë emërtohet si pragu i riskut nga varfëria. Të dhënat paraqiten në vlerë monetare dhe tregojnë nivelin e të ardhurave minimale që i duhen një individi ose familjeje bazë për të jetuar në secilin prej vendeve të marra në konsideratë.

Ajo çfarë vihet re është diferenca midis vlerave për disa vende. Nëse i referohemi vlerës monetare mujore në euro për një person të vetëm, dallojmë vende si Qipro, Maltë dhe Slloveni me shkëputje të ndjeshme prej vendeve të tjera. Më pas renditen Republika Ceke, Sllovakia, Polonia për ta mbyllur me shifrën më të ulët vjetore për individ me nivelin e Rumanisë. Ndërkohë vihet gjithashtu re se me përjashtim të Qipros të gjitha vendet e listuara kanë shfaqur rritje të nivelit të minimumit jetik, si në nivelin e individit ashtu edhe të familjes.

---

[60] Idem

**Tabela 7. Vlerat vjetore të minimumit jetik sipas metodës së varfërisë relative në disa prej vendeve të BE-së (Euro/muaj)**

| Viti | 2013 | | 2014 | | 2015 | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Vendi | Për Frymë | Për një njësi familjare | Për Frymë | Për një njësi familjare | Për Frymë | Për një njësi familjare |
| Bullgari | 146.17 | 307.00 | 165.58 | 347.67 | 166.58 | 349.83 |
| Estoni | 328.92 | 690.75 | 360.83 | 757.75 | * | * |
| Hungari | 222.50 | 467.17 | 225.58 | 473.83 | 227.83 | 478.42 |
| Kroaci | 253.92 | 533.17 | 261.25 | 548.67 | * | * |
| Letoni | 233.25 | 489.92 | 260.17 | 546.33 | 291.42 | 612.00 |
| Lituani | 234.92 | 493.33 | 241.17 | 506.42 | 259.00 | 543.92 |
| Maltë | 604.67 | 1269.83 | 639.33 | 1342.67 | * | * |
| Poloni | 258.17 | 542.25 | 266.83 | 560.33 | * | * |
| Qipro | 793.67 | 1666.75 | 720.00 | 1512.00 | * | * |
| Republika Ceke | 384.67 | 807.83 | 381.08 | 800.33 | * | * |
| Rumani | 100.75 | 211.67 | 109.75 | 230.50 | 115.67 | 242.92 |
| Sllovaki | 336.83 | 707.42 | 340.50 | 715.00 | * | * |
| Slloveni | 592.58 | 1244.50 | 595.50 | 1250.50 | 616.58 | 1294.83 |

*Burimi: Eurostat (2016), Përpunim i Autorit*

Në kuadër të politikave ekonomike, minimumi jetik përllogaritet për efekte të mirëqenies së individit. Për pasojë lidhja me të ardhurat për frymë ose të ardhurat familjare me minimumin jetik për frymë ose njësi familjare sipas përcaktimit duhet të jetë e fortë.[61]

---

[61] ILO, "Dokumenti i Programit të Vendit për Punën e Ndershme 2012-2015", 2015, http://www.ilo.org/public/english/bureau/program/dwcp/download/albania2.pdf

Një ndër elementët e lidhur ngushtësisht minimumin jetik ose pragun e riskut të varfërisë është paga minimale[62], e cila duhet të përbëjë një element të rëndësishëm për kapërcimin e varfërisë dhe për plotësimin e nevojave bazë të familjes/punonjësve. Ende sot në vendet e BE-së nuk ka një politikë të unifikuar duke qenë se për pagën minimale, praktikat mbi të dhe ndryshueshmërinë vendimet merren në nivel kombëtar. Paga minimale në disa nga vendet e BE-së është e përcaktuar me ligj, ndërkohë në disa të tjera jo, ose jo për të gjitha profesionet.[63] Tabela 7 paraqet një ndarje të vendeve pjesë e BE-së për sa më sipër,ku shihet se një pjesë e vogël e vendeve të marra në konsideratë si pjesë integrale e BE-së nuk kanë një kufi minimal për pagën. Vihet re veçanërisht se vendet të cilat nuk e zbatojnë një parim detyrues të pagës minimale janë vendet nordike dhe vende si Austria, Qipro dhe Italia (kjo e fundit është shembull i veçuar nga vendet e Mesdheut me të cilat zbaton përgjithësisht politika të ngjashme).

**Tabela 8. Rregullim ose jo mbi përcaktimin e pagës minimale në BE që prej 01 Janar 2016**

| Shtete që zbatojnë legjislacion mbi përcaktimin e pagës minimale | Shtete që nuk kanë një mekanizëm ligjor për përcaktimin e pagës minimale |
|---|---|
| Belgjikë, Bullgari, Kroaci, Republika Çeke, Estoni, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Irlandë, Letoni, Lituani, Luksemburg, Maltë, Holandë, Poloni, Portugali, Rumani, Sllovaki, Slloveni, Spanjë dhe Mbretëri e Bashkuar | Austri, Danimarkë, Finlandë, Itali, Qipro dhe Suedi |

*Burimi: Eurofound, K. Fric, Pagat minimale statusore në BE, 2016*

Më tej në tabelën e mëposhtme paraqiten një sërë të dhënash për pagat minimale në vendet e Bashkimit Evropian.

[62] Për më tepër referojuni: ILO, R 135: Rekomandime për përcaktimin e pagës minimale, 1970, http://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100_INSTRUMENT_ID:312473

[63] Eurofound, K. Fric,Paga Minimale e Njohur me Ligj në BE, 2016,

**Tabela 9. Të dhëna mbi pagat minimale në disa vende të BE-së**

| Vendi | Efektive prej datës | Paga Minimale (Euro) | Njësia |
|---|---|---|---|
| **Bullgari** | 1/1/2016 | 214 | Muaj |
| **Estoni** | 1/1/2016 | 430 | Muaj |
| **Hungari** | 1/1/2016 | 353 | Muaj |
| **Kroaci** | 1/1/2016 | 407 | Muaj |
| **Letoni** | 1/1/2016 | 370 | Muaj |
| **Lituani** | 1/1/2016 | 350 | Muaj |
| **Maltë** | 1/1/2016 | 168 | Javë |
| **Poloni** | 1/1/2016 | 430 | Muaj |
| **Republika Ceke** | 1/1/2016 | 360 | Muaj |
| **Rumani** | 5/1/2016 | 276 | Muaj |
| **Sllovaki** | 1/1/2016 | 405 | Muaj |
| **Slloveni** | 1/1/2016 | 790 | Muaj |

*Burimi: Eurofound, K. Fric, 2016*

Siç shihet në tabelë është shtuar në dallim nga vendet e trajtuara për minimumin jetik edhe Belgjika, që paraqet një pagë minimale disa herë më të lartë se sa vendet e tjera. Kjo paraqitje është realizuar për të bërë diferencën e vendeve të cilat po trajtojmë aktualisht. Politikat e zbatueshme dhe kushtet ekonomiko-sociale në vende e Evropës Lindore apo në vendet Ballkanike ndryshojnë në masë të madhe nga ato të vendeve të zhvilluara, duke sjellë si pasojë edhe një produkt të ndryshëm final.[64,65]Megjithatë më interesante është shkëputja e Sllovenisë në raport me vendet e tjera në tabelë për pagën minimale. Literatura mbështet faktin se ka një sërë kriteresh në përcaktimin e pagës minimale si: 1. Nevojat e punonjësve dhe familjeve të tyre; 2. Niveli i përgjithshëm i pagave në vend; 3. Kostot e jetesës dhe ndryshimet; 4. Përfitimet sociale; 5. Standardi relativ i jetesës i grupeve të tjera sociale; 6. Faktorët ekonomikë (kërkesa për zhvillim ekonomik, nivelet e produktivitetit; norma e punësimit etj)[66]. Për

[64] R. J. Pember, M. Dupré, Aspekte Statistikore të përcaktimit të pagës minimale, 1996, http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---stat/documents/publication/wcms_087898.pdf
[65] ILO, R 135: Rekomandime për përcaktimin e pagës minimale, II. Kriteret për përcaktimin e pagës minimale, 1970, http://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100_INSTRUMENT_ID:312473
[66] Kriteri i fundit përfshin gjithashtu aftësinë paguese të individëve. (Starr, 1993)

shkak të përfshirjes së vetë kostos së jetesës dhe standardit relativ të jetesës në vend, më poshtë vijohet më krahasimin e pagës minimale me minimumin e jetesës për vendet në diskutim.

**Tabela 10. Të dhëna krahasuese të pagës minimale dhe minimumit jetik për frymë (2013-2015, në euro)**

| | **2013** | **Në fuqi në 01.01.2014** | **Raporti Pagë Minimale /MJ** | **2014** | **Në fuqi në 01.01.2015** | **Raporti Pagë Minimale/MJ** | **2015** | **Ne fuqi ne 01.01.2016** | **Raporti Pagë Minimale/MJ** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Vendi** | MJ/Për Frymë | Paga Minimale | | MJ/Për Frymë | Paga Minimale | | Për Frymë | Paga Minimale | |
| Bullgari | 146.17 | 174 | 119% | 165.58 | 183 | 111% | 166.58 | 214 | 128% |
| Estoni | 328.92 | 355 | 108% | 360.83 | 390 | 108% | * | 430 | * |
| Hungari | 222.5 | 322 | 145% | 225.58 | 333 | 148% | 227.83 | 353 | 155% |
| Kroaci | 253.92 | 394 | 155% | 261.25 | 395 | 151% | * | 407 | * |
| Letoni | 233.25 | 320 | 137% | 260.17 | 360 | 138% | 291.42 | 370 | 127% |
| Lituani | 234.92 | 300 | 128% | 241.17 | 325 | 135% | 259 | 350 | 135% |
| Maltë | 604.67 | 662 | 110% | 639.33 | 664 | 104% | * | 672 | * |
| Poloni | 258.17 | 390 | 151% | 266.83 | 407 | 153% | * | 430 | * |
| Republika Çeke | 384.67 | 310 | 81% | 381.08 | 335 | 88% | * | 360 | * |
| Rumani | 100.75 | 187 | 186% | 109.75 | 215 | 196% | 115.67 | 276 | 239% |
| Sllovaki | 336.83 | 352 | 105% | 340.5 | 380 | 112% | * | 405 | * |
| Slloveni | 592.58 | 789 | 133% | 595.5 | 790 | 133% | 616.58 | 790 | 128% |

*Burimi: Eurostat, 2016*     ** - të dhënat mungojnë*

Në rishikim të kësaj tabele në vëmendje janë vende si Kroacia, Sllovenia, Hungaria, Polonia dhe Rumania të cilat kanë një raport të lartë mbulimi të minimumit jetik nga paga minimale. Vlen të theksohet përsëri se në përcaktimin e vlerës së pagës

minimale ndikojnë edhe faktorët e mësipërm, megjithatë praktika e këtyre vendeve dhe masat e marra në politikat publike flasin për një mbulim të plotë të kostove të përllogaritura të jetesës (mbijetesës). i vetmi rast diferencial në këtë krahasim është Republika Ceke, në të cilën paga minimale mbulon minimumin jetik në nivelin 80-90 përqind, duke mos e sjellë vlerën e pagës minimale në vlerën e vlerës së minimumit jetik. Që individët të kenë mundësi të jetojnë mbi nivelin e kufirit të varfërisë duhet të punojnë një numër të madh orësh në javë.[67] Madje Republika Ceke është ndër të vetmet vende të OECD e cila ka patur ulje të pagës minimale pas vitit 2007. Megjithatë, në kushtet e diskutimit për nivelin e varfërisë apo dallimet në standardet e jetesës, presioni politik për paga minimale të rregulluara më ligj mbetet shumë i gjerë. Ndaj ndodh shpesh që ekonomi të ndryshme botërore të mos mbështeten vetëm në pagën minimale, pavarësisht se ajo është pjesë e paketave për uljen e varfërisë dhe ndoshta instrumenti me barrën më të ulët në buxhetin e shtetit në krahasim me transfertat qeveritare.[68]

Referuar nivelit të minimumit jetik, nga të dhënat e mësipërme dhe nëpërmjet një analize të thjeshtë krahasimore mund të dalim në përfundimin se vendet e hyra rishtazi në BE kanë një kufi varfërie dukshëm më të ulët se vendet themeluese të BE-së.

### 3.1.4 Minimumi Jetik në Ballkanin Perëndimor

Evropa Lindore dhe Ballkani Perëndimor kanë pësuar transformime të rëndësishme përgjatë 26 viteve të fundit. Vlen të theksohet se procesi i tranzicionit për vendet e Ballkanit Perëndimor[69] ka qenë veçanërisht i pabarabartë. Kjo pabarazi është shfaqur edhe në mirëqenien e vendeve të ndryshme por edhe të së njëjtës popullatë në një shtet. Megjithatë ekspertët gjykojnë se deri në vitet e krizës financiare varfëria në Ballkan ka qenë në rënie. [70] Në kontekstin e tranzicionit mundësitë dhe kërcënimet e politikëbërësve në rajon kanë qenë të shumta: mundësitë janë lidhur ngushtësisht me prirjen për veprim të shpejtë për të përmirësuar jetesën e njerëzve, por gjithashtu një kërcënim duke qenë se shpejtësia në veprim mund të sjellë një proçes të dhimbshëm reformimi (FMN, 2016). Më poshtë paraqiten të dhënat kryesore demografike dhe ekonomiko-sociale, ku shquhen normat e larta të papunësisë dhe normat e ulëta të rritjes së prodhimit të brendshëm bruto, veçanërisht për disa prej vendeve të Ballkanit Perëndimor.

---

[67] Për më tepër: OECD, Republika Ceke – Rezultate të Raportit të Pagave Minimale, 2015, http://www.oecdbetterlifeindex.org/countries/czech-republic/

[68] OECD, Republika Ceke, Pagat minimale pas krizës, Maj 2015, http://www.oecd.org/social/Focus-on-Minimum-Wages-after-the-crisis-2015.pdf

[69] Ballkani Perëndimor përfshin Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e ZI, Serbinë Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Kosovën, http://ec.europa.eu/trade/policy/countries-and-regions/regions/western-balkans/

[70] Idem

**Tabela 11. Të dhënat ekonomike të Ballkanit Perëndimor**

| Vendi | Popullsia | Rritja e PBB-së (%) | PBB për frymë (USD) | Papunësia (%) |
|---|---|---|---|---|
| **Shqipëri** | **2,889,167** | **2.56** | **3,965** | **16.1** |
| Bosnja dhe Hercegovina | 3,810,416 | 3.15 | 4,197 | 27.9 |
| Kosova | 1,797,151 | 3.62 | 3,553 | 32.9 |
| Maqedonia | 2,078,453 | 3.66 | 4,852 | 27.8 |
| Mal i Zi | 622,388 | 3.37 | 6,415 | 19.1 |
| Serbi | 7,098,247 | 0.72 | 5,143 | 22.2 |

*Burimi: Indikatorët e Zhvillimit Botëror, Banka Botërore, 2014-2015*[71]

Përfshirja e të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor në një analizë krahasimore në kushte të mungesës së të dhënave zyrtare nga një burim informacioni (dëshmi për një metodologji të njëjtë përllogaritjeje) për të gjitha vendet, nuk është e mundur. Shqipëria pritet të prodhojë statistika të tilla në këtë vit në përputhje edhe me Dokumentet e Matjes, Monitorimit dhe Raportimit të Politikave me Orientim Rezultatet në Dokumentin Zyrtar të Politikave Sociale (2016-2020).

Në vijimësi të analizës për çështje të minimumit jetik shohim bëjmë një krahasim të shumave të përcaktuara si vlera të minimumit të mbijetesës në vendet fqinje të Ballkanit Perëndimor përgjatë tre viteve të fundit. Maqedonia, ka pasur një rritje të nivelit të minimumit jetik si në rastin e individit dhe në atë të njësisë familjare. Ndërkohë nga vendet e Ballkanit Perëndimor Serbia shfaqet me vlerën më të lartë të minimumit jetik, me një luhatshmëri të vogël në vitin 2014, ardhur si pasojë e kushteve ekonomike. Fatkeqësisht të dhënat e Eurostat nuk sigurojnë informacion për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor si Shqipëria, Kosova dhe Mali i Zi, ndaj dhe nuk mund të bëjmë një krahasim mes tyre.

[71]World Bank, Database World Bank, Data on selected indicators, (Last access 28.08.2016) http://databank.worldbank.org/data/reports.aspx?Code=NY.GDP.MKTP.KD.ZG&id=af3ce82b&report_name=Popular_indicators&populartype=series&ispopular=y#

**Tabela 12. Vlera të Minimumit Jetik në disa nga vendet e Ballkanit Perëndimor (Euro/muaj)**

| Viti | 2013 | | 2014 | | 2015 | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Vendi | Për Frymë | Për një njësi familjare | Për Frymë | Për një njësi familjare | Për Frymë | Për një njësi familjare |
| Shqipëria | * | * | * | * | * | * |
| Bosnja dhe Hercegovina | * | * | * | * | * | * |
| Maqedoni | 95.2 | 199.9 | 97.4 | * | * | * |
| Mal i Zi | * | * | * | * | * | * |
| Serbi | 120.9 | 253.9 | 119.3 | 250.6 | 127.2 | 267.1 |

*Burimi: Eurostat, 2016*

Një indikator me rëndësi të veçantë në çështjet e varfërisë dhe minimumit jetik është ai i pagës minimale. Ndërkohë vihet re që Mali i Zi ofron pagën minimale më të lartë në rajon kurse Shqipëria pagën më të ulët minimale në rajon. Krahasimi i pagës minimale në rajon dhe minimumeve jetike na sjell një sërë diferencash në bazë të shifrave zyrtare të të dhënave të tabelës.

Për sa i përket pagat minimale vihet re se Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia kanë paga mbi 200 EUR dhe ofrojnë një mbulimin të mirë të nivelit të tyre të minimumit jetik. Në këtë formë të tria këto vende ofrojnë shifra të krahasueshme me vendet e Bashkimit Evropian, veçanërisht ato të Bllokut Lindor, Evropës Lindore dhe Ballkanit pjesë e BE-së. Ndaj mund të themi se mbulimi i minimumit jetik nga paga minimale është i përafërt me një sërë vendesh të BE-së.

**Tabela 13. Paga minimale dhe minimumi jetik në Ballkanin Perëndimor (Euro/muaj)**

| Vendi | Vlera e fundit e përcaktuar e Minimumit Jetik | Paga Minimale | Raporti Pagë Minimale / Minimum Jetik |
|---|---|---|---|
| Shqipëria | * | 157 | * |
| Bosnja Hercegovina | * | 207 | * |
| Kosova | * | 170 | * |
| Mali i Zi | 186.45 | 288 | 154% |
| Maqedonia | 97.4 | 214 | 218% |
| Serbia | 119.3 | 235 | 197% |

*Burimi: Eurostat, 2016*

Në mënyrë të përmbledhur mund të themi se vendet e Ballkanit Perëndimor, si pasojë dhe e zhvillimit të tyre ekonomik, pasqyrojnë vlera më të ulëta të pagës minimale dhe minimumit jetik se vendet e tjera të BE-së. Dukshëm evidentohet se Shqipëria ofron një normë më të ulët të pagës minimale krahasuar me vendet e rajonit. Ndërkohë, në kushtet e mungesës së të dhënave të unifikuara, një analizë krahasimore e nivelit të minimumit jetik në vendet e Ballkanit Perëndimor nuk është e mundur.

### 3.2 Evoluimi i Matjes së Minimumi Jetik në Shqipëri

Gjatë regjimit komunist (1989), minimumi jetik në Shqipëri ishte caktuar 450 lekë në muaj (sa paga minimale) për një familje mesatare me 4 persona. Pas përmbysjes së regjimit komunist vitet "90 e gjetën Shqipërinë pa politika sociale të sintetizuara qartë. Studimi i parë për përcaktimin minimumit jetik u ndërmor në vitin 1991 nga Ministria e Ekonomisë dhe Instituti i Studimeve të Ekonomisë, të cilët e përcaktuan minimumin jetik për një të punësuar 870 lekë për një familje, duke pësuar kështu një rritje me 93%. Megjithatë kjo masë e varfërisë nuk u miratua asnjëherë zyrtarisht.

Baza e parë ligjore për vendosjen e minimumit jetik gjendet në Kodin e Punës (KP) të miratuar në 1995.[72] Sipas KP, personi i autorizuar për caktimin e minimumit jetik është Ministri i Punës ose organi i autorizuar prej tij dhe paga konsiderohet jetike kur është e nevojshme për të siguruar mbajtjen e punëmarrësit dhe të familjes së tij. Minimumi jetik konsiston në nevojat për ushqime, rroba, shtëpi dhe nevoja sociale. Pas një periudhe vakumi për llogaritjen e minimumit jetik, përpjekja tjetër për llogaritjen e tij nga institucionet qeveritare u bë në fillim të vitit 2001. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (MPÇS), sot Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ngriti një grup ekspertësh për përcaktimin e "minimumit jetik zyrtar". Sipas studimit të saj, u llogarit minimumi jetik për frymë 7,975 lekë në muaj, minimumi jetik për një të punësuar 13,404 lekë në muaj dhe minimumi jetik për një familje me 4 persona 21,532 lekë në muaj.[73] Megjithatë, edhe ky studim nuk u miratua asnjëherë zyrtarisht.

Në 15 vite, prej vitit 2001 nuk është domosdoshmëri vetëm përcaktimi i një treguesi zyrtar të minimumit jetik por edhe shpallja e tij në Fletoren Zyrtare. Kjo do të shërbente në kuadër të zbatimit të ligjeve të Kuvendit, si: Kodit të Punës, Ligjit të Sigurimeve Shoqërore[74], dhe porosive të organizatave botërore, si Organizata Botërore e Punës (ILO), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore si dhe kërkesave të vazhdueshme të Sindikatave.

---

[72] Minimumi Jetik diskutohet gjerësisht në: Metohu and Kodra, 1995, https://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2015/10/kodi_i_punes_i_ndryshuar_21960_1.doc

[73] Këto të dhëna janë ende të pashpallura për publikun por evidenca mbi to gjendet në librin me titull "Versioni Sindikalist për Pagën Minimale dhe Pagat", të Institutit të Studimeve Sindikale (ISS), 2002

[74] Ligji Nr. 7703, date 11.05.1993, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", http://www.issh.gov.al/al/wp-content/uploads/2014/05/Kapitulli-1.pdf?hc_location=ufi

Studiues të ndryshëm në Shqipëri janë përpjekur të kryejnë studime për minimumin jetik në mënyrë të pavarur. Në vitin 1995, studiuesi L. Shahollari përcaktoi minimumin jetik për një familje me katër anëtarë, sipas të cilit varianti optimal i minimumit jetik ishte 4,543 lekë në muaj, kurse në variantin minimal në prill rezultoi 3,197 lekë dhe në dhjetor 3,508 lekë. Kontribut të mëtejshëm në këtë fushë ka dhënë në vitin 1998 dhe prof. I. Telo, drejtues i Institutit të Punës në BSPSH asokohe. Sipas të dhënave të këtij studimi, minimumi jetik për një të punësuar rezultoi të jetë 20,834 lekë në muaj, minimumi jetik për frymë 9,058 lekë në muaj dhe minimumi jetik për një familje me 4 anëtarë 36,232 lekë në muaj. Në vitin 2011, një llogaritje e re e minimumit jetik u bë nga studiuesi K. Ziso. Referuar përllogaritjeve të tij minimumi jetik për frymë për vitin 2010 del 15,072 lekë ndër të cilat 54,8% për ushqim, minimumi jetik për një të punësuar llogaritet 30,144 lekë dhe për një familje tipike me katër persona rezulton 60,288 lekë.

Ndër informacionet zyrtare më të fundit për varfërinë dhe minimumin jetik mund të konsiderohet studimi i INSTAT-it mbi Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS) për vitin 2012, i cili tregoi se varfëria është rritur me 14.3% në krahasim me vitin 2008. Në vazhdim, studimi nënvizon gjithashtu se varfëria ekstreme është rritur si në zonat urbane dhe ato rurale nga 1.2% në vitin 2008 në 2.2% në vitin 2012.[75] Niveli më i lartë i varfërisë evidentohet në zonat malore dhe qendrore, ndërkohë norma më të ulëta reflektohen në Tiranë dhe në zonat bregdetare.[76] Studime të tjera për varfërinë dalin në përfundimin se familjet me më shumë anëtarë kanë më tepër gjasa që të jenë të varfra.[77] Për më tepër, sipas vlerësimeve të EUROSTAT, fuqia blerëse e shqiptarëve është rreth 2.9 herë më e vogël sesa e konsumatorëve evropianë. Megjithatë, në vlerësimet e INSTAT, BB, dhe EUROSTAT shfaqen pamje dhe nivele të ndryshme të varfërisë në vend. Ky fakt e bën akoma më të nevojshëm llogaritjen dhe shpalljen e minimumit jetik si referenca kryesore për vlerësimin e politikave kundër varfërisë. [78]

Konsumi mujor real për frymë sipas Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës nga INSTAT në 2002 rezultoi 4,891 lekë për frymë (3,047 lekë për frymë ushqime dhe 1,844 për artikujt bazë jo-ushqimorë).[79] Kështu për një familje me mesatarisht 4 persona, minimumi jetik në muaj do të jetë 19,564 lekë. Të gjitha përllogaritjet e bëra në studimet e 2005, 2008 dhe 2012 kanë si bazë krahasimore konsumin mesatar për frymë të

---

[75] INSTAT dhe Banka Botërore, "Trendet në Varfëri, 2002-2005-2008-2012", 2015 http://www.instat.gov.al/media/288399/living_standart_measurement_survey__2012_revised.pdf

[76] UNICEF, "Varfëria e Fëmijëve në Shqipëri", 2013, http://www.unicef.org/albania/ChildPovertyInAlbania-En13.pdf

[77] A. Spaho, "Përcaktuesit e Varfërisë në Shqipëri, 2014, http://www.mcser.org/journal/index.php/jesr/article/viewFile/2811/2774

[78] K. Barjaba, "Rithemelimi i Mirëqenies: Zhvillimi, sfidant i varfërisë", 2014, fq 25-56

[79] INSTAT, të dhëna statistikore mbi nivelin e jetesës, http://www.instat.gov.al/al/themes/niveli-i-jetes%C3%ABs.aspx?tab=tabs-5

përcaktuar në 2002. Në këtë mënyrë, duke e indeksuar këtë të fundit me çmimet e tregut rezultoi si më poshtë: 5,272 lekë në 2005; 5,722 lekë në 2008 dhe 6,047 në 2012.[80]

Vlen të përmendet se për llogaritjen e minimumit jetik si nga institucionet dhe nga studiuesit e pavarur është përdorur metoda e varfërisë absolute. Në tabelën 14 jepet një pasqyrë më gjithëpërfshirëse e përpjekjeve të bëra ndër vite nga instancat shtetërore dhe studiues të ndryshëm për llogaritjen e minimumit jetik në Shqipëri.

Diferencat në vlerën e minimumit jetik vijnë si pasojë e pikëpamjeve dhe metodologjive të ndryshme në trajtimin e përllogaritjes së minimumit jetik. Nga tabela më sipër shohim një përfshirje të vakët nga ana e institucioneve për llogaritjen e këtij treguesi social. Për më tepër të dhënat e ofruara nuk kanë vazhdimësi, dhe si rrjedhojë integriteti i tyre mbetet i diskutueshëm.

Tabela 14. Përllogaritjet e minimumit jetik në Shqipëri ndër vite [81]

| | **Viti** | **Minimumi Jetik (në lekë)** | | | **Burimi:** |
|---|---|---|---|---|---|
| | | **Për frymë** | **Për një të punësuar** | **Për një familje me katër persona** | |
| **Institucioni** | | | | | |
| ME dhe ISE | 1989 | | | 450 | Referencë e tërthortë |
| ME dhe ISE | 1991 | | | 870 | Referencë e tërthortë |
| MPÇS | 2001 | 7,975 | 13,404 | 21,532 | Referencë e tërthortë |
| INSTAT | 2002 | 4,891 | | | LSMS, 2002 |
| INSTAT | 2005 | 5,272 | | | LSMS, 2005 |
| INSTAT | 2008 | 5,722 | | | LSMS, 2008 |
| INSTAT | 2012 | 6,047 | | | LSMS, 2012 |
| **Studiues të pavarur** | | | | | |

[80] INSTAT, Anketa mbi Nivelin e Standardit të jetesës, Metodologjia, http://www.instat.gov.al/en/themes/living-standard.aspx

[81] Për studimet mbi përcaktimin e minimumit jetik në vitet 1991 dhe 2001kemi mundur të sigurojmë nga burime të tërthorta vetëm madhësinë e minimumit jetik por nga kërkime zyrtare studimet duke se mungojnë. Ky fakt cënon besueshmërinë e rezultateve të tyre nga ana metodike.

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| L. Shahollari | 1995 | | | 4,543; 3,197; 3,508 | Instituti i Punës BSPSH |
| I. Telo | 1998 | 9,058 | 20,843 | 36,232 | Instituti i Punës BSPSH |
| K. Ziso | 2011 | 15,072 | 30,144 | 60,288 | Instituti i Punës BSPSH |

*Burimi: Përpunim i autorit, 2016*

Llogaritja e minimumit jetik ka një rëndësi të veçantë pasi ky i fundit është tregues i mirëqenies dhe matjes së kufirit të varfërisë. Matja e varfërisë e bazuar në kufirin e varfërisë, i cili llogaritet mbi konsumin ose të ardhurat e familjeve, përdoret më tepër për të orientuar dhe për t'i dhënë prioritet veprimeve politike.[82] Minimumi jetik shërben si një udhëzues për politika efektive të qeverisë pasi:

1. Tregon dinamiken e ndryshimeve në standardin e jetesës së individëve.
2. Ndihmon për te përcaktuar normën minimale të pensioneve, ndihmës ekonomike, pagesës së papunësisë , pagesës së paaftësisë dhe numrin e përfituesve për secilën prej tyre.
3. Tregon mënyrat për të orientuar pagën minimale drejt nivelit të minimumit jetik për një të punësuar.
4. Ndihmon për të përcaktuar përjashtimin nga taksa mbi te ardhurat nën minimumin jetik ose limitin e përjashtimit nga taksa e të ardhurave.

[82] Z. Koczan, IMF, "Të jesh i Varfër, Të Ndjehesh i Varfër: Pabarazia, Varfëria dhe Perceptimet e Varfërisë në Ballkanin Perëndimor", ;https://www.imf.org/external/pubs/ft/wp/2016/wp1631.pdf

**Figura 2. Paraqitje Skematike e Shërbimeve Sociale të Shtetit**




*Burimi: L. Shahollari, 2014*

Për sa i përket sigurimit të një minimumi jetik është shteti ai që duhet ti garantojë individëve një nivel minimal të standardit të jetesës. Në këtë kuadër, në figurën e mësipërme jepet një paraqitje skematike e të gjitha shërbimeve sociale që duhet te sigurojë shteti. Kështu, shteti duhet ti sigurojë individëve dhe familjeve një sistem të integruar për ndërhyrjet sociale, të promovojë masat për garantimin e cilësisë së jetesës, të eliminojë ose zvogëlojë kushtet aftësisë së kufizuar dhe të mungesës që rezulton nga të ardhurat e pamjaftueshme dhe problemet sociale.[83] Për më tepër, Kushtetuta WHO, e konsideron standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit si një e drejtë themelore e çdo qenieje njerëzore. Ky standard përfshin disponueshmërinë e shërbimeve shëndetësore, strehimin e përshtatshëm dhe ushqimet kalorifike.[84]

---

[83] Studio e Kërkimeve Sociale (SRS), F. Strati, "Italia: Skemat e të Ardhurave Minimale, Një Studim mbi Politikat Kombëtare", 2009, https://www.google.al/webhp?sourceid=chrome-instant&ion=1&espv=2&ie=UTF-8#

[84] WHO, Fact Sheet Nr. 323, 2015, http://www.who.int/mediacentre/factsheets/fs323/en/

Të gjitha shërbimet sociale dhe institucionet që i ofrojnë ato duhet të jenë të ndërlidhur dhe komplementarë në objektivat, funksionet dhe financimet e tyre, duke formuar kështu një sistem mbrojtjeje sociale. Për më tepër, tabela 15 ofron një përshkrim të plotë të dinamikës së pagës minimale, pensionit minimal, ndihmës ekonomike dhe pagesës së papunësisë ndër vite. Ndonëse ende nuk ka të dhëna zyrtare sa i takon minimumit jetik në Shqipëri, arrihet të dallohet lehtësisht se këto tregues luhaten nën nivelin "e pranueshëm" të minimumit jetik.

**Tabela 15. Treguesit e kufirit të varfërisë**

| Viti | Paga minimale mujore | Pensioni minimal mujor Urban | Pensioni minimal mujor Rural | Ndihma Ekonomike mujore/ familje | Pagesa e Papunësisë | Pagesa e aftësisë së kufizuar (e njëjtë dhe për kujdestarin ) | Kufiri i varfërisë/ frymë institucional | Minimumi Jetik/frymë jozyrtar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2000 | 7,000 | 5,148 | 1,328 | 2,495 | 2,500 | * | * | * |
| 2001 | 7,580 | 5,560 | 1,726 | 2,420 | 3,100 | * | 7,975 | * |
| 2002 | 9,400 | 6,116 | 2,158 | 2,659 | 3,600 | * | 4,891 | * |
| 2003 | 10,060 | 6,728 | 2,590 | 2,604 | 3,780 | * | * | * |
| 2004 | 10,080 | 7,266 | 2,980 | 2,679 | 4,360 | * | * | * |
| 2005 | 11,800 | 7,850 | 3,430 | 2,242 | 4,360 | * | 5,272 | * |
| 2006 | 14,000 | 8,240 | 4,110 | 2,308 | 5,240 | 6,800 | * | * |
| 2007 | 14,000 | 8,650 | 4,520 | 1,922 | 5,240 | 8,700 | * | * |
| 2008 | 17,000 | 9,515 | 5,200 | 3,275 | 5,980 | 8,700 | 5,722 | * |
| 2009 | 18,000 | 10,276 | 6,344 | 3,419 | 6,340 | 8,700 | * | * |
| 2010 | 19,000 | 10,690 | 6,980 | 2,968 | 6,565 | 8,700 | * | * |
| 2011 | 20,000 | 11,117 | 7,468 | 3,043 | 6,850 | 8,700 | * | 15,072 |
| 2012 | 21,000 | 11,562 | 7,841 | 3,043 | 6,850 | 8,700 | 6,047 | * |
| 2013 | 22,000 | 12,024 | 8,233 | 3,716 | 6,850 | 8,700 | * | * |

*Burimi: INSTAT, 2015*

Organizata Kombëtare e Punës (ILO) i ka dhënë theks të veçantë ndërtimit të një marrëdhënie më të fortë mes pagës minimale dhe minimumit jetik.[85] Studime të tjera të bëra në këtë kuadër nënvizojnë akoma më shumë nevojën që paga minimale të mbrojë

[85] ILO, "Dokumenti i Programit të Vendit për Punën e Ndershme 2012-2015", 2015, http://www.ilo.org/public/english/bureau/program/dwcp/download/albania2.pdf

punëtorët më vulnerabël në Shqipëri dhe të ndryshojë në përputhje me ndryshimin e shpenzimeve të jetesës.[86] Kështu, paga minimale duhet të përcaktohet duke u bazuar në nivelin e minimumit jetik për një të punësuar dhe mundësitë që ka shteti për garantimin e saj. [87]

Për sa i përket pensioneve, parimisht duhet që shuma e tyre të jetë e lidhur në mënyrë direkte me kontributet e paguara, ku këto të fundit duhet ti përshtaten pagës minimale dhe maksimale.[88] Kështu një rritje e pagës minimale ndikon në një mbrojtje më të mirë të qytetarëve në moshën e pensionit. Pensioni social në Shqipëri, i cili përfaqëson dhe pensionin minimal, është 6,750 lekë.

Një tjetër koncept i lidhur në mënyrë të patjetërsueshme me minimumin jetik është Ndihma Ekonomike. Ndihma ekonomike (NE) është programi ndihmës sociale i orientuar drejt zbutjes së varfërisë, e cila siguron një ndihmë mujore në të holla për rreth 7.3 përqind të popullsisë (rreth 100.000 familje).[89] Sipas ligjit Nr. 9355 date 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, në Shqipëri ndihma ekonomike jepet në formën e një kësti mujor në lekë ose përfitimi mujor në natyrë për personat në nevojë që nuk kanë mundësi të plotësojnë nevojat bazë jetike. Në vazhdim, qeveria ka vendosur limitin se pavarësisht nga përbërja e familjes, NE nuk duhet të jetë më shumë se 7,500 lekë në muaj. Institucioni i Avokatit të Popullit më shumë se njëherë është shprehur pro rishikimit të formulës së pikëzimit për ndihmën ekonomike.

Në mbështetje të tregut të punës zënë vend thelbësor programet e pagesës së papunësisë. Këto të fundit janë pjesë e politikave shtetërore të punësimit të cilat sigurojnë mbështetjen me të ardhura të të papunëve në momentin e daljes së tyre si të tillë, duke synuar krijimin e kushteve për rikthimin e tyre në tregun e punës.[90] Vlen të theksohet se numri i personave në pagesë papunësie ka ardhur në ulje përgjatë viteve të fundit dhe në 2014 llogariteshin 7,734 individë të përfshirë në programin e pagesës së papunësisë.[91] Gjithashtu, gjatë këtij viti (2016), me Vendim të Këshillit të Ministrave pagesa e papunësisë pati një rritje të konsiderueshme prej 60 përqind duke u bërë në këtë mënyrë 11,000 lekë në muaj. Kjo rritje kishte për synim përmbushjen e Konventës

---

[86] Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER), "Tendencat e Pagave dhe Hendeku i tyre në Shqipëri", 2014, http://www.ilo.org/budapest/information-resources/press-releases/WCMS_250831/lang--en/index.htm

[87] I. Telo, "Reduktimi i Varfërisë – Detyrë Urgjente e Shoqërisë Shqiptare", Revista Demografia Nr. 1, Viti 2016, http://www.revistademografia.al/revista%20demografia1%202016.pdf

[88] A. Hado, A.Koxhaj dhe O. Metalla, "Reformimi i Skemës së Pensioneve në Shqipëri", 2015, http://eujournal.org/index.php/esj/article/viewFile/6379/6130

[89] Banka Botërore, "Programi "Snapshot", Shqipëria", 2015, https://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Albania-Snapshot.pdf

[90] VKM Nr. 223, date 19.04.2006, "Për pagesën e të Ardhurës nga Papunësia", http://www.ikub.al/LIGJE_CATEGORY/606260001/Article_Mbi-zbatimin-e-vendimit-te-Keshillit-te-Ministrave-nr-223-date-19-04-2006-Per-pa.aspx

[91] Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP), "Buletini i Tregut të Punës", 2014, http://www.kerkojpune.gov.al/wp-content/uploads/2015/03/Buletini-i-Tregut-t%C3%AB-Punu%C3%ABs-2014.pdf

Ndërkombëtare Nr. 168 të ILO-s, sipas të cilës pagesa e papunësisë duhet të jetë të paktën sa 50 përqind e pagës minimale në shkallë vendi. [92]

Pagesa për aftësinë e kufizuar duhet gjithashtu të marrë në konsideratë mbulimin e minimumit jetik dhe gjithashtu të shpenzimeve mjekësore të nevojshme pasi vetëm kështu mund ti sigurojë mbrojtje sociale të plotë personave me aftësive të kufizuar dhe invalidëve të punës. Pagesë paaftësie përfitojnë personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësorë të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP). [93] Pagesa e aftësisë së kufizuar indeksohet çdo vit me ritmet e rritjes së pagës minimale në shkallë vendi për sa kohë pagesa e aftësisë së kufizuar e përllogaritur nuk është më shumë se masa e pensionit minimal në qytet.[94] Përgjatë vitit të fundit (2006) me Vendim të Këshillit të Ministrave, pagesa e aftësisë së kufizuar u bë 10,140 lekë në muaj dhe 10,650 lekë në muaj për kujdestarin.[95]

Kur flasim për sigurimin e një niveli bazë jetese vlejnë të theksohen dhe shpenzimet shtetërore për mbrojtjen sociale, si një tregues i politikave të ndërmarra për luftimin e varfërisë. Megjithatë lufta kundër varfërisë, nëse nuk mbështet mbi zhvillimin dhe punësimin, nuk është efikase dhe e bëjnë gjendjen e popullsisë të paqëndrueshme. Dokumente dhe marrëveshje ndërkombëtare si Karta Shoqërore Evropiane dhe Kodi Evropian i Sigurimeve Shoqërore përcaktojnë detyrimet e shtetit për të ndihmuar qytetarët në raste nevoje ekonomike dhe shoqërore.[96] Në tabelën e mëposhtme jepet një paraqitje më e detajuar në vlerë e treguesve të mbrojtjes sociale: sigurimet shoqërore, kujdesi shëndetësor, ndihma ekonomike dhe pagesa e papunësisë. Shpenzimet për mbrojtjen sociale kundrejt Produktit të Brendshëm Bruto për vitin 2014 kanë qenë në nivelin 11.5 përqind.

[92] Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Konventa Nr. 168 "Konventa e Nxitjes së Punësimit dhe Mbrotjes kundër Papunësisë", 1988, http://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100_ILO_CODE:C168
[93] Neni 7, Ligji 9355, date 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", http://www.sherbimisocial.gov.al/pagesat-e-aftesise-se-kufizuar/
[94] Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (SHDPAK), "Paketë Ligjore mbi Aftësine e Kufizuar", 2008, http://www.adrf.org.al/images/paketa_ligjore.pdf
[95] Shërbimi Social Shtetëror, "Pagesa për aftësinë e kufizuar", http://www.sherbimisocial.gov.al/pagesat-e-aftesise-se-kufizuar/
[96] K. Barjaba, "Kurthet e Papunësisë", 2013, fq 13-32

**Tabela 16. Shpenzimet për mbrojtjen sociale në vitin 2014**

| | Mbrojtja Sociale | Shpenzimet (në miliardë lekë) |
|---|---|---|
| 1 | Sigurimet shoqërore | 101,5 |
| 2 | Kujdesi shëndetësor | 35,7 |
| 3 | Ndihma ekonomike | 22,8 |
| 4 | Pagesat e papunësisë | 0,9 |
| **Totali i Shpenzimeve Sociale** | | **160,9** |

*Burimi: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020*[97]

Megjithatë mbrojta sociale nuk përfshin të gjithë shërbimet shtetërore që kanë si synim mbrojtjen e grupeve të caktuara shoqërore nga rreziku i varfërisë. Krahas elementëve të përmendura më sipër, ndër këto shërbime përmendim pensionet; subvencionimin e energjisë elektrike, telefonisë fikse dhe transportit; përjashtimin nga taksa të caktuara dhe sigurimin e strehimit nëpërmjet banesave sociale. Në tabelën e mëposhtme jepet një përshkrim i gjithë shërbimeve të ofruara nga shteti dhe koston financiare respektive të secilit prej tyre në buxhetin e shtetit.

**Tabela 17. Matrica e disa shërbimeve me fondet buxhetore në vitin 2015**

[97] Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, http://www.planifikimi.gov.al/sites/default/files/SKZHI_FINAL1652016_TOTAL%20bashkerendimi%20sipas%20porosise%20se%20mbledhjes%20redaktuar%2019%205%202016.pdf

| | Llojet e shërbimeve | Përfitimi financiar mesatare (lekë) | Përfituesit | Kosto përkatëse (lekë) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Pagesat e papunësisë | 68,500 | 6,200 individë | 614,398,687 lekë |
| 2 | Pagesa për personat me aftësi të kufizuar/kujdestarin | 10,030 | 66,727 PAK | 15,515,000,000 lekë |
| | | 10,125 | 71,915 Invalidë Pune | |
| 3 | Ndihma ekonomike | | 79,530 familje | 4,447,262,582 lekë |
| 4 | Pensionet | | 598,932 pensionistë | 86,071,000,000 lekë |
| 4.1 | Urban | 14,585 | 454,163 pensionistë | |
| 4.2 | Rural | 8,330 | 144,769 pensionistë | |
| 5 | Strehimi | * | 1,240 familje | * |
| 6 | Subvencionimi për Energjinë Elektrike | 1,400 | PAK dhe invalidët | * |
| | | 20 % | Të verbrit | |
| 7 | Subvencionimi për telefoninë fikse | 1,000 | Të verbrit, PAK dhe invalidët | * |
| 8 | Rimbursimi i barnave dhe ilaçeve | 50 - 100% | PAK, invalidët pensionistët [4,2 milion receta të rimbursueshme (2014)] | 8,400,000,000 lekë |
| 9 | Subvencionimi i transportit | 100% për transportin në qytet dhe 50% për transport ndërqytetas | PAK dhe invalidët | * |
| 10 | Përjashtimi nga pagesat për sigurimin shëndetësor | 100% | PAK dhe invalidët | * |
| 11 | Përjashtimi nga taksat doganore për pajisjet e invalidëve | 100% | Invalidët | * |

*Burimi: Përpunim i autorit, 2016*

Ajo çka vlen për tu theksuar është fakti se përgjithësisht shërbimet e ofruara nga shteti nuk janë mbështetur drejtpërdrejt në minimumin jetik dhe llogaritja e vlerës apo shpenzimit për secilën prej shërbimeve sa më sipër ose përcaktohet me ligj ose vendoset me VKM nisur nga mundësitë e buxhetit të shtetit, përvojat e viteve të mëparshme, etj.

Në këtë linjë, llogaritja e minimumit jetik do të shërbente për një përcaktim më të argumentuar të pagesave të mësipërme. Në këtë mënyrë, duke bërë një krahasim të thjeshtë të tyre me vlerën përpara ndryshimit mund të identifikojmë efektin që do të kishte çdo ndryshim në buxhetin e shtetit.

## 3.3 KUADRI RREGULLATOR DHE INSTITUCIONAL PËR MINIMUMIN JETIK

### 3.3.1 KUADRI RREGULLATOR

Kjo nënçështje e studimit synon të përmbledhë dhe analizojë shkurtimisht kuadrin rregullator dhe referencat në legjislacionin shqiptar për minimumin jetik dhe efektet e përllogaritjes së tij. Bazuar në pikën 1 të nenit 12 të Ligjit Nr. 9000, datë 30.01.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", grupet e punës me ekspertë për hartimin e strategjive , të politikave, të studimeve ose të projekteve të veçanta, krijohen me Urdhër të Kryeministrit ose të ministrit për ministrinë përkatëse.

Përcaktimi i parë i rëndësishëm i minimumit jetik vërehet në kodin e punës së vitit 1995. Sipas tij paga konsiderohet jetike ku ajo është e nevojshme për të siguruar mbajtjen e punëmarrësit dhe të familjes së tij. Ministria që mbulon çështjet e punës është përgjegjëse për përcaktimin e minimumit jetik së bashku më strukturat e autorizuara prej Ministrit për përllogaritjen e tij.[98] Me amendimet që i janë bërë KP në vitet në vijim, ky nen është hequr duke çliruar në këtë mënyrë qeverinë nga detyrimi ligjor përllogaritjen e minimumit jetik.

Në këtë kuadër, referenca tjetër kryesore dhe e drejtpërdrejtë për minimumin jetik në legjislacionin shqiptar është ajo e vitit 2001 në Vendimin e këshillit të Ministrave "Për një Shtesë Fondi në Buxhetin e Vitit 2001, të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, për Projektin "Minimumi Jetik, Zyrtar"[99]. Në këtë VKM jepen detaje të miratimit të projektit për zbatim nga Ministria e Punëve dhe Çështjeve Sociale të kohës dhe citohet se përcaktimi i treguesit zyrtar të minimumit jetik është bërë domosdoshmëri për zbatimin e ligjeve të Kuvendit, si: Kodit të Punës, Ligjit të Sigurimeve Shoqërore, dhe porosive të organizatave botërore, si Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore si dhe kërkesave të vazhdueshme të Sindikatave.

Për ecurinë e këtij projekti në raportin e Avokatit të Popullit (2011)[100] theksohen kërkesat e Bashkësisë së Sindikatave të Shqipërisë dhe lobimi i institucionit të Avokatit të Popullit në kuadër të sigurimit të përllogaritjes së këtij treguesi zyrtar. Sipas raportimit, studimi i realizuar nga grupi i punës i Këshillit Kombëtar të Punës[101] përfundoi në dhjetor 2001, në pritje të zyrtarizimit në Këshillin e Ministrave. Ky minimum jetik sipas

---

[98] Kodi i punës, 1995

[99] VKM Nr. 119, datë 08.03.2001, http://www.qbz.gov.al/doc.jsp?doc=docs/Vendim%20Nr%20119%20Dat%C3%AB%2008-03-2001.htm

[100] Avokati i Popullit, Raport Vjetor i vitit 2011, Tiranë, 2012, http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/Raporti_2001.pdf

[101] Krijuar në atë kohë në kuadër Të zbatimit të projektit "Minimumi Jetik Zyrtar".

dokumenteve zyrtarë duhet të shërbente në krahasimin me pagat, pensionet, ndihmën ekonomike dhe me të ardhurat gjithsej të punonjësve mbi bazën e buxheteve familjare. Sot minimumi jetik nuk citohet në legjislacion ose në dokumente zyrtarë. Shembull është Ligji për ndihmën dhe shërbimet shoqërore apo VKM-të në zbatim të tij. Në këto dokumente përcaktohen përfituesit e ndihmës ekonomike, ku përfshihen edhe familjet me të ardhura të pamjaftueshme ose pa të ardhura. por nuk ka referencë për atë se çfarë konsiderohet e ardhur e pamjaftueshme.

Sipas ligjit të sipërpërmendur gjendja e varfërisë për përcaktimin e ndihmës ekonomike merr në konsideratë një formulë të pikëzuar, e cila bën përcaktimin e peshave dhe vlerësimit të përbashkët me vendim të Këshillit të Ministrave. Aktualisht MMSR dhe SHSSH po zbatojnë një projekt pilot me mbështetjen e Bankës Botërore, i cili synon të përmirësojë efektivitetin e Shërbimit Social Shtetëror duke përmirësuar identifikimin e fëmijëve në nevojë, rasteve abuzive në përfitime të NE-së dhe përmirësimin e vlerësimit për përfituesit. Duke theksuar qëllimet e projektit, shihet se në fokus nuk është rishikimi apo përcaktimi i një metodologjie për vlerësimin e minimumit jetik në mënyrë periodike në vend.

Paga minimale është po ashtu një element i cili sipas nenit 111 të Kodit të Punës në fuqi në Republikën e Shqipërisë përcaktohet ndër të tjera sipas nivelin e përgjithshëm të jetesës së punëmarrësve në vend, të ardhurat e përfituara nga sigurimet shoqërore dhe nivelet e jetesës së grupeve të ndryshme shoqërore[102], përmes një Vendimi të Këshillit të Ministrave.[103] Pensioni si element i tretë në këtë diskutim, duhet po ashtu të sigurojë nevojat bazë jetesës. Ndërkohë në nenin 5/1 të ligjit “Për sigurimet shoqërore ne Republikën e Shqipërisë" (te ndryshuar)[104] pensioni social (i cili synon mbrojtjen sociale të shtresës së tretë që nuk përfiton nga skema e pensioneve) përllogaritet me të ardhurat minimale që sigurohen nga pensioni i pjesshëm i pleqërisë me 15 vite të siguruara me pagë minimale, i llogaritur në datën 31.12.2014. As në rastin e specifikave të pensionit social dhe as të pensionit në tërësi, nuk theksohet në legjislacion që ky pension duhet të mbulojë një nivel bazë mbijetese (minimumin jetik).

Ajo që vlen të theksohet është se në Dokumentet e Matjes, Monitorimit dhe Raportimit të Politikave me Orientim Rezultatet në Dokumentin Zyrtar të Politikave Sociale (2016-2020) [105] është bërë një përcaktim i indikatorëve që do të masin

---

[102] Paga minimale përcaktohet në bazë: a. të faktorëve ekonomikë, kërkesave të zhvillimit ekonomik dhe zvogëlimit të papunësisë, rritjes së prodhimit; b. të nevojave të punëmarrësve dhe familjeve të tyre, duke pasur parasysh nivelin e përgjithshëm të jetesës së punëmarrësve në vend, të ardhurat e përfituara nga sigurimet shoqërore dhe nivelet e jetesës së grupeve të ndryshme shoqërore. (Pika 2, Neni 111) Kodi i Punës, Republika e Shqipërisë, http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2012/PDF-2012/Kodi%20i%20punes-2012.pdf

[103] Ligji Nr. 10 405, datë 24.3.2011, Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve,

[104] Ligji Nr. 104/2014 Për disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 7703, Date 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar

[105] Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Dokumentet e Matjes, Monitorimit dhe Raportimit të Politikave me Orientim Rezultatet, Dokumentin Zyrtar të Politikave Sociale (2016-2020), Janar 2016

efektshmërinë e këtyre politikave. Ndër të tjera vihet re integrimi i indikatorëve sipas Eurostat dhe Statistikave të kërkuara nga BE për indikatorët/treguesit e varfërisë ekonomike dhe mbrojtjen sociale. Ndërkohë për indikatorë kombëtarë si vija absolute e varfërisë është përmendur burimi aktual i të ardhurave, por është specifikuar se duhet të gjendet mekanizmi për vlerësimin e ardhshëm të konsumit mbi bazën e varfërisë.

### 3.3.2 Roli i Institucioneve Publike në Kuadër të Përcaktimit të Minimumit Jetik

Qeveria e Shqipërisë, institucionet publike, agjencitë kombëtare etj, kanë për detyrë përmirësimin e kushteve të jetesës dhe sigurimin e kushteve minimale të jetesës duke mbrojtur qytetarët e këtij vendi nga uria/varfëria në kategori të ndryshme të popullsisë në vend, sipas legjislacionit në fuqi, por edhe sipas Konventave ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut. Qeveritë e shteteve të cilat janë palë në konventat ndërkombëtare zotohen të marrin masa të nevojshme për të siguruar zbatimin e ligjit, dhe masave të nevojshme për plotësimin e të drejtave të plota të njeriut duke përfshirë edhe bashkëpunimet rajonale e më gjerë.

Institucione qendrore qeveritare të përfshira në mënyrë direkte në çështje të minimumit jetik për shkak të fushës së tyre të veprimit janë MMSR, MF dhe agjencitë dhe institucionet me përgjegjësi të caktuara të zbatimit të politikave sociale si ISSHSH, SHSSH. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në misionin e vet përfshin garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje dhe përfshirje sociale, arsim dhe formim profesional, punësim të sigurt e të denjë, sigurim shoqëror, përkujdesje sociale dhe shanse të barabarta, garantimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën sociale etj. Në të njëjtën kohë Ministria e Financave është aktor i rëndësishëm në vend për administrimin e buxhetit të shtetit dhe menaxhimin financiar në kuadër të zbatimit të politikave sociale. Të dyja Ministritë zbatojnë detyrat e tyre përmes menaxhimit të departamenteve përkatëse dhe përmes koordinimit të politikave me institucione si Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, Shërbimi Social Shtetëror dhe INSTAT. INSTAT është përgjegjës për mbledhjen e të dhënave, përmes Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës etj., për gjetjen e mënyrave të reja të grumbullimit të informacionit, për përllogaritjet e indikatorëve socialë në vend, për publikimin dhe ofrimin e informacioneve për publikun, institucionet qeveritare dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm. MMSR në njohje të vlerave të mundshme të minimumit jetik ose të nivelit të varfërisë merr masa në hartimin e politikave në bashkëpunim me institucione si ISSHSH, SHSSH duke i zyrtarizuar përmes sugjerimeve dhe marrjes së vendimeve pranë Këshillit të Ministrave. MMSR mund të bashkëpunojë me struktura apo grupe pune "*ad hoc*", të ngritura për trajtimin e një problematikë të caktuar, apo me struktura si Këshilli Kombëtar i Punës, Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësi.

Në proceset vendimmarrëse të strukturave qeveritare, institucioni i Avokatit të Popullit shërben si një burim i fortë advokimi përmes rekomandimeve dhe propozimeve të marrjes së masave në mbrojtje të drejtave, lirive, dhe interesave të ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të

administratës publike. Në vijim trajtohen përputhja në mision/objektiva e institucioneve të përfshira në çështjen e minimumit jetik në këtë studim.

### 3.3.3 Monitorimi dhe Trajtimi i Minimumit Jetik nga Aktorë të Tjerë të Jashtëm

Përtej institucioneve dhe agjencive qeveritare çështjet e minimumit jetik janë me interes edhe për aktorë të tjerë të pranishëm në vend, të cilët përmes mënyrave të ndryshme dhe në përputhje me qëllimet e veprimtarisë së tyre mund të marrin pjesë në procesin vendimmarrës të strukturave të përmendura më sipër. Aktorët e ashtuquajtur të jashtëm mund t"i grupojmë në tri kategori kryesore: grupime/organizime të sindikatave, organizata ndërkombëtare dhe kombëtare të lidhura me çështje të mirëqenies së shoqërisë dhe ekspertë të fushës së dietologjisë.

Sindikatat dhe grupimet e tyre përfaqësojnë interesat e të punësuarve sipas industrisë, rajonit etj., duke u fokusuar në të drejtat e punonjësve, në mirëqenien e tyre, kushtet e denja të punës apo edhe të pagës. Me këtë të fundit dhe me kushtet bazë të punës lidhet edhe vlera e minimumit jetik mbi të cilën sindikatat përpiqen të realizojnë studime dhe të advokojnë me synim përmirësimin. Ndërkohë organizatat ndërkombëtare kanë në funksion të veprimtarisë së tyre në vend, plotësimin e objektivave madhorë të përcaktuar në rajon dhe botë. Ata realizojnë plane për zbatimi e politikave ndërkombëtare në Shqipëri dhe nxisin fortësisht Qeverinë e Shqipërisë për hapa drejt përmirësimit të kushteve të jetesës në vend. Ata realizojnë studime, hulumtime dhe përgatisin rekomandime politike në kuadër të qëllimit përkatës. Organizatat kombëtare po ashtu realizojnë studimet relevante për problematikat e lidhura me fokusin e punës së tyre dhe advokojnë për marrjen në konsideratë të përfundimeve dhe rekomandimeve. Në kategorinë e fundit, ndodhen ekspertët e fushës së dietologjisë, të cilët duhet të përfshihen në procesin vendimmarrës në kuadër të përmirësimit të shportës aktuale të produkteve bazë.

Për të gjitha kategoritë e aktorëve të paraqitur në tabelën e mëposhtme, janë listuar përgjegjësitë kryesore që lidhen me fushën dhe problematikat dhe po ashtu janë listuar disa rekomandime mbi detyrat që mund të ushtrojnë më tepër në përmbushje të përmirësimit të kushteve të jetesës dhe të rritjes së mirëqenies të familjeve shqiptare në nevojë. Për më tepër rreth rekomandimeve të mëposhtme referojuni kapitullit të rekomandimeve politike të këtij studimi.

**Tabela 18. Fushat e veprimit të agjencive shtetërore dhe aktorëve të tjerë në lidhje me çështje të minimumit jetik**

| Nr | Aktorët / Institucioni / Agjencia | Përgjegjësitë Institucionale | Të dhënat | Burimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinise | - Zhvillimi i politikave dhe monitorimi i politikave, legjislacionit, aktiviteteve që kanë të bëjnë me sigurimet shoqërore, si dhe procesin e koordinimit të skemave të mbrojtjes shoqërore;<br>- Zhvillimi i politikave që synojnë mbrojtjen, promovimin, integrimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies sociale të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë;<br>- Zhvillimi i politikave dhe modeleve për ndihmën dhe shërbimet shoqërore alternative për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike;<br>- Hartimi dhe rishikimi i standardeve për shërbime të ndryshme shoqërore dhe inspektimi i tyre për garantimin e një shërbimi cilësor;<br>- Nxitja dhe zhvillimi i dialogut social, në kuadrin e partneritetit, me qëllim harmonizimin e interesave të palëve për minimizimin e konflikteve sociale.<br>***VKM nr. 845, datë 27.9.2013, Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë*** | - Indikatorët social | - Dokumenta Fact-sheet, Strategji, Raporte |
| 2 | Ministria e Financave | - Përgjegjëse për politikën makroekonomike dhe fiskale, për administrimin e buxhetit të shtetit dhe për menaxhimin financiar dhe të kontrollit<br>***VKM nr. 841, datë 27.9.2013, Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave*** | - Të dhëna të financave publike: të ardhurat, kategoritë e shpenzimeve | - Buxheti |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 3 | **Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore** | - Administrimi i sigurimeve shoqërore ne përgjithësi dhe i politikave te pensioneve ne veçanti<br>- Vendosja e personave te siguruar dhe përmirësimi i shërbimit ndaj tyre ne qendër te veprimtarisë se këtij institucioni<br>- Mbulimi i te gjithë popullsisë me elemente te sigurimeve shoqërore dhe akordimi i përfitimeve për pension, paaftësi te përkohshme ne pune, barrëlindje, aksidente ne pune dhe sëmundje profesionale e përfitime suplementare ne momentin e lindjes te se drejtës dhe nevojës për to.<br>***Ligj, Nr. 7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar*** | - Të dhënat statistikore për: të ardhurat nga kontributet, shpenzimet, numrin e kontribuesve, numrin e përfituesve | - Statistikat e vitit korent, Raporti Vjetor |
| 4 | **Avokati i Popullit** | - Mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj.<br>- Parandalon konfliktet e mundshme midis administratës publike dhe individit.<br>***Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kreu VI, Nene 60-63*** | - Korrespondenca me Kryeministrinë, MMRS, INSTAT | - Raporti Vjetor |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **5** | **INSTAT** | - Institucioni përgjegjës për mbledhjen e statistikave në vend në përgjithësi dhe për realizimin e Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës dhe Anketës së Buxhetit të Familjes në veçanti<br>***Ligj, Nr. 9180, datë 5.2.2004, Për statistikat zyrtare, i Ndryshuar*** | - Të dhëna të nivelit kombëtar: GDP, konsumi, investimet, eksportet, importet etj<br>- Çmimet e konsumatorëve dhe të prodhuesve<br>- Konsumi dhe të ardhurat e familjes; kushtet e jetesës, indikatorët social | - Sistemi i llogarive kombëtare<br>- Indekset e çmimeve<br>- Anketa e Studimit të Nivelit të Jetesës (LSMS), Anketa e Buxhetit të Familjes |
| **6** | **Instituti i Shëndetit Publik** | - Ndërmarrja dhe rritja e shkallës së informimit të popullatës, edukimit dhe ndërgjegjësimit të saj mbi problemet shëndetësore.<br>- Stimulimi dhe mbështetja e projekt-ligjeve dhe rregulloreve drejtuar mbrojtjes së shëndetit të popullatës dhe sigurimit shëndetësor të saj. | - Të dhëna mbi kaloritë ushqimore që i duhen një individi tipik në ditë | -Publikime |
| **7** | **Këshilli Kombëtar i Punës** | - Organ konsultativ trepalësh me përfaqësues të Këshillit të Ministrave dhe të organizatave të punëdhënësve e të punëmarrësve që zhvillon këshillime, merr vendime me konsensus dhe i bën rekomandimet përkatëse Këshillit të Ministrave, nëpërmjet ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë referuar çështjeve te lidhura me punësimin<br>***Vendim Nr. 1039, datë 4.12.2013***<br>***Për funksionimin e këshillit kombëtar të punës dhe për caktimin e përfaqësuesve të këshillit të ministrave në këtë këshill*** | - Vendime, rekomandime për çështjet e punësimit | -Publikime, VKM |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 8 | **Shërbimi Social Shtetëror** | - Zbatimi i politikave, legjislacionit të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi te kufizuar dhe shërbimeve shoqërore në të gjithë vendin | - Të dhënat për personat me aftësi të kufizuar, invalidë | - Strategji të ndryshme, Raporti Vjetor |
| 9 | **Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë** | - Shqyrton brenda fushave të përgjegjësisë projektligjet, projektvendimet dhe çështjet e tjera që paraqiten në Kuvend, kryen studime për efektivitetin e ligjeve në fuqi, ndjek zbatimin e ligjeve dhe kontrollon veprimtarinë e ministrive dhe të organeve të tjera qendrore, duke i propozuar Kuvendit ose Këshillit të Ministrave marrjen e masave përkatëse, si dhe propozon për miratim në Kuvend projektligje, projektdeklarata ose projektrezoluta për çështjet e marrëdhëniet e punës, çështjet sociale, sigurimet shoqërore, familja, gruaja dhe shëndetësia | - Të dhëna mbi zbatimit e ligjeve | -Studime, propozime |
| 10 | **Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë** | - Kontribuon me punime në favor të kryerjes së studimeve te shumta konkrete e të përgjithshme përsa i përket llogaritjes së minimumit jetik | - Llogaritja e minimumit jetik | - Studime, Raporte |
| 11 | **Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë** | - Punësim të plotë dhe të zgjedhur lirisht, mirëqenie dhe standardizim më të mirë të jetesës për të gjithë anëtarët e sindikatës, përfshirë sigurimin e pagave, pensioneve dhe rregullimin e kohës së punës. | - Statistika të mirëqenies | - Studime |
| 12 | **Organizata Ndërkombëtare (ILO, BB, FMN etj)** | - Ndërmarrja e studimeve te shumta referuar përcaktimit te nivelit të jetesës, varfërisë dhe mirëqenies së një vendi. | - Të dhëna për nivelin e jetesës, varfërinë dhe mirëqenien | - Studime, Raporte mbi pagën minimale, nivelin e jetesës, |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | varfërinë, mirëqenien |
| 13 | **Organizata Kombëtare (IPOL, KSS, etj)** | - Ndërmarrja e studimeve kombëtare për llogaritjen e të ardhurave minimale që i duhen një personi (pensionist, familje, persona me nevoja të caktuara) për të plotësuar nevojat bazë të jetesës | - Të dhëna për vlerën minimumit jetik | - Studime, Raporte mbi minimumin jetik |
| 14 | **Ekspertët e fushës së Dietologjisë** | - Përcaktimi i shportës ushqimore me produktet bazë që përmbushin vlerat energjetike të nevojshme për plotësimin e nevojave bazë të një individi | - Të dhëna mbi kaloritë ushqimore që u duhen një individi tipik në ditë | - Studime, Publikime |

*Burimi: Përpunim i autorit, 2016*

## 4. PËRLLOGARITJA E MINIMUMIT JETIK NË SHQIPËRI

### 4.1METODA E PËRZGJEDHUR PËR STUDIMIN

Duke marrë në konsideratë faktin që Shqipëria nuk bën pjesë në vendet e zhvilluara dhe si pasojë e të gjitha avantazheve që ofron metoda e varfërisë absolute për llogaritjen e minimumit jetik do të përdorim këtë fundit. Në këtë mënyrë, minimumi jetik do të përcaktohet në bazë të shportës ushqimore. Shporta ushqimore minimale siguron furnizimin me ushqime (proteina, yndyrnat dhe karbohidratet), të cilat janë te nevojshme për zhvillimin fizik te njeriut dhe jetesën që mbështet qëndrueshmërinë, sipas kërkesave fiziologjike në vlera kalorike dhe çmimet e tregut. Kështu, sipas kësaj metodologjie, minimumi jetik përcaktohen me dy hapa: së pari llogaritet kosto e produkteve ushqimore dhe pastaj kosto e produkteve jo-ushqimore llogaritet në bazë të kostos së kërkesave ushqimore.

Shporta ushqimore e minimumit jetik do të bazohet te nevoja për të përmbushur nevojat bazë jetike. Objektivi i identifikimit të kufirit të varfërisë në ushqim është identifikimi i individëve të varfër në shoqërinë shqiptare. Shporta ushqimore do të ndërtohet duke u bazuar te rekomandimet e FAO, të cilat sugjerojnë kaloritë që duhet të marrin njerëzit të një moshe, gjinie dhe aktiviteti fizik të ndryshëm. Ndërtimi i një diete konsumi do të kalojë në hapat e mëposhtëm[106]:

1. Së pari, llogaritet *numri i kalorive që kërkohen në ditë për një individ mesatar*
2. Së dyti, vendoset se cilat *grupe ushqimore do të përfshihen në dietën model dhe sasia përkatëse për secilën prej tyre.*
3. Së treti, vendoset *përqindja e kalorive që duhet të zënë proteinat, yndyrnat dhe karbohidratet* dhe përcaktohen u*shqimet specifike të secilit grup ushqimor që do të përfshihen në dietën model*.
4. Së pesti, identifikohen *kostot e secilit produkt ushqimor duke shumëzuar sasinë me çmimin për njësi dhe duke mbledhur kostot e çdo produkti në dietën model për të llogaritur koston totale të shportës*.

---

[106] R. Anker, "Një metodologjie e re për vlerësimin e kufirit të varfërisë dhe normës së pagës së jetesës të krahasueshme ndërkombëtarisht", 2005, http://www.ilo.int/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---integration/documents/publication/wcms_079165.pdf

5. Së fundmi, përcaktohen dhe *kostot jo-ushqimore mujore në varësi të përqindjes që zënë shpenzimet e tjera te konsumit që nuk shkojnë për ushqim në anketën e matjes së nivelit të jetesës dhe bëhet llogaritja e kostos totale te nevojave bazë në vend.*

### 4.1.1 NUMRI I KALORIVE QË KËRKOHEN PËR NJË MUAJ PËR NJË INDIVID MESATAR

Niveli minimal i kërkesave ushqimore të energjisë për kalori është nxjerrë duke përdorur standardet e energjisë të vendosura nga Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara (FAO), Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO) dhe Universiteti i Kombeve të Bashkuara (UNU) për grupe të gjinisë dhe moshës së ndryshme që kanë aktivitet fizik sedentar dhe një peshë minimale trupore të pranueshme për gjatësinë e tyre. Duke qenë se një i rritur ka nevojë thuajse për dyfishin e energjisë të një fëmije tre-vjeçar, kërkesa minimale e kalorive për një individ në çdo vend duhet të marrë në konsideratë kombinimin e faktorëve si mosha, gjinia, madhësia trupore, aktiviteti fizik etj. Numri i kalorive minimum, me qëllim vlerësimin e kequshqyerjes, llogaritet në nivel kombëtar bazuar në një dietë energjetike.[107]

### 4.1.2 GRUPET USHQIMORE QË DO TË PËRFSHIHEN NË DIETËN MODEL

Në fakt ka një pafundësi varietetesh shportash ushqimore, të ndryshme në çmime, që i përkasin një niveli të caktuar kalorish, por përzgjedhja e artikujve për tu përfshirë në shportë është shpesh herë shumë arbitrare.[108] Vlen të theksohet se koncepti i minimumit jetik është një nocion relativ dhe përcaktimi i produkteve që duhet të përmbajë shporta e nevojave nuk shmang dot gjykimet subjektive.[109] Pavarësisht kësaj, nga modele dietash ushqimore të organizatave ndërkombëtare gjejmë të përfshira disa grupe ushqimesh që janë të domosdoshme për të qenë pjesë e saj. Këtu përmendim: drithërat dhe niseshte; ushqimet e pasura me proteina; qumështi dhe nën-produktet e qumështit; mishi dhe peshku; perimet; frutat; vajrat dhe yndyrnat; sheqernat dhe llojshmëri të tjera ushqimesh.

### 4.1.3 PËRQINDJA E KALORIVE QË DUHET TË ZËNË PROTEINAT, YNDYRNAT DHE KARBOHIDRATET NË DIETËN MODEL USHQIMET SPECIFIKE TË SECILIT GRUP USHQIMOR

FAO dhe WHO rekomandojnë që karbohidratet të sigurojnë 55-75 përqind të kalorive. Rreth 60% konsiderohet optimalja, ku peshën më të madhe e zënë drithërat. Gjithashtu për proteinat rekomandohet që duhet të përbëjnë 10-15 përqind të dietës ushqimore. Ushqimet më të pasura me proteina janë bulmetet

---

[107] Indikatorët për monitorimin e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, "Përqindja e popullsisë nën minimumin jetik të konsumit të dietës energjetike"2012, http://mdgs.un.org/unsd/mi/wiki/1-9-Proportion-of-population-below-minimum-level-of-dietary-energy-consumption.ashx

[108] L. Carraro, "Llogaritja dhe Përdorimi i Kufirit Absolut të Varfërisë", 2006, http://www.opml.co.uk/sites/default/files/FINAL_REPORT_-_calculation_and_use_of_an_absolute_poverty_line_(modified_OECD)_0.pdf

[109] J. Bradshaw, "Metodologjitë për të matur varfërinë: Më e mira është më shumë se një", 2001, http://www.bristol.ac.uk/poverty/pse/conf_pap/mex01_jrb.pdf

dhe veza. Ndërkohë sugjerimet për yndyrnat janë që të zënë 15-30% të kalorive. Pjesa e mbetur e kalorive duhet të plotësohet nga frutat, perimet dhe sheqernat, siç edhe tregohet në tabelën 18.

**Tabela 19. Shpërndarja e nevojave ushqimore sipas proteinave, yndyrnave dhe grupeve ushqimore sipas rekomandimeve të FAO**

| Drithërat (dhe ushqimet e pasura me karbohidrate) | Proteinat | Yndyrnat | Perimet dhe frutat | Sheqerna t |
|---|---|---|---|---|
| 55-75% kalori | 10-15% kalori | 15-30% kalori | 400g | <10% |

*Burimi: FAO*[110]

Pas evidentimit të nevojave energjetike për karbohidrate, proteina, yndyrna, sheqerna dhe perime e fruta do të përcaktohen ushqimet specifike të secilit grup ushqimor që do të përfshihen në dietën model.

### 4.1.4 PËRCAKTIMI I KOSTOS SË SECILIT PRODUKT USHQIMOR DHE SHUMATORES SË TYRE PËR LLOGARITJEN E KOSTOS TOTALE TË SHPORTËS

Megjithatë kaloritë e marra në vetvete nuk janë kriter mbi të cilat vlerësohet mirëqenia e individit. Përkundrazi këto kalori ushqimore përdoren për të përcaktuar shpenzimet minimum që do ti lejonin njerëzit që të arrinin këtë minimum ushqimor. Pra çka është më e rëndësishme është kosto për të blerë këto kalori. Duke shfrytëzuar të dhënat e çmimeve mesatare për njësi për secilin produkt do të llogaritet kosto përkatëse për sasinë e përcaktuar dhe më pas duke mbledhur kostot e çdo produkti në dietën model për të llogaritur koston totale të shportës ushqimore.

### 4.1.5 PËRCAKTIMI I SHPENZIMEVE JO-USHQIMORE DHE LLOGARITJA E MINIMUMIT JETIK

Megjithatë, kosto që përmbush vetëm nevojat ushqimore nuk mund të përbëjë kufirin e varfërisë duke qenë se injoron nevoja të tjera bazë të rëndësishme: të qenurit i shëndetshëm dhe i aftë për të marrë pjesë në shoqëri kërkon shpenzime për strehim, veshmbathje, shëndetësi etj. Përgjithësisht në vendet në zhvillim minimumi jetik të llogaritet me mënyrë analitike, duke i ndarë shpenzimet e njerëzve në katër grupe: shpenzime për artikuj ushqimore; shpenzime për artikuj te veshmbathjes; shpenzime për pajisje dhe orendi shtëpiake dhe shpenzime te tjera (energji elektrike, ujë, ngrohje, detergjente, shpenzime për arsim etj). [111] Kështu, varfëria nuk lidhet vetëm me të pasurit e një

---

[110] Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO), "Profili i vendit, të ushqyerit", 2005, http://www.fao.org/3/a-aq005e.pdf

[111] Për më tepër referojuni: Revista Demografia, Nr. 1, 2016

niveli të caktuar konsumi por gjithashtu me të pasurit e kushteve të mira të jetesës, të qenurit i sigurt dhe të qenurit i përfshirë në jetën sociale. [112] Ndaj është e rëndësishme të konsiderohet dhe komponentët jo-ushqimore të minimumit jetik. Pjesa e konsumit jo-ushqimor ndaj konsumit total do të shërbejë si referencë për përcaktimin e kostos jo-ushqimore që i duhet shtuar minimumit jetik ushqimor për të përllogaritur minimumin e plotë jetik.

**Figura 3. Grafiku i metodës së përdorur për llogaritjen e Minimumit Jetik**




---

[112] R. Bici dhe A. Mancellari, "Matja Shumëdimensionale e Varfërisë – Rasti i Shqipërisë", 2015, https://dialnet.unirioja.es/descarga/articulo/5575862.pdf

*Burimi: Përpunim i autorit, 2016*

Figura e mësipërme ofron një paraqitje grafike të detajuar të metodologjisë që do të përdoret në këtë studim për llogaritjen e shportës së ushqimeve minimum.

### 4.2 Të dhëna për llogaritjen e minimumit jetik në Shqipëri

Shporta ushqimore që do të përdoret për rastin e Shqipërisë do të marrë në konsideratë rekomandimet e Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO) mbi kërkesën minimum për kalori sipas moshës dhe gjinisë, duke i rregulluar sipas shpërndarjes së popullsisë në Shqipëri. Sipas rekomandimeve të FAO rezulton se numri i kalorive të nevojshme për frymë në ditë rezulton të jetë 2288 kalori. Mbështetur në nevojat energjetike ushqimore në ditë tabela e mëposhtme ofron një pasqyrë të gjitha shpenzimeve për konsum që i duhet një individi për të bërë një jetesë normale.

**Tabela 20. Burimet e kalorive në shportën e 2288 kalorive**

| | Kaloritë | Përqindja |
|---|---|---|
| Bukë dhe brumëra | 266 | 6 |
| Drithëra, miell dhe makarona | 928 | 14 |
| Mish | 60 | 17 |
| Peshk | 3 | 1 |
| Qumështi dhe produktet e qumështit | 300 | 27 |
| Vaj | 350 | 8 |
| Fruta | 11 | 2 |
| Perimet dhe bishtajoret | 101 | 15 |
| Perimet e konservuara dhe të ngrira | 99 | 2 |
| Sheqer dhe ëmbëlsira | 158 | 4 |
| Erëzat | 0 | 0 |
| Pije joalkoolike, çaj dhe kafe | 11 | 3 |
| Ushqime të tjera | 1 | 0 |
| **Totali** | **2288** | **100** |

*Burimi: INSTAT dhe Banka Botërore[113], 2002*

Kostoja mujore e produkteve të shportës së ushqimeve llogaritet duke shumëzuar sasinë mujore të një produkti me çmimin e tij mesatar. Shuma e

[113]Tabela e mësipërme është përpunuar nga INSTAT dhe BB në përcaktimin e kufirit të varfërisë në vitin 2002, http://siteresources.worldbank.org/INTLSMS/Resources/3358986-1181743055198/3877319-1190309366854/alb05cameth.pdf

kostove të të gjitha produkteve të shportës ushqimore përfaqëson koston mesatare mujore të shportës ushqimore minimum.

Pas përcaktimit të kostos minimale të shportës së ushqimeve në Shqipëri, do të llogarisim minimumin jetik duke shqyrtuar dhe pjesën qe zënë shpenzimet ushqimore ne raportin e minimumit jetik.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Minimumi jetik | = | Minimum jetik i shportës së ushqimeve | + | Minimum jetik i shpenzimeve jo-ushqimore të konsumit |

Për përcaktimin e minimumit jetik do të na shërbejnë të dhënat e Anketës së Buxhetit të Familjes të vitit 2014. Për qëllime analitike është përzgjedhur struktura tipike e shpenzimeve të konsumit të familjeve shqiptare për arritjen e një vlere minimumi jetik e cila pasqyron në të dhe tendencën e konsumit në vendin tonë. Si më poshtë paraqiten shpenzimet e konsumit të ndara sipas grupeve përkatëse.

**Tabela 21. Shpenzimet mesatare mujore për konsum**

| | Vlera (në %) | |
|---|---|---|
| Ushqim dhe pije jo-alkoolike | 44,3 | **44.3%** |
| Pije alkoolike dhe duhan | 3,6 | |
| Veshje dhe këpucë | 5,1 | |
| Shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike dhe qira e paguar | 10,2 | |
| Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje e zakonshme e banesës | 5,4 | |
| Shëndet | 4,8 | |
| Transport | 6,8 | **55.7%** |
| Komunikim | 3,3 | |
| Argëtim dhe kulturë | 3,1 | |
| Arsim | 4,2 | |
| Restorante dhe hotele | 3,2 | |
| Të tjera mallra dhe shërbime | 6,0 | |

*Burimi: Anketa e Buxhetit të Familjes, 2014*[114]

Sipas të dhënave të mësipërme dalim në përfundimin se produktet ushqimore zënë vetëm 44,3 përqind të konsumit të familjeve ndërkohë që pjesën tjetër e zënë shpenzimet e tjera të konsumit. Në këtë mënyrë nëse vlerën e minimumit jetik do ta përcaktonim X, kosto e shportës ushqimore do të jetë 0.443 X dhe kosto e gjithë produkteve jo-ushqimore dhe shërbimeve të tjera do të jetë 0.557 X.

**Tabela 22. Çmimet mesatare të shpenzimeve ushqimore të konsumit (në lekë)**

| Nr | Emërtimi | Njësia | Vjetore 2015 |
|---|---|---|---|
| 1 | Oriz | Kg | 154.4 |
| 2 | Bukë | Kg | 108.0 |
| 3 | Makarona | Kg | 178.2 |
| 4 | Miell | Kg | 93.8 |
| 5 | Mish vici | Kg | 777.6 |
| 6 | Mish derri | Kg | 557.8 |
| 7 | Mish qingji, dashi e keci | Kg | 757.8 |
| 8 | Mish pule | Kg | 361.8 |
| 9 | Sallam | Kg | 584.6 |
| 10 | Kremviçe | Kg | 537.5 |
| 11 | Proshutë | Kg | 723.4 |
| 12 | Mëlci vici, lope | Kg | 607.6 |
| 13 | Peshk i freskët | Kg | 572.6 |
| 14 | Konserva peshku | 100 gr | 107.7 |
| 15 | Qumësht i freskët | Litër | 108.5 |
| 16 | Kos natyral | Kg | 108.7 |
| 17 | Djath i bardhë | Kg | 490.3 |
| 18 | Djath kackavall | Kg | 717.9 |

[114] INSTAT, Anketa e Buxhetit të Familjes, 2014, http://www.instat.gov.al/media/309688/abf_2014_final_16_09_2015_18_34.pdf

| | | | |
|---|---|---|---|
| 19 | Gjizë | Kg | 186.0 |
| 20 | Vezë | Kokërr | 14.0 |
| 21 | Gjalp | Kg | 556.9 |
| 22 | Vaj Ulliri | Litër | 508.3 |
| 23 | Vaj luledielli | Litër | 181.9 |
| 24 | Portokalle | Kg | 130.0 |
| 25 | Limona | Kg | 198.8 |
| 26 | Mollë | Kg | 102.8 |
| 27 | Domate | Kg | 106.1 |
| 28 | Kastraveca | Kg | 108.9 |
| 29 | Speca | Kg | 136.9 |
| 30 | Ullinj | Kg | 261.3 |
| 31 | Qepë e thatë | Kg | 61.9 |
| 32 | Fasule | Kg | 264.5 |
| 33 | Patate | Kg | 54.1 |
| 34 | Sheqer | Kg | 91.1 |
| 35 | Mjaltë | Kg | 980.4 |
| 36 | Kripë | Kg | 25.1 |
| 37 | Kafe e bluar | 100 gr | 111.0 |
| 38 | Ujë mineral | liter | 44.7 |

*Burimi: INSTAT, 2016*

Në tabelën 21 jepen çmimet mesatare për produktet e mësipërme të konsumit për vitin 2015 të cilat do të na ndihmojnë të identifikojmë koston totale të shportës dhe të llogarisim vlerën e minimumit jetik për vitin 2015.

### 4.3 Përllogaritja e Nivelit të Minimumit Jetik në Shqipëri

Minimumi jetik do të përcaktohet me metodën e varfërisë absolute, duke u bazuar te shporta ushqimore. Fillimisht do të llogariten nevojat energjetike ditore

për kalori të cilat sipas rekomandimeve të FAO rezulton 2288 kalori.[115] Duke marrë në konsideratë grup-shpenzimet e shportës së ndërtuar në studimin e INSTAT dhe Bankës Botërore për përllogaritjen e kufirit të varfërisë për frymë në vitin 2002, për konsumin e produkteve të ndryshme ushqimore, në tabelën e mëposhtme jepet një shportë ushqimore që paraqet normën ditore mesatare në gram dhe kalori për një person në punë të lehtë. Kjo shportë reflekton dhe rekomandimet e Institutit të Shëndetit Publik sipas të cilit modeli i dietës ushqimore duhet të përmbajë 12-15 përqind proteina, 25-30 përqind yndyrna dhe 55-60% karbohidrate.

**Tabela 23. Norma ditore mesatare në gram dhe në kalori [116]**

| | | Kaloritë në ditë | Sasia ditore në gram |
|---|---|---|---|
| 1 | Bukë dhe brumëra | 266 | 115.65 |
| 2 | Drithëra, miell dhe makarona | 928 | 263.11 |
| 3 | Mish | 60 | 20.00 |
| 4 | Peshk | 3 | 2.75 |
| 5 | Qumështi dhe produktet e qumështit | 300 | 100.00 |
| 6 | Vaj | 350 | 39.28 |
| 7 | Fruta | 11 | 18.33 |
| 8 | Perimet dhe bishtajoret | 200 | 707.96 |
| 9 | Sheqer dhe ëmbëlsira | 158 | 43.41 |
| 10 | Erëzat | 0 | 0.00 |
| 11 | Pije joalkoolike, çaj dhe kafe | 11 | 27.50 |
| 12 | Ushqime të tjera | 1 | 0.13 |
| | **Totali** | **2288** | |

*Burimi: FAO, Përpunim i autorit, 2016*

[115] Banka botërore, "Ndërtimi i agregatit të konsumit dhe vlerësimi i kufirit të varfërisë", http://siteresources.worldbank.org/INTLSMS/Resources/3358986-1181743055198/3877319-1190310325388/Albconsagg.pdf

[116] Për konvertimin e normës së kalorive në sasi në gramë i jemi referuar ekspertëve dietologë dhe publikimeve të FAO. Për më tepër: http://www.fao.org/docrep/006/y5022e/y5022e04.htm

Për artikujt e shportës norma ditore në gram do të konvertohet në konsum mujor në kilogram (do të shumëzohen me 365 dhe do të pjesëtohen me 12). Më tej artikujt e shportës duke u shumëzuar me çmimet mesatare për njësi të ponderuara të vitit 2015 do të na japin koston në lekë për çdonjërin prej tyre dhe shumatorja e të gjithë artikujve do të na ofrojë koston e shportës ushqimore në lekë për një person në muaj. Në këtë mënyrë në tabelën 23 jepet një paraqitje me të dhëna përkatëse për çdo artikull të shportës ushqimore për vitin 2015. Siç edhe mund ta vëmë re, minimumi jetik për artikujt ushqimorë rezulton të jetë 7,089 lekë në muaj. Ky tregues përbën edhe bazën mbi të cilën do të bëhet përllogaritja e shpenzimeve të tjera të konsumit me synim përcaktimin analitik të minimumit jetik të plotë për vitin 2015.

**Tabela 24. Minimumi jetik në vlerë për artikujt ushqimorë në muaj**

| | | Norma ditore në gr. | Norma mujore në kg. | Çmimet mesatare për kg në 2015 | Vlera mujore në lekë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Bukë dhe brumëra | 115.65 | 3.52 | 61.9 | 218 |
| 2 | Drithëra, miell dhe makarona | 263.11 | 8.00 | 142.1 | 1137 |
| 3 | Mish | 20.00 | 0.61 | 613.5 | 373 |
| 4 | Peshk | 2.75 | 0.08 | 824.9 | 69 |
| 5 | Qumështi dhe produktet e qumështit | 100.00 | 3.04 | 311.7 | 948 |
| 6 | Vaj | 39.28 | 1.19 | 345.1 | 412 |
| 7 | Fruta | 18.33 | 0.56 | 143.8 | 80 |
| 8 | Perimet dhe bishtajoret | 707.96 | 21.53 | 142 | 3,058 |
| 9 | Sheqer dhe ëmbëlsira | 43.41 | 1.32 | 535.7 | 707 |
| 10 | Erëzat | 0.00 | 0.00 | 35.6 | 0 |
| 11 | Pije joalkoolike, çaj dhe kafe | 27.50 | 0.84 | 102.5 | 86 |
| 12 | Ushqime të tjera | 0.13 | 0.00 | | 0 |
| | **Totali** | | | | **7,089** |

*Burimi: INSTAT, Përpunim i autorit, 2016*

Metodika e përdorur për llogaritjen e shpenzimeve të tjera të konsumit do të realizohet duke u bazuar në raportin mes pjesës së shpenzimeve jo-ushqimore

të konsumit ndaj totalit të shpenzimeve. Sipas Anketës së Buxhetit të Familjes për vitin 2014 shpenzimet për produkte jo-ushqimore përfaqësonin 55.7 përqind të totalit të shpenzimeve të konsumit për një familje. Kështu, nevojat për produktet jo-ushqimore, të cilat përfshijnë shpenzimet për shëndet, transport, arsim etj., llogariten të jenë 8,913 lekë në muaj. Këto të fundit së bashku me koston e produkteve ushqimore na ofrojnë vlerën e minimumit jetik për frymë.

**Tabela 25. Minimumi jetik në vlerë për frymë në muaj**

| | Vlera (në %) | Lekë në muaj |
|---|---|---|
| Minimumi jetik i shpenzime ushqimore | 44.3 | 7,089 |
| Minimumi jetik i shpenzimeve jo-ushqimore | 55.7 | 8,913 |
| **Minimumi jetik për frymë** | | **16,002** |

*Burimi: Përpunim i autorit, 2016*

**Në mënyrë të përmbledhur, arrihet në përfundimin se minimumi jetik për frymë për vitin 2015 është *16,000 lekë në muaj*. Në ndryshim nga studimet e tjera mbi nivelin e minimumit jetik, vlera e përcaktuar nga ky studim merr në konsideratë edhe aspekte sociale dhe tendencat e konsumit në vendin tonë me qëllim sigurimin e një minimumi jetik sa më të përshtatshëm.**

Vlera e përllogaritur e minimumit jetik duket se luhatet në nivele më të larta se pensioni minimal, pagesa e ndihmës ekonomike, pagesa e paaftësisë dhe pagesa e papunësisë në vend, duke i ekspozuar kështu individët ndaj një jetese të pasigurt ekonomikisht. Ky rezultat vjen si pasojë e faktit se përcaktimi i vlerës për pagesat e mësipërme nuk është bërë në studime të mirëfillta që marrin në konsideratë dhe kufirin e varfërisë.

Minimumi jetik i përllogaritur në 16,000 lekë në muaj përbën shumën minimale e parave që i duhet një individi shqiptar për të siguruar një nivel jetese bazë. Kjo shifër shërben si bazë referuese mbi të cilën do të përllogaritet minimumi jetik për një të punësuar (në bazë të koeficientit të ngarkesës) dhe një familje (sipas numrit mesatar të personave për familje).

Në një analizë krahasimore të minimumit jetik në Shqipëri prej 16,000 lekë për frymë me atë vendet e Ballkanit Perëndimor vëmë re se luhatet në të njëjtat nivele me Serbinë dhe Maqedoninë, ndonëse metoda e përdorur në përllogaritjen e tij nuk është e njëjta.

Në linjën e krahasimeve, gjykohet me vlerë dhe përballja dhe krahasimi i minimumit jetik të llogaritur në 16,000 lekë për frymë sipas studimit tonë me

kufirin e varfërisë për frymë të vitit 2002 të përafruar në vitin 2015. Më poshtë, është kryer një indeksim i kufirit të varfërisë të vitit 2002 të INSTAT sipas indeksit të çmimeve të konsumit për të marrë një përafrim të tij për vitin 2015.

**Tabela 26. Kufiri i varfërisë me metodën e indeksit të çmimeve të konsumit**

| Viti | Ndryshimi Vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në përqindje) | Kufiri i Varfërisë (lekë në muaj) |
|---|---|---|
| 2002 | 5.22 | 4,891 |
| 2003 | 3.30 | 5,146 |
| 2004 | 2.20 | 5,316 |
| 2005 | 2.04 | 5,433 |
| 2006 | 2.51 | 5,544 |
| 2007 | 3.06 | 5,683 |
| 2008 | 2.16 | 5,857 |
| 2009 | 3.53 | 5,983 |
| 2010 | 3.57 | 6,194 |
| 2011 | 1.68 | 6,416 |
| 2012 | 2.43 | 6,524 |
| 2013 | 1.85 | 6,683 |
| 2014 | 0.66 | 6,806 |
| 2015 | 1.96 | **6,851** |

*Burimi: INSTAT, Përpunim i autorit, 2016*

Sipas kësaj mënyre indeksimi, vlera e kufirit të varfërisë për vitin 2015 rezulton relativisht e vogël. Kjo vjen si pasojë e faktit se baza fillestare është shumë e ulët. Megjithatë edhe pse kjo përllogaritje e INSTAT është thjeshtë treguese për kufirin e varfërisë dhe nuk ka si qëllim të ofrohet si minimum jetik, nga të dhënat mund të evidentohet se ky kufi varfërie është dukshëm më i ulët se niveli i minimumit jetik prej 16,000 lekësh në muaj.

## 4.4 NGA MINIMUMI JETIK SI FILANTROPI DREJT NJË STANDARDI JETESE TË ARSYESHËM

A mund të konsiderohet minimumi jetik prej 16,000 lekësh i mjaftueshëm për ti siguruar një jetë me dinjitet individëve? Përgjigjja do të ishte pa hezitim jo. Për ti siguruar individëve një standard jetese të arsyeshëm duhet të ngrihemi mbi konceptin e minimumit jetik. Sipas literaturës, **standard jetese i arsyeshëm** është ai standard i cili plotëson nevojat fizike, psikologjike dhe sociale të një personi. Një standard jetese i arsyeshëm nuk do të thotë që një person duhet të jetojë në një nivel luksi por as nuk nënkupton se një person duhet të jetojë vetëm në nivelin e mbijetesës. Personi që zotëron paratë duhet të jetë në gjendje që të marrë pjesë në jetën e komunitetit, njësoj si qytetarët e tjerë. Duhet të jetë e mundur për personin që të ha ushqime të shëndetshme..., të ketë rroba për mot dhe situata të ndryshme, të mbajë shtëpinë të rregullt dhe të pastër, të ketë mobilje dhe pajisje në shtëpi për pushim dhe argëtim, të jetë në gjendje që ti kushtojë kohë aktiviteteve të lira, dhe të lexojë libra, gazeta dhe të shohë televizor.[117]

Në këtë linjë, edhe Komisioni Evropian në rekomandimet e tij ka përsëritur përgjegjësinë e vendeve anëtare të BE-së në promovimin e skemave të mbështetjes së duhur me të ardhura të bazuara te "e drejta themelore e një individi në burime dhe ndihmë të mjaftueshme për të jetuar me dinjitet njerëzor, në kuadrin e një mekanizmi global dhe koherent për të luftuar varfërinë dhe përjashtimin social".[118] Në këtë mënyrë, çdo vend duhet të punojë shumë për ti ofruar të gjithëve shtetasve të vet një standard jetese që është i përshtatshëm në përputhje me mundësitë dhe kushtet mbizotëruese në vend.

Megjithatë, është e rëndësishme që trajtimi i minimumit jetik të mos shihet vetëm në këndvështrimin si detyrim i shtetit por të konsiderohet si një e drejtë themelore e çdo qenieje njerëzore. E drejta për një standard jetese të përshtatshëm njihet si një e drejtë njerëzore në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe nënkupton nevojën për të vendosur një të drejtë minimale për ushqim, veshje dhe strehim në nivelin e duhur. E drejta për ushqim dhe e drejta për strehim janë përcaktuar më tej në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut.[119] Sipas Nenit 25, gjithkush ka të drejtë për një nivel jetese të mjaftueshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij dhe familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, strehimin, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme

---

[117] Shërbimi i paaftësisë në Irlandë, "Udhëzime për një standard jetese të arsyeshëm dhe shpenzimejetese të arsyeshme", 2013, http://www.isi.gov.ie/en/isi/guidelinesundersection23-final.pdf/files/guidelinesundersection23-final.pdf

[118] Studio e Kërkimeve Sociale (SRS), F. Strati, "Italia: Skemat e të Ardhurave Minimale, Një Studim mbi Politikat Kombëtare", 2009, http://ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=9033&langId=it

[119] Deklarata Universale e të Drejtave në Zhvillim të Njeriut, 2009, http://www.world-governance.org/IMG/pdf_DUDHE.pdf

sociale, si dhe të drejtën e sigurimit në rast të papunësisë, sëmundjes, paaftësisë, vejërisë, pleqërisë etj.

Vlen të theksohet se një standard jetese i arsyeshëm është standardi i jetesës që bazohet në nevoja, dhe jo në dëshira, por është më shumë se mbijetesa dhe lejon për pjesëmarrje kuptimplotë në shoqëri. Në këtë kuadër, Indeksi i Zhvillimit Human, një tregues i përbërë nga tre faktorë bazë që ndikojnë standardin e jetesës – të ardhurat, jetëgjatësia dhe edukimi, në vlerësimin e tij të fundit për vitin 2014 e renditi Shqipërinë të 85-tën nga 188 vende në nivel global. [120] Ky është viti kur është shfaqur dhe vlera më e lartë e këtij indeksi për Shqipërinë. Megjithatë, Shqipëria ka ende punë për të bërë në këtë drejtim. Pavarësisht rëndësisë të çështjes së një standardi jetese të arsyeshëm, vendi ynë ka bërë shumë pak përmirësim vetëm me rritjen e disa pagesave sociale të caktuara.

Një standard jetese i arsyeshëm në një shoqëri të caktuar ndryshon me kalimin e kohës. Për këtë arsye është thelbësore që instancat më të larta shtetërore të angazhohen në identifikimin e një standardi jetese të arsyeshëm për Shqipërinë. Kështu rekomandohet që të bëhet një rivlerësim i nevojave energjetike ditore për një individ. Në vazhdim, identifikimi i kostove bazë të jetesë duhet të plotësohet me shpenzimet e tjera të nevojshme për sigurimin e një jetese me dinjitet. Një standard jetese i arsyeshëm është në mënyrë të patjetërsueshme i lidhur me zhvillimin ekonomik dhe kulturor të një vendi dhe është i influencuar në mënyrë të padiskutueshme nga zakonet e zonës ku individi jeton. Prandaj, një standard jetese i përshtatshëm është ai që i mundëson personit minimumin e mjeteve, të cilat do të lejonin përputhshmërinë me shoqërinë të cilës ai i përket.

Në mënyrë të përmbledhur, mund të thuhet se një standard jetese i arsyeshëm përfaqëson një standard minimum i cili të lejon të mbulosh shpenzimet bazë të jetesës dhe shpesh ky nivel është më i lartë se thjeshtë shuma e mbijetesës. Gjithashtu, individëve nuk duhet t'i diktohet se si duhet ti shpenzojnë vlerën e arsyeshme të shpenzimeve të jetesës. Këto të fundit duhet të kenë kontroll vetë mbi mënyrën e menaxhimit të të ardhurave të tyre dhe të jenë në gjendje për të marrë pjesë në komunitet si gjithë të tjerët. [121] Për këtë arsye, është i rëndësishëm identifikimi i të gjithë ndërhyrjeve dhe politikave sociale për kalimin nga nevoja e përcaktimit të minimumit jetik në atë të një standardi jetese të arsyeshëm me qëllim sigurimin e një jetese me dinjitet. Në këtë linjë, edhe

---

[120] Niveli më i lartë i zhvillimit human jepet në vlerën 1 dhe niveli me i ulët jepet afër vlerës zero. Për më tepër shiko: Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara, "Indeksi i Zhvillimit Human", Shqipëria 2015, http://hdr.undp.org/en/content/human-development-index-hdi
[121] Idem

Strategjia Kombëtare Kundër Varfërisë e Komisionit Evropian rekomandon që politikat të cilat mbështeten te të ardhurat duhet të synojnë sigurimin e të ardhurave të mjaftueshme për të gjithë individët në mënyrë që të dalin nga varfëria dhe të jetojnë në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerëzor.[122]

[122] Agjencia e Luftimit të Varfërisë, "Një përmbledhje e propozimeve për rishikimin e strategjisë kombëtare kundër varfërisë", 200, https://books.google.al/books?id=I0BFbZZWkDcC&pg=PA25&lpg=PA25&dq=the+national+anti-poverty+strategy+european+commission+minimum+income&source=bl&ots=j_w76T2N_D&sig=IRELzhkjoqHVSNqk4c3Bqh69HUI&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwiqyraL9M_PAhVCzRQKHVKqCOkQ6AEIJzAC#v=onepage&q=the%20national%20anti-poverty%20strategy%20european%20commission%20minimum%20income&f=false

## 5. CESHTJE PER DISKUTIM

### 5.1 INDEKSIMI I MINIMUMIT JETIK

Me qëllim pasjen e një minimumi jetik real ndër vite është thelbësore indeksimi i tij. Me kalimin e viteve vihet re se një ecuri pozitive e raportit të shpenzimeve për produkte ushqimore ndaj totalit të produkteve. Në të kundërt shpenzimet jo-ushqimore kanè ardhur në rritje dhe prirja është që të rriten dhe më shumë. Ky fakt pasqyron dukurinë pozitive të përmirësimit të nivelit të jetesës. Si pasojë, çdo përmirësim në ekonomi ka një ndikim të drejtpërdrejtë në nivelin e standardit të jetesës dhe për këtë arsye duhet të reflektohet dhe në vlerën e minimumit jetik.

Ndër faktorët që ndikojnë në indeksimin e minimumit jetik mund të përmendim inflacionin, remitancat apo aksionet e ndryshme të ndërmarra nga qeveria kundër informalitetit. Në vijim jepet një analizë për secilin prej këtyre treguesve.

#### 5.1.1 INFLACIONI

Minimumit jetik duhet të rregullohet patjetër me normën e inflacionit në vend. Kështu kur norma e inflacionit rritet, bie vlera e parasë dhe si pasojë çmimet bëhen më të shtrenjta. Inflacioni sasinë e mallrave që mund të blihen me një shumë të caktuar parash.[123] Për këtë arsye, minimumi jetik duhet të rritet mjaftueshëm aq sa për të kompensuar këtë rënie të fuqisë blerëse të konsumatorëve.

Siç mund të vërejmë nga figura e mëposhtme norma e inflacionit në Shqipëri, pavarësisht synimit të Bankës së Shqipërisë për ta mbajtur inflacionin në nivelin 3 përqind me marzh plus minus 1 përqind, duket sikur nga viti 2010 nuk është mbajtur shumë në kontroll. Për këtë motiv, *ndikimi i treguesit të inflacionit përbën një nevojë për rillogaritjen apo indeksimin e minimumit jetik*.

[123] K. Harriot, "Fakte Thelbësore për Inflacionin", 2002, http://boj.org.jm/uploads/pdf/papers_pamphlets/papers_pamphlets_Essential_Facts_About_Inflation_.pdf

**Figura 4. Inflacioni në Shqipëri në vitet 2000-2015**




*Burimi: Banka Botërore, 2016*

### 5.1.2 REMITANCAT

Remitancat përcaktohen nga Fondi Monetar Ndërkombëtar si transferta rrjedhëse private nga emigrantët të cilët konsiderohen rezidentë të vendit pritës, te marrësit në vendin e origjinës së emigrantit.[124] Remitancat mund të ndikojnë në kufirin e varfërisë së një të varfri, duke rritur të ardhurat për individët dhe familjet dhe për këtë arsye janë një instrument i fuqishëm kundër varfërisë në vendet në zhvillim.[125] Kështu edhe në Shqipëri remitancat kanë luajtur një rol të rëndësishëm në përballimin e varfërisë për shumë familje shqiptare.

**Figura 5. Remitancat personale në Shqipëri 1992-2015 (në milionë $ amerikan)**




*Burimi: Banka Botërore, 2016*

Remitancat në Shqipëri kanë ardhur gjithmonë në rritje deri në vitin 2008. Pas krizës financiare që përfshiu gjithë botën, vëmë re një ulje të nivelit të remitancave nga jashtë. Kjo ulje e remitancave ka çuar dhe në reduktim e të ardhurave familjare për shumë shqiptarë. Studime të ndryshme sugjerojnë se thuajse 90 përqind e remitancave që vijnë në Shqipëri shkojnë për konsum.[126] Në

---

[124] Fondi Monetar Ndërkombëtar, "Manuali i Pozicionimit të Balancave të Pagesave dhe Investimeve Ndërkombëtare", Botimi 6, 2010, https://www.imf.org/external/pubs/ft/bop/2007/pdf/bpm6.pdf

[125] D. Ratha, "Ndikimi i Remitancave në Rritjen Ekonomike dhe Reduktimin e Varfërisë", Instituti i Politikave të Migrimit (mpi), Analizë e Përmbledhur Nr. 8, Shtator 2013, www.migrationpolicy.org/pubs/Remittances-PovertyReduction.pdf

[126] IOM dhe ILO, "Rritja e Ndikimit të Remitancave të Migrantëve në Shqipëri", 2007, fq 9-22

këtë kuadër, është i rëndësishëm *rregullimi i minimumit jetik për të mbuluar pakësimin e të ardhurave në buxhetin e familjes si pasojë e uljes së prurjeve të remitancave.*

### 5.1.3 Reformat e Qeverisë Kundër Informalitetit

Përgjatë dy viteve të fundit, Shqipëria është përballur aksionet e qeverisë përsa i përket pagesave të prapambetura të energjisë. Skema e cila është ofruar për mbledhjen e detyrime të prapambetur në energji ka qenë pagesa me këste dhe nxitja e tyre nëpërmjet faljes së kamatëvonesave. Kështu, këto pagesa përbëjnë kosto të shtuar në shpenzimet e familjes. Aksione të tilla mund të themi se kanë një natyrë disi agresive pasi *ekspozojnë një nivel të lartë të popullsisë ndaj varfërisë dhe si të tilla duhet të balancohen nëpërmjet një indeksimi në vlerën e minimumit jetik.*

## 5.2 IMPLIKIMET E PËRLLOGARITJES SË MINIMUMIT JETIK NË VEND

Përllogaritja e minimumit jetik nënkupton identifikimin e një indikatori i cili do të shërbejë si referencë për përmirësimin e efektivitetit të skemës së asistencës sociale. Përdorimi i tij si një guidë për politikat sociale që synojnë: reflektimin e ndryshimeve në standardin e jetesës së popullatës, përcaktimin e popullsisë së varfër të targetuar për asistencën sociale, përcaktimin e shumës minimale të pensioneve, përcaktimin e pagës minimale në varësi të nivelit të minimum jetik .

### 5.2.1 NDIKIMI NË PAGËN MINIMALE

Përllogaritja e minimumit jetik zyrtar ka një ndikim të drejtpërdrejtë te paga minimale zyrtare, e cila përfaqëson dhe pikënisjen mbi të cilën llogariten pagat si në sektorin publik dhe në atë privat. Në një kohë kur 70% e të punësuarve në sektorin privat paguhen me pagë minimale, çdo vendim i marrë për ndryshimin e saj ka një efekt domethënës në ekonomi. Në bazë të studimeve të shumta mendohet se një i punësuar është përgjegjës dhe për mbajtjen ekonomikisht të një individi tjetër. Për këtë arsye gjykohet se paga minimale duhet të bazohet në vlerën e minimumit jetik. Këtu shohim se trendi i pagës minimale në Shqipëri është luhatur nën këtë nivel dhe aktualisht paga minimale mbulon vetëm 69 përqind të nivelit të minimumit jetik prej 16,000 lekësh. Ekspertët argumentojnë se paga minimale duhet të rritet pasi ajo lidhet direkt me pensionet, punësimin e papunësisë, pagesën e paaftësisë të tjera përfitime të cilat po rrisin nivelin e varfërisë.[127]

Nga ana tjetër, këtu vlejnë të përmenden edhe studime të shumta sipas të cilave një rritje e pagës minimale do të çonte në rritjen e papunësisë. Për këtë arsye përpara ndërmarrjes së çdo lloj politike rregulluese është e rëndësishme që çdo vendimmarrje për ndryshim e pagës minimale, krahas minimumit jetik duhet të marrë në konsideratë dhe burimet e krijuara nga rritja e produktivitetit të punës dhe shtimi i pasurisë.

### 5.2.2 NDIKIMI NË SIGURIMET SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE

Nga ana tjetër cilido person që është në marrëdhënie pune ka për detyrim që të derdhë kontribute në skemën sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në masën 21.6%, që konsiderohet dhe si taksa e punës. Por a është e drejtë që individi të paguajë taksë pune dhe mbi atë pagesën që konsiderohet minimumi jetik për të përballuar jetesën? Nga pikëpamja sociale, duke marrë në konsideratë edhe dinjitetin e individëve, organet ligjvënëse nuk duhet ta taksojnë shumën e

[127] Koço Broka, "Paga Minimale dhe Minimumi Jetik në Shqipëri", 2016, http://telegraf.al/opinion/koco-broka-paga-minimale-dhe-minimumi-jetik-ne-shqiperi

minimumit jetik, duke përjashtuar nga taksat të ardhurat të cilat janë nën nivelin e minimumit jetik dhe duke taksuar vetëm kapacitetin ekonomik sipër kësaj vlere. [128] Për këtë arsye është e sugjerueshme rishikimi i kuadrit ligjor për të ardhurat personale dhe taksimit të tyre duke pasur si referencë minimumin jetik.

### 5.2.3 Ndikimi te Pensionet

Një ndër ndikimet më të mëdha të minimumit jetik është efekti i menjëhershëm që minimumi jetik për frymë ka te pensionet. Duke qenë se ky tregues shërben si bazë për matjen e nivelit të mirëqenies dhe varfërisë ai duhet të ketë gjithmonë një karakter dinamik dhe të ndryshojë në varësi të inflacionit, dhe si pasojë të ndryshojnë dhe pensionet në mënyrë për ti siguruar pensionistëve një nivel jetese bazë.

Ajo çka vihet re është se diferenca mes minimumit jetik (16,000 lekë në muaj) dhe pensionit minimal është më e afërt për pensionet minimale në qytet se ato në fshat. Për më tepër kjo diferencë është akoma më e madhe në rastin e pensionit social (6750 lekë në muaj), i cili nuk mbulon as gjysmën e nivelit të minimumit jetik. Ekspertët sugjerojnë se për ti siguruar pensionistëve një jetesë me dinjitet duhet që pensioni social të barazohet me nivelin e minimumit jetik.[129] Duke marrë në konsideratë se pensioni minimal nuk është i mjaftueshëm për të arritur nivelin e minimumit jetik, një tjetër mundësi është që të moshuarit të ndihmohen nëpërmjet subvencionimit të energjisë elektrike, telefonisë fikse, transportit, nëpërmjet sigurimit të strehimit etj.[130]

### 5.2.4 Ndikimi te Ndihma Ekonomike

Një tjetër pagesë e cila duhet të marrë në konsideratë minimumin jetik është NE. Niveli i NE në Shqipëri luhatet në vlera shumë të vogla të cilat janë të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet e një familjeje. Ndaj për këtë pagesë llogaritja e minimumit jetik për familje do të shërbente si etalon matës për përcaktimin e një ndihme ekonomike adekuate. Aktualisht NE llogaritet të jetë te 4,500 lekë në muaj për një familje [131]. Sipas INSTAT, një familje në Shqipëri ka mesatarisht 3.8 persona, ndaj dhe NE për frymë rezulton të jetë afërsisht 1,200

---

[128] I. Vukcevic, "(Mungesa e) Të kuptuarit e rregullit të aftësisë-për-të-paguar në sistemin tatimor në Mal të Zi – Rast praktik i gjykatës kushtetuese dhe qasja legjislative", 2014, http://ojs.ius.bg.ac.rs/index.php/anali/article/view/40/74

[129] N. Hasa, 2014, http://www.dw.com/sq/sistemi-i-pensioneve-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-nevoj%C3%AB-urgjente-p%C3%ABr-reformim/a-17382066

[130] D. Anxo, G. Bosch dhe J. Rubery, "Shteti i Mirëqenies dhe Tranziocionet Jetësore: Një Perspektivë Evropiane", 2010, https://books.google.al/books?id=5lzTidB4PvkC&pg=PA121&lpg=PA121&dq=minimum+subsistence+european+perspective&source=bl&ots=CFDrOWYXRC&sig=w8IFCJsGrBlaimHWpNFgIs-AQeA&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwin_YjtzsDPAhWjKMAKHSHCA00Q6AEIPjAG#v=onepage&q=minimum%20subsistence%20european%20perspective&f=false

[131] INSTAT, 2013

lekë në muaj. Siç mund të vlerësohet lehtësisht kjo shifër nuk mbulon as 10 përqind të minimumit jetik për frymë prej 16,000 lekësh, duke përfaqësuar një nivel NE thuajse të pa konsiderueshëm. Duke marrë në konsideratë se në vitin 2013 figuronin 104,398 familje shqiptare në ndihmë ekonomike, është e nevojshme që ti sigurohet këtyre të fundit niveli i minimumit jetik.

### 5.2.5 NDIKIMI TE PAGESA E PAPUNËSISË

Pagesa e papunësisë në Shqipëri ka pësuar një rritje prej 60% gjatë vitit të fundit ku nga 6,850 leke u rrit në 11,000 lekë. Vlen të përmendet se kjo rritje e menjëhershme e saj u bazua në Konventën Ndërkombëtare Nr. 168 të ILO-s, sipas të cilës pagesa e papunësisë duhet të jetë të paktën sa 50 përqind e pagës minimale në shkallë vendi. Megjithatë në situatën ku paga minimale vendoset apriori me VKM pa u mbështetur në studime të mirëfillta, për pasojë dhe pagesa mujore e papunësisë është nën nivelin e minimumit jetik. Megjithatë, këtu vlen të theksohet se treguesi i pagesës së papunësisë duket se është më afër nivelit të minimumit jetik se pagesat e tjera sociale, duke mbuluar rreth 69 përqind të vlerës së minimumit jetik. Ndaj, ende është i nevojshëm të reflektohet ndikimi i plotë që ka minimumi jetik te pagesa e papunësisë.

### 5.2.6 NDIKIMI TE PAGESA E PAAFTËSISË NE PUNE

Pagesa e paaftësisë simbolizon dhe treguesin më sensitiv të mbështetjes sociale. Individët përfitues së kësaj pagese duhet të përfitojnë një shumë të tillë monetare që ti sigurojë atyre një nivel jetese bazë por ti mbulojë dhe shpenzimet mjekësore të nevojshme për paaftësinë e tyre. Numri i përfituesve për aftësinë e kufizuar për vitin 2013 ka qenë 168,574 persona dhe pagesa e aftësisë së kufizuar llogarite të ketë qenë mesatarisht te 93,000 lekë në muaj.[132] Vërehet se kjo pagesë është dukshëm nën minimumin jetik dhe nuk mbulon as shpenzimet e tjera mjekësore të nevojshme për PAK. Për këtë motiv është e nevojshme që kjo pagesë të rillogaritet mbi bazën e nivelit të minimumit jetik dhe të përfshijë dhe kostot shtesë për kujdesin shëndetësor të tyre.

---

[132] Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Fact Sheet "Pagesat për Aftësinë e Kufizuar", http://www.sociale.gov.al/al/dokumente/fact-sheet/pagesat-per-aftesine-e-kufizuar&page=1

# 6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

## 6.1 Disa Përfundime Kryesore

Sipas çështjeve kryesore të trajtuara në studim, ky seksion jep në mënyrë të përmbledhur disa përfundime si më poshtë.

- Në Shqipëri vihet re një mungesë dhe vështirësi në aksesimin e të dhënave zyrtare të nevojshme për përllogaritjen e minimumit jetik. Nuk ka asnjë informacion të plotë dhe të përditësuar, si dhe as mbi studimet që janë bërë mbi minimumin jetik.

- Minimumi jetik llogaritet kryesisht me dy metoda: metodën relative varfërisë relative dhe ajo e varfërisë absolute. Vendet në zhvillim përdorin metodën absolute, kurse vendet e pasura, përjashtuar SHBA, përdorin metodën relative. Për përcaktimin e minimumit jetik në Shqipëri është përdorur gjithmonë metoda e varfërisë absolute.

- Kufiri i varfërisë sipas EUROSTAT është dukshëm më i lartë në vendet themeluese të BE-së se në ato të hyra rishtazi dhe kufiri i varfërisë reflektohet të kapë nivele akoma më të ulëta në vendet e Ballkanit Perëndimor, kryesisht në ato që ende nuk janë anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Fatkeqësisht për Shqipërinë nuk është bërë ende një përllogaritje e kufirit të varfërisë sipas metodës relative por vlen të përmendet se duke filluar nga viti tjetër dhe vendi jonë do të jetë pjesë e përllogaritjes së EUROSTAT.

- Përpjekjet e bëra në Shqipëri për llogaritjen e minimumit jetik nga institucionet janë shumë të vakëta dhe të shkëputura në kohë. Llogaritjen e parë e hasim në vitet e fundit të regjimit komunist në 1989 dhe më tej janë bërë vlerësime në vitin 1991 nga Ministria e Ekonomisë dhe në 2001 nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale. Në vazhdim, në këtë drejtim vlerësimi i vetëm i kryer është ai kufirit të varfërisë për frymë i përcaktuar nga INSTAT në vitin 2002, 2005, 2008, 2012. Kontribut në këtë fushë kanë dhënë dhe studiues të pavarur (L. Shahollari, 1995; I.Telo, 1998; dhe K. Ziso, 2011) me studimet e tyre mbi përcaktimin e minimumit jetik. Vlerësimet e bëra të minimumit jetik qoftë nga institucionet dhe nga studiuesit e pavarur janë jo konsistente. Kjo vjen si pasojë edhe e faktit se të dhënat e ofruara nuk kanë vazhdimësi, dhe si pasojë krahasimi i tyre mbetet i diskutueshëm.

- Përcaktimi i parë i rëndësishëm i minimumit jetik në Shqipëri evidentohet në Kodin e Punës së vitit 1995. Me amendimet që i janë bërë KP në vitet në vijim, koncepti i minimumit jetik është hequr duke çliruar në këtë mënyrë qeverinë nga detyrimi për llogaritjen e minimumit jetik. Referencë e rëndësishme në legjislacion shqiptar referuar minimumit jetik është ajo e vitit 2001 në VKM për "Për një Shtesë Fondi në Buxhetin e Vitit 2001, të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, për Projektin "Minimumi Jetik, Zyrtar"". Ndërkohë prej atëherë, kuadri ligjor në Shqipëri nuk parashikon asnjë dispozitë për llogaritjen e minimumit jetik në vend dhe as të institucionit përgjegjës për vlerësimin e tij.

- Në vendin tonë, niveli i pensioneve është i vendosur me ligj, ndërsa niveli i pagës minimale vlera e ndihmës ekonomike, pagesës së papunësisë dhe pagesës së paaftësisë përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Asnjëri prej këtyre treguesve të varfërisë nuk bazohet në treguesin e minimumit jetik.

- Minimumi jetik për frymë në Shqipëri sipas metodës absolute në vitin 2015 rezultoi të jetë 16,000 lekë në muaj (7,089 lekë në muaj për shpenzimet ushqimore dhe 8,913 lekë në muaj për shpenzimet jo-ushqimore). Në ndryshim nga studimet e tjera mbi nivelin e minimumit jetik, vlera e përcaktuar nga ky studim merr në konsideratë edhe aspekte sociale dhe tendencat e konsumit në vendin tonë me qëllim sigurimin e një minimumi jetik sa më të përshtatshëm.

- Minimumi jetik prej 16,000 lekë në muaj për frymë në Shqipëri vërehet se luhatet në të njëjtat nivele me vendet e Ballkanit Perëndimor, veçanërisht me Serbinë dhe Maqedoninë. Kjo ngjashmëri me vendet e rajonit rrit kredibilitetin e vlerës së përllogaritur nga ky studim.

- Konsiderohet e nevojshme dhe do të përbënte vlerë të shtuar ngritja e çështjes mbi konceptin e minimumit jetik në atë të një standardi jetese të arsyeshëm me qëllim për ti siguruar individëve të drejtën e tyre themelore për një jetesë me dinjitet.

- Duke marrë në konsideratë se treguesi i minimumit jetik ka një karakter dinamik është nevojshëm indeksimi i tij. Në Shqipëri, mungon Indeksi i Çmimeve të Shportës së Konsumit mbi bazën e të cilit mund të bëhet llogaritja automatike e minimumit jetik për vitet pasardhëse.

- Për sa i përket kuadrit të mbështetjes sociale, nëpërmjet një analize të thjeshtë krahasimore vlerësohet se standardi i pagës minimale, pensionit minimal, ndihmës ekonomike, pagesës së papunësisë dhe pagesës së paaftësisë në vend është më i ulët se niveli i llogaritu i minimumit jetik prej 16,000 lekë në muaj për frymë.

## 6.2 DISA REKOMANDIME KRYESORE

Në përmbyllje të këtij raporti dhe në vijim të përfundimeve të trajtuara më sipër po paraqesim disa rekomandime lidhur me tematikën, minimumin jetik dhe zhvillimet e mëtejshme referuar përllogaritjes dhe përdorimit të tij. Matja e kryer në këtë studim bazohet te metoda e varfërisë absolute dhe rekomandimet në vijim mbështesin zbatimin e kësaj metode në vijimësi.

- ✓ Përcaktimi me ligj i detyrimit për **llogaritjen e minimumit jetik** dhe institucionit përgjegjës të ngarkuar me këtë detyrë dhe reflektimi në legjislacion nevojës për indeksimin e këtij treguesi çdo vit.

- ✓ Në kuadër të mënyrës së llogaritjes së minimumit jetik, sugjerohet **përzgjedhja e një metode të përshtatshme dhe zbatimi i saj në mënyrë të vazhdueshme**. Për këtë qëllim rekomandohet krijimi i infrastrukturës së nevojshme që ti vijë në ndihmë dhe në shërbim përcaktimit të minimumit jetik.

- ✓ Për llogaritjen e minimumit jetik është thelbësore **përfshirja institucionale**[133] **për sigurimin e infrastrukturës** në tërësi dhe komponentëve përbërës specifikë të nevojshëm. Në vijim përmenden hapat nëpër të cilat duhet të ndërveprojë administrata publike:

  - Zhvillimi i një baze të dhënash për të mbështetur zbatimin e metodologjisë së llogaritjes së minimumit jetik, duke u mbështetur në elementët bazë të këtij vlerësimi.

    a) Të dhënat sa i takon shportës ushqimore rekomandohet që të përpunohen dhe proçesohen nga INSTAT.

    b) Nevojat energjetike për një individ mesatar në ditë duhet të publikohen çdo vit nga Instituti i Shëndetit Publik. Gjithashtu ISHP-ja sugjerohet që të përcaktojë peshat kalorifike për çdo produkt të shportës ushqimore të INSTAT në ditë/muaj.

---

[133] Për përgjegjësitë specifike institucionale referojuni Tabelës 23

- Përllogaritja e vlerës së minimumit jetik nga Instituti i Statistikave në bazë të çmimeve mesatare të referuara për vitin përkatës. Më pas INSTAT bën publikimin zyrtar të vlerës përkatëse të minimumit jetik si edhe ofron akses të plotë në të dhënat për përllogaritjen për të interesuarit.

- Publikimi zyrtar dhe dërgimi në formë zyrtare pranë ministrisë përgjegjëse dhe organeve e tjera të varësisë detyron strukturat qeveritare dhe vartëse të përdorin vlerën e minimumit jetik për efekt të përcaktimit të zërave në Buxhetin e Shtetit. Këshilli Kombëtar i Punës, luan rolin e monitoruesit dhe kujdeset që kjo shifër të merret në konsideratë në përllogaritjet e pagave minimale. Është e rekomandueshme që shqyrtimi i përcaktimit të madhësisë së minimumit jetik nga qeveria dhe implikimet përkatëse ne sistemin e pagave e pensioneve etj., tëndjekë proçesin e hartimit te buxhetit për vitin pasardhës dhe të reflektojë implikimet eventuale.

✓ Pas publikimit të vlerës së minimumit jetik, është i domosdoshëm **monitorimi i zbatimit të minimumit** të llogaritur. Këtu zë vend të veçantë përfshirja dhe kontributi i sindikatave dhe Organizatave të Shoqërisë Civile në ndërgjegjësimin e opinionit publik dhe në ushtrimin e një presioni pozitiv ndaj qeverisë për:

  - Përllogaritjen e përvitshme të vlerës së minimumit jetik;
  - Pagesën e detyrimeve të sigurimeve shoqërore;
  - Zbatimin e strategjisë se përfshirjes sociale;
  - Kujdesin ndaj shtresave te marxhinalizuara etj

✓ Krahas metodës absolute të llogaritjes së minimumit jetik, duke u nisur nga interesi dhe detyrimet e vendit në kuadër të anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe po ashtu nga përvoja e vendeve fqinje lidhur me vlerësimin e minimumit jetik, rekomandohet gjithashtu krijimi i infrastrukturës përkatëse për të mbështetur Eurostat në përcaktimin e kufirit të varfërisë sipas medianës.

✓ Duke ndjekur perspektivën evropiane të Shqipërisë, rekomandohet gjithashtu që ashtu si vendet anëtare në BE dhe Shqipëria të rrisë fokusin te "Të Drejtat Ekonomike, Kulturore dhe Sociale (ESCR)" në politikat e saj të brendshme, duke theksuar njohjen e qartë të dimensionit të drejtave të njeriut në fusha të tilla si politika sociale, shëndetësi, arsim, akses në ushqime dhe ujë, ose të standardit të jetesës dhe duke promovuar e mbështetur zhvillimin dhe rritjen e mbulimit të mbrojtjes sociale dhe zbatimin gradual të standardeve më të larta të garancive sociale. Në këtë kontekst rekomandohet që në rishikimin më të

parë të kushtetutës së vendit kjo tërësi të drejtash për një standard jetese të arsyeshëm të reflektohet përkatësisht.

Për një ndërveprim më të mirë të institucioneve publike në tabelën e mëposhtme jepet në mënyrë të detajuar një matricë me ndërhyrjet e rekomanduara.

**Tabela 27. Matrica e ndërhyrjeve të rekomanduara**

| Institucioni | Çështja | Ndërhyrja e rekomanduar | Akti ligjor qe preket |
|---|---|---|---|
| **Kuvendi / Qeveria** | Përfshirja e përcaktimit të minimumit jetik në kuadrin ligjor | Rishikimi i kuadrit ligjor për llogaritjen e minimumit jetik dhe krijimi i një baze ligjore të fortë për përllogaritjen e minimumit jetik sipas bazave shkencore dhe përgjegjësive institucionale | **Ligji Nr. 9125**, datë 29.07.2003, *"Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë"*<br><br>Amendimi i Kodit të Punës aktual të Republikës së Shqipërisë. Më specifikisht, ripërfshirja e nocionit të minimumit jetik dhe institucionit përgjegjës për llogaritjen e tij në **Nenin 123** të këtij kodi. |
| | | Amendim i ligjit për Këshillin Kombëtar të Punës dhe përfshirjen në funksionet e tij, dhe përdorimin e minimumit jetik në orientimin e pagave, pensioneve dhe përkrahjes sociale. | **Vendimi Nr. 1039**, datë 4.12.2013, "*Për Funksionimin e Këshillit Kombëtar të Punës dhe për Caktimin e Përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave në këtë Këshill*"<br><br>Në pikën 10 të këtij vendimi duhet të specifikohet funksioni i funksioni në rivlerësimin e pagave në varësi të nivelit të minimumit jetik |
| **Instituti i Statistikave INSTAT** | Përllogaritja e madhësisë së minimumit jetik | Amendimi i ligjit për INSTAT, me synim përfshirjen në funksionet e këtij institucioni dhe atë të llogaritjes së minimumit jetik | **Ligji Nr. 9180**, datë 05.02.2004 (i amenduar për herë të fundit në 2013), *"Për Statistika Zyrtare"*<br><br>Përfshirja në Nenin 7 në përgjegjësitë e |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | INSTAT dhe atë të përllogaritjes së madhësisë së minimumit jetik |
| | Lëvrimi dhe publikimi i të dhënave | Mbledhja e të dhënave dhe publikimi i tyre sipas formatit të përcaktuar në standardet evropiane (direktiva BE) | **Ligji Nr. 9180**, datë 05.02.2004 (i amenduar në 2012 dhe 2013), *"Për Statistika Zyrtare"*<br><br>Përcaktimi në Nenin 8 për detyrat e INSTAT që ky institucion duhet të mbledhë, përpunojë dhe publikojë të dhënat sipas standardeve evropiane |
| **Instituti i Shëndetit Publik ISHP** | Sigurimi i të dhënave shkencore periodike (mbi baza vjetore) i nevojës për kalori në ditë | Amendimi i ligjit për ISHP me Urdhër të ministrit të shëndetësisë për përcaktimin në funksionet të tij të publikimit të nevojave energjetike për kalori në ditë për frymë | **Ligji Nr. 10138**, datë 11.05.2009, *"Për Shëndetin Publik"*<br><br>Në Nenin 15 të këtij ligji duhet të përfshihet në funksionet e ISHP përcaktimi i nevojës ditore për kalori për një individ mesatar |
| **Instituti i Sigurimeve Shoqërore ISSH** | Përdorimi i minimumit jetik si bazë për llogaritjen e përfitimeve | Përfshirja në ligjin për ISSH të llogaritjes së përfitimeve sociale duke përdorur minimumin jetik si referencë. Gjithashtu indeksimi i këtyre pagesave sociale sipas indeksimit të minimumit jetik | **Ligji Nr. 7703**, datë 11.05.1993, *"Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë"*<br><br>Ndërhyrja në Nenin 59 për përfshirjen e minimumit jetik si bazë në vlerësimin e indeksimit të pensionit minimal, pagesës së paaftësisë etj |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Sindikatat** | Advokimi për minimumin jetik | Ndërgjegjësimi publik dhe rritja e presionit pozitiv te këshilli kombëtar i punës për çështjen e minimumit jetik | Aktivitete sindikaliste, mbledhje, konsultime me instancat shtetërore për advokimin e vlerës së minimumit jetik dhe impaktit të tij |
| **Shoqëria Civile** | Monitorimi i Minimumit Jetik | Monitorimi dhe publikimi i raporteve mbi ecurinë e zbatimit të minimumit jetik, sipas dhe sugjerimeve të Avokatit të Popullit | Nënshkrimi i një **memorandumi bashkëpunimi** midis OSHC-ve për angazhimin e tyre për zbatimin minimumit jetik (çdo vit)  dhe  publikimin e raporteve të lidhura me të |

*Burimi: Përpunim i autorit*

## Bibliografi e Zgjedhur


A. Atkinson dhe F. Bourguignon, "Krahasimi i shpërndarjeve multidimensionale të gjendjes ekonomike", fq 183-201., http://www.darp.lse.ac.uk/papersdb/Atkinson-Bourguignon_(REStud_82).pdf;

A. Domińczak, P. Strzelecki, Pensioni minimal si instrument i mbrojtjes nga varfëria në sistemit të caktuar të pensioneve - shembulli i Polonisë, Shtator 2010, https://mpra.ub.uni-muenchen.de/25262/1/MPRA_paper_25262.pdf

A. Hado, A. Koxhaj dhe O. Metalla, "Reformimi i skemës së pensioneve në Shqipëri", 2015, http://eujournal.org/index.php/esj/article/viewFile/6379/6130

A. K. Sen, "Varfëria: Një qasje rendore për matjen", Ekonometrika 44 (1976), 219-231, http://dds.cepal.org/infancia/guia-para-estimar-la-pobreza-infantil/bibliografia/capitulo-III/Sen%20Amartya%20(1976)%20Poverty%20an%20ordinal%20approach%20to%20measurement.pdf

Spaho Alma, "Përcaktuesit e varfërisë në Shqipëri, 2014, http://www.mcser.org/journal/index.php/jesr/article/viewFile/2811/2774

Agjencia e Statistikave të Kosovës, "Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore 2015 në Kosovë", 2016, http://ask.rks-gov.net/sq/tregut-i-punes?download=1635:rezultatet-e-anketes-se-fuqise-punetore-2015-ne-kosove

Avokati i Popullit, "Minimumi Jetik", Botim periodik i institucionit të Avokatit të Popullit Nr.2, Shkurt 2015, fq. 8-10

Avokati i Popullit, Raport vjetor i vitit 2011, Tiranë, 2012, http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/Raporti_2001.pdf

Banka Botërore, "Kufiri ndërkombëtar i varfërisë", http://www.worldbank.org/en/topic/poverty/brief/global-poverty-line-faq

Banka botërore, "Ndërtimi i agregatit të konsumit dhe vlerësimi i kufirit të varfërisë", http://siteresources.worldbank.org/INTLSMS/Resources/3358986-1181743055198/3877319-1190310325388/Albconsagg.pdf

Banka Botërore, "Shënim për politikën e pensioneve, sfidat dhe drejtimet kryesore për reformën", 2013, http://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2014/06/L3-Albania-Pension-Policy-Note.pdf

Banka Botërore, "Shqipëria, programi "Snapshot"", 2015, https://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Albania-Snapshot.pdf

Banka Botërore, "Zgjedhja dhe matja e një kufiri varfërie", 2015, http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/TOPICS/EXTPOVERTY/EXTPA/0,,contentMDK:20242879~menuPK:435055~pagePK:148956~piPK:216618~theSitePK:430367,00.html

Banka Botërore, A.Coudouel, J. S. Hentschel, dhe Q. T. Wodon, "Teknikat kryesore dhe problematikat ndërsektoriale, kapitulli 1. Matja e varfërisë dhe analiza", http://siteresources.worldbank.org/INTPRS1/Resources/383606-1205334112622/5467_chap1.pdf

C.Garroway dhe J. R. Laiglesia, "Për rëndësinë e varfërisë relative për vendet në zhvillim", 2012, http://www.oecd-ilibrary.org/docserver/download/5k92n2x6pts3.pdf?expires=1473921275&id=id&accname=guest&checksum=6E10AF4E11F6DD542E3C3E9EF674DC3F

D. Ratha, "Ndikimi i remitancave në rritjen ekonomike dhe reduktimin e varfërisë", Instituti i Politikave të Migrimit (mpi), analizë e përmbledhur Nr. 8, Shtator 2013, www.migrationpolicy.org/pubs/Remittances-PovertyReduction.pdf

Departamenti i Kërkimit Kela, "Përshtatshmëria e sigurisë sociale bazë në Finlandë 2011-2015", 2015, https://www.julkari.fi/bitstream/handle/10024/126908/WorkingPapers80%20(1).pdf?sequence=1

E. Liu dhe J.Liu, "Llogaritja e varfërisë", 1998, http://www.legco.gov.hk/yr97-98/english/sec/library/07plc.pdf

E. Maasoumi, "Matja dhe zbërthimi i pabarazisë shumëdimensionale", http://www.ophi.org.uk/wp-content/uploads/ssMaasoumi-1986.pdf;

E. Wratten, "Konceptualizimi i varfërisë urbane, mjedisi dhe urbanizimi" 1995, http://eau.sagepub.com/content/7/1/11.full.pdf+html

Eurostat, 2016, Të dhëna mbi punësimin, http://ec.europa.eu/eurostat/tgm/table.do?tab=table&init=1&language=en&pcode=tsdec410&plugin=1

F. Bourguignon dhe S. R. Chakravarty, Banka Botërore, "Matja e varfërisë shumëdimensionale", Journal of Economic Inequality, 2003, http://siteresources.worldbank.org/INTPA/Resources/429966-1092778639630/bourguignon.pdf

F. Sheri, J.Haxhinikolla, I.Telo dhe R. Koçi, "Mosha e tretë në Shqipëri", 2001

F.Kodra. "Ndikimi i Krizës mbi pagat në Shqipëri", 2011, http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/@europe/@ro-geneva/@sro-budapest/documents/publication/wcms_172435.pdf

FAO, "Përditësimi i kërkesave minimum të dietës energjetike", 2008, http://www.fao.org/fileadmin/templates/ess/documents/food_security_statistics/metadata/undernourishment_methodology.pdf

Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Akademia e Shkencave, faqe 1728

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (SHDPAK), "Paketë ligjore mbi aftësine e kufizuar", 2008, http://www.adrf.org.al/images/paketa_ligjore.pdf

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), Statistika 2015, http://www.fsdksh.com.al/raporte-dhe-statistika/112-raporte-dhe-statistikat-2

Fondi Monetar Ndërkombëtar, "Manuali i pozicionimit të balancave të pagesave dhe investimeve ndërkombëtare", Botimi 6, 2010, https://www.imf.org/external/pubs/ft/bop/2007/pdf/bpm6.pdf

Fondi Monetar Ndërkombëtar, Z. Koczan , "Të jesh i varfër, të ndjehesh i varfër: Pabarazia, varfëria dhe perceptimet e varfërisë në ballkanin perëndimor", 2016, https://www.imf.org/external/pubs/ft/wp/2016/wp1631.pdf

Fruzsina, Komision Evropian, "Hungaria: Skema e të ardhurave minimale, një studim i politikave kombëtare", 2009, http://ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=9031&langId=en

Geostat, "Metodologjia e llogaritjes së minimumit jetik për mashkullin në moshën e forcës së punës", http://www.geostat.ge/cms/site_images/_files/english/methodology/Subsistence%20Minimum%20Calculation%20Methodology%20for%20Working%20Age%20Male%20ENG.pdf

H. Hoxha, "Skemat e pensioneve në Shqipëri dhe reformimi i saj në vitet e tranzicionit", Revista Demografia, 2016, faqe 74-89

H. Immervoll, "Benefitet e të ardhurave minimale në vendet e OECD-së: Hartimi i politikave, efektiviteti dhe sfidat", 2009, http://ftp.iza.org/dp4627.pdf

HRSD Kanada, "Të ardhurat e ulëta në Kanada: 2000-2007, Përdorimi i matësit të shportës së tregut", 2009, http://publications.gc.ca/collections/collection_2010/rhdcc-hrsdc/HS28-49-2009-eng.pdf

I. Telo, "Reforma e sistemit të pensioneve shtetërore në Shqipëri", http://www.coe.int/t/dg3/sscssr/source/alannex4.pdf

I. Telo, "Minimumi jetik dhe mirëqenia", 1998, faqe 75-117

I.Telo, "Reforma e sistemit të sigurimeve shoqërore, e domosdoshme për Shqipërinë", SEER, 2007, faqe 73-78

I. Vukcevic, "(Mungesa e) Të kuptuarit e rregullit të aftësisë-për-të-paguar në sistemin tatimor në Mal të Zi – Rast praktik i gjykatës kushtetuese dhe qasja legjislative", 2014, http://ojs.ius.bg.ac.rs/index.php/anali/article/view/40/74

ILO, "Dokumenti i programit të vendit për punë të denjë 2012-2015", http://www.ilo.org/public/english/bureau/program/dwcp/download/albania2.pdf

ILO, "Metodologjia e vlerësimit të minimumit jetik në Kazakistan dhe problemet e tij", 2012, http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_protect/---soc_sec/documents/publication/wcms_secsoc_33548.pdf

ILO, "Metodologjitë e përcaktimit të minimumit Jetik: Mënyrat dhe përqasjet për përmirësim", 2012, http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_protect/---soc_sec/documents/publication/wcms_secsoc_33548.pdf

ILO, "Metodologjitë për përcaktimin e minimumit jetik në Kazakistan: Mënyrat dhe përqasje për përmirësim", 2012, http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_protect/---soc_sec/documents/publication/wcms_secsoc_33548.pdf

ILO, Akti Nr. 966, 15 Korrik 1999, http://ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:13100:0::NO::P13100_COMMENT_ID:3081229

ILO, R 135: Rekomandime për përcaktimin e pagës minimale, II. Kriteret për përcaktimin e pagës minimale, 1970,
http://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100_INSTRUMENT_ID:312473

ILO, S. Kapsos, E. Bourmpoula, "Punësimi dhe klasat ekonomike në një botë në zhvillim, 2013,
http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---inst/documents/publication/wcms_216451.pdf

INSTAT dhe Banka Botërore, "Trendet në varfëri, 2002-2005-2008-2012", 2015
http://www.instat.gov.al/media/288399/living_standart_measurement_survey__2012_revised.pdf

INSTAT, "Indeksi i çmimeve të konsumit", 2016,
http://www.instat.gov.al/media/322917/metodologjia_e_ick.pdf

INSTAT, Anketa mbi nivelin e standardit të jetesës, metodologjia,
http://www.instat.gov.al/en/themes/living-standard.aspx

INSTAT, të dhëna statistikore mbi nivelin e jetesës, http://www.instat.gov.al/al/themes/niveli-i-jetes%C3%ABs.aspx?tab=tabs-5

Instituti Ekonomik Molinari, "Efektet ekonomike të pagës minimale",
http://www.institutmolinari.org/IMG/pdf/note20083en.pdf

Instituti i Sociologjisë, "Shteti i mirëqenies sociale – arritjet, mangësitë dhe rrugët e përmirësimit", 2011, fq. 41-44

Instituti i Studimeve Sindikale (ISS), "Versioni dindikalist për pagën minimale dhe pagat", 2002

ISSH, Statistika të sigurimeve shoqërore, 2015, http://www.issh.gov.al/al/wp-content/uploads/2014/02/Perb_12_15.pdf

J. Bradshaw, "Metodologjitë për të matur varfërinë: Më e mira është më shumë se një", 2001,
http://www.bristol.ac.uk/poverty/pse/conf_pap/mex01_jrb.pdf

J. Bradshaw, E. Mayhew, Komisioni Evropian, "Matja e varfërisë ekstreme në Bashkimin Evropian", Janar 2011, http://ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=6462&langId=en

J. Morduch, "Konceptet e Varfërisë",
https://wagner.nyu.edu/files/faculty/publications/conceptsofpoverty.pdf

K. Barjaba, "Kurthet e Papunësisë", 2013, fq 13-32

K. Barjaba, "Rithemelimi i mirëqenies: Zhvillimi, sfidant i varfërisë", 2014, fq 25-56

K. Harriot, "Fakte thelbësore për inflacionin", 2002,
http://boj.org.jm/uploads/pdf/papers_pamphlets/papers_pamphlets_Essential_Facts_About_Inflation_.pdf

K. Krilshvili, R. Gerliani dhe I. Makalatia, "Inovacionet metodologjike të llogaritjes së minimumit jetik dhe aplikimit të tij në Gjeorgji", http://csogeorgia.org/uploads/publications/76/77-eng.pdf

K. Y. Tsui, "Përgjithësime shumëdimensionale të treguesve relative dhe absolute: Qasja e Atkinson-Kolm-Sen", fq. 251–265, http://www.ophi.org.uk/wp-content/uploads/ssTsui-1995.pdf;

Koço Broka, "Paga minimale dhe minimumi jetik në Shqipëri", 2016, http://telegraf.al/opinion/koco-broka-paga-minimale-dhe-minimumi-jetik-ne-shqiperi

Kombet e Bashkuara , "Koncepte të pabarazisë – Çështje të zhvillimit Nr. 1, sektori i zhvillimit të politikave dhe analizave", Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Sociale, 2015, http://www.un.org/en/development/desa/policy/wess/wess_dev_issues/dsp_policy_01.pdf

Kombet e Bashkuara, "Guidë për vlerësimin e varfërisë", 2016, https://www.unece.org/fileadmin/DAM/stats/documents/ece/ces/ge.15/2016/Sem/WP4_Chapter_2_ENG.pdf

Komisioni Evropian, "Rrjeti Evropian i të ardhurave minimale, raporti vendi: Polonia, analiza dhe udhërrëfyesi për skemat e të ardhurave minimale të përshtatshme dhe të arritshme në shtetet anëtare të BE-së", https://www.julkari.fi/bitstream/handle/10024/126908/WorkingPapers80%20(1).pdf?sequence=1

Konfederata e Sindikatave te Shqipërisë, "Studim: Reforma për pensione dinjitoze", 2013, http://kssh.org/publikime/refrma-per-pensione-dinjitoze/

L. Calite, L. Balga and E.A. Fogele, "Analiza e skemës së të ardhurave minimale: Letoni", 2014, http://www.eapn.lv/emin/20150510_latvia_emin_final_report.pdf

L. Carraro, "Llogaritja dhe përdorimi i kufirit absolut të varfërisë", 2006, http://www.opml.co.uk/sites/default/files/FINAL_REPORT_-_calculation_and_use_of_an_absolute_poverty_line_(modified_OECD)_0.pdf

L. Kuchkina, "Mbi varfërinë dhe përkufizimin e minimumit jetik", http://mesharpe.metapress.com/link.asp?target=contribution&id=WG11831844482024

Shahollari Luan, "Veçori të zhvillimit të mirëqenies sociale". EMAL, 2010

Shahollari Luan, Metodologjia amerikane e matjes së varfërisë si model për Shqipërinë, Revista “Demografia nr.2, 2012, f.44.76.

Gjendet e rishikuar edhe në: Luan Shahollari: Kriza Financiare, rënia ekonomike, pasoja sociale dhe roli i shtetit.EMAL 2014. F.123-154.

Shahollari Luan: Sa të varfër ka Shqipëria?Panorama, 13 nëntor 2012.

Shahollari Luan: Rreth problemit të minimumit jetik. Ekonomia dhe tranzicioni. Revistë ekonomike tremujore. Botimi i: Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike. Nr.3 (5), dhjetor 1995. F.22-27

Ligji Nr. 7703, date 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë",të amenduar, 1993, Neni 5/1, http://www.issh.gov.al/al/wp-content/uploads/2014/02/LIGJI_7703_MERITA_UPDATE_02_02_2015.pdf

Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës", https://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2015/10/kodi_i_punes_i_ndryshuar_21960_1.doc

Ligji Nr. 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", http://observator.org.al/wp-content/uploads/2015/11/Ligji_9355_per_ndihmen_ekon.dhe_sherbimet_sociale.pdf

M. F. Forster, OECD, "Matja e të ardhurave të ulëta dhe varfërisë në perspektivën e krahasimeve ndërkombëtare", 1994, http://www.oecd-ilibrary.org/docserver/download/5lgsjhvj7v5g.pdf?expires=1471246250&id=id&accname=guest&checksum=94E7F8961A3F3C5FFA808E088EDE92AE

M. Flores, "Shporta ushqimore e familjes, përkufizimi dhe metodologjia", http://www.ncbi.nlm.nih.gov/pubmed/7447589

M. Muo, "Zhvillimi i politikës së të ardhurave dhe tregut të punës në hqipëri: Disa implikime të shpërndarjes dhe standardit të jetesës", 1996, http://www.nato.int/docu/colloq/1996/96-2-2.htm

M. Padley, D. Hirsch, L. Valadez, Njësitë ekonomike familjare nën nivelin minimal standard të të ardhurave: 2008/09-2012/13, 2015, https://dspace.lboro.ac.uk/dspace-jspui/handle/2134/16827

M. Ravallion, "Çështjet dhe matjet në modelimin e varfërisë", Jstor, https://www.jstor.org/stable/2235525?seq=1#page_scan_tab_contents

M. Ravallion, Varfëria "fanatike: Një udhëzues për koncepte dhe metoda. Studimet mbi matjen e nivelit të jetesës", 1992, fq. 252

M. Viies, Komisioni Evropian "Estonia: Skema e të ardhurave minimale, një studim i politikave kombëtare", 2009, http://ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=9026&langId=en

M.F. Forster, G. Tarcali dhe M. Till, "Të ardhurat dhe varfëria në mungesë të të ardhurave në Europë: Çfarë është standardi minimum i pranueshëm në një Bashkim Evropian të zgjeruar", 2004, http://www.euro.centre.org/data/1135243684_51096.pdf

M.Xhumari, "Trajektoret e pensioneve në Ballkanin Perëndimor, raste Studimore: Shqipëria, Maqedonia dhe Kosova 1990-2000", 2011

Makalatia, K. Krilshvili dhe R. Gerliani, "Metodologjia e llogaritjes së minimumit jetik për vendet në zhvillim dhe njehsimi i tij në shembullin e Gjeorgjisë" , http://serdica-comp.math.bas.bg/index.php/serdicajcomputing/article/viewFile/231/219

Mihailescu, "Standardi minimum i setesës, një konstante e kërkimit shkencor dhe opsionit të punës së politikave sociale", 2014, http://www.jppc.ro/reviste/JCPP%20Nr.%201%202014/articole/art11.pdf

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, "Studim i politikave të pensioneve", 2014, http://www.sociale.gov.al/files/news_files/Dokumenti_i_Pensioneve_Ang.pdf

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Fact Sheet "Pagesat për aftësinë e kufizuar", http://www.sociale.gov.al/al/dokumente/fact-sheet/pagesat-per-aftesine-e-kufizuar&page=1

Muravyev dhe A. Oshchepkov, "Pagat minimale: Papunësia dhe informaliteti: Evidencë nga të dhënat panel në rajonet e Rusisë", 2013, http://ftp.iza.org/dp7878.pdf

N. Hasa, 2014, http://www.dw.com/sq/sistemi-i-pensioneve-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-nevoj%C3%AB-urgjente-p%C3%ABr-reformim/a-17382066

Organizata e Kombeve të Bashkuara, Samiti Botëror mbi zhvillimet sociale në Kopenhagen, 1995, http://www.un.org/esa/socdev/unyin/documents/ydiDavidGordon_poverty.pdf

Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO), "Profili i vendit, të ushqyerit", 2005, http://www.fao.org/3/a-aq005e.pdf

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Konventa Nr. 168 "Konventa e nxitjes së punësimit dhe mbrotjes kundër papunësisë", 1988, http://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100_ILO_CODE:C168

P. Ruggles, "Matja e varfërisë", 1992, http://www.irp.wisc.edu/publications/focus/pdfs/foc141a.pdf

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER), "Tendencat e pagave dhe hendeku i tyre në Shqipëri", 2014, http://www.ilo.org/budapest/information-resources/press-releases/WCMS_250831/lang--en/index.htm

R. Ackland, "Përfshirja e konsumit të minimumit jetik në krahasimet ndërkombëtare të të ardhurave reale", 2008, http://www.mitpressjournals.org/doi/pdf/10.1162/rest.90.4.702

R. Anker, "Një metodologji e re për vlerësimin e kufirit të varfërisë dhe normës së pagës së jetesës të krahasueshme ndërkombtarisht", 2005, http://www.ilo.int/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---integration/documents/publication/wcms_079165.pdf

R. Bici dhe A. Mancellari, "Matja shumë-dimensionale e varfërisë – Rasti i Shqipërisë", 2015, https://dialnet.unirioja.es/descarga/articulo/5575862.pdf

R.J. Pember dhe M.Dupre, "Aspektet statistikore të përcaktimit të pagës minimale", https://www.researchgate.net/publication/265121013_Statistical_aspects_of_minimum_wage_determination

S. C. Kolm, "Barazia shumëdimensionale", https://www.jstor.org/stable/1883135?seq=1#page_scan_tab_contents;

S. Tsenkova dhe Z.N. Budic, "Mozaiku urban i Evropës post-socialiste, hapësira, institucionet dhe politikat", https://books.google.al/books?id=qvbPjM-EewUC&pg=PA153&lpg=PA153&dq=poverty+line+in+CEE+countries&source=bl&ots=FXrlYAZrrE&sig=ngkmzdlzNxrDYBGgVDb4_9rG6vc&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwjS6dfspbzOAhUIMBoKHXuwDD8Q6AEIUDAI#v=onepage&q=poverty%20line%20in%20CEE%20countries&f=false

Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015-2020, http://www.planifikimi.gov.al/sites/default/files/SKZHI_FINAL1652016_TOTAL%20bashkerendimi%20sipas%20porosise%20se%20mbledhjes%20redaktuar%2019%205%202016.pdf

Shërbimi Kërkimor i Punës, "Një përmbledhje e pagës për të jetuar dhe pagës minimale Kombëtare në Afrikën e Jugut", 2014, http://www.lrs.org.za/docs/BI2014-lowres_Chapt1.pdf

Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP), "Buletini i tregut të punës", 2014, http://www.kerkojpune.gov.al/wp-content/uploads/2015/03/Buletini-i-Tregut-t%C3%AB-Punu%C3%ABs-2014.pdf

Shërbimi Social Shtetëror, "Pagesa për aftësinë e kufizuar", http://www.sherbimisocial.gov.al/pagesat-e-aftesise-se-kufizuar/

Shërbimi Social Shtetëror, Raporti 2015, http://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2016/05/Raporti-Shssh-2015.pdf

T. Boeri, "Përcaktimi i pagës minimale, 2009, http://ftp.iza.org/dp4335.pdf

Th. Schulten, "Konturet e politikës evropiane për pagën minimale", 2014, http://library.fes.de/pdf-files/id-moe/11008.pdf

UNICEF, "Reformimi i ndihmës ekonomike: Nga mbijetesa tek investimi në reduktimin e varfërisë", 2011, http://www.unicef.org/albania/2011-Reformimi_i_ndihmes_ekonomike_shq.pdf

UNICEF, "Varfëria e fëmijëve në Shqipëri", 2013, http://www.unicef.org/albania/ChildPovertyInAlbania-En13.pdf

VKM Nr. 80, datë 28.01.2008, "Për miratimin e strategjisë sektoriale të mbrojtjes sociale dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj", http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2008/PDF-2008/14-2008.pdf

VKM Nr. 119, datë 08.03.2001, "Për një Shtesë Fondi në Buxhetin e Vitit 2001, të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, për Projektin “Minimumi Jetik, Zyrtar”", http://www.qbz.gov.al/doc.jsp?doc=docs/Vendim%20Nr%20119%20Dat%C3%AB%2008-03-2001.htm

VKM Nr. 203,date 19.04.2006, "Për Pagesën e së ardhurës nga papunësia", http://www.kerkojpune.gov.al/wp-content/uploads/2014/03/Pagesa-e-Papun%C3%ABsis%C3%AB-n%C3%AB-mb%C3%ABshtetje-t%C3%AB-tregut-t%C3%AB-pun%C3%ABs.pdf

VKM Nr. 223, date 19.04.2006, "Për pagesën e të ardhurës nga papunësia", http://www.ikub.al/LIGJE_CATEGORY/606260001/Article_Mbi-zbatimin-e-vendimit-te-Keshillit-te-Ministrave-nr-223-date-19-04-2006-Per-pa.aspx

VKM Nr. 235, datë 15.03.2008, "Për Përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", http://www.ikub.al/ligje/802270001/Article_PeR-PeRCAKTIMIN-E-PAGeS-MINIMALE-Ne-SHKALLe-VENDI-.aspx

VKM Nr. 387 datë 31.05.2001, “Për përjashtimin nga taksat dhe tatimet të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë”, http://www.ikub.al/LIGJE/105310010/Article-Per-perjashtimin-nga-taksat-dhe-tatimet-te-invalideve-paraplegjike-dhe-tetraplegjike-.aspx